

GUIDË
për
Edukimin Mjedisor
(me fokus Zonat e Mbrojtura Natyrore)

**"Natyra na shoqëron
nga mali në det"**

Publikuar nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, kati i 1, Tirana

Tel/fax: +355 42231437

<http://www.inca-al.org>

E-mail: info@inca-al.org

Të drejtat e autorit © Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, 2019

Të gjitha të drejtat mbi botimin, riprodhimin, kopjimin dhe përdorimin e informacionit të plotë ose të pjesshëm, janë të rezervuara nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri - INCA.

Hartimi i këtij dokumenti u udhehoq nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri - INCA

Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike - CEPF

Kopjet e këtij botimi janë mundësuar nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, kati I, Tiranë,

Tiranë, 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	5
1. BIODIVERSITETI NË SHQIPËRI.....	7
2. SISTEMI I ZONAVE TE MBROJTURA MJEDISORE NË SHQIPËRI DHE KATEGORIZIMI I TYRE.....	8
2.1. Çfarë është një zonë e mbrojtur?	8
2.2. Kush e propozon e më pas kush e shpall një zonë të mbrojtur?	9
2.3. A ka tipe apo forma të ndryshme zonash të mbrojtura?	9
2.4. Tipe te tjera tipe zonash te mbrojtura	10
2.5. Kush i ruan dhe i menaxhon zonat e mbrojtura?	11
2.6. A është e vështirë të menaxhosh një zonë të mbrojtur?	11
3. INTERPRETIMI I EDUKIMIT MJEDISOR NË ZONAT E MBROJTURA.....	12
3.1. Çfarë është interpretimi?.....	12
3.2. Çfarë e bën të mirë një Interpretues?	13
3.3. Si të zhvillojmë një shërbim / produkt interpretues?	15
4. EDUKIMI MJEDISOR NË PARK.....	17
4.1. Pse është i rëndësishëm edukimi dhe ndërgjegjësimi për zonat e mbrojtura?	17
4.2. Çfarë është Edukimi Mjedisor dhe pse e përdorim atë	17
4.3. Kush dhe si mund ta zhvillojë EM?	18
5. RRJETI AKTUAL I ZONVE TË MBROJTURA	20
6. AKTIVITETE EDUKUESE DHE NDËRGJEGJËSUSESE QË MUND TË ZHVILLOHEN ME FEMIJËT ME FOKUS ZONËN E MBROJTUR	22
6.1. Aktiviteti 1 : Eskursion Edukativ në Zonën e Mbrojtur “Të jesh një renxher ”	22
6.2. Aktiviteti 2: Rindërtimi i një ekosistemi në klasë	24
6.3. Aktiviteti 3: Zonat e Mbrojtura, pjesë e historisë dhe gjeografisë sonë	24
6.4. Aktiviteti 4: Të kuptojmë ekonominë tradicionale lokale.....	25
6.5. Aktiviteti 5: Takim me menaxherët e zonës së mbrojtur	27
6.6. Aktiviteti 6: Konkursi i vizatimeve për natyrën.....	28
6.7. Aktiviteti 7: “Marshimi i Mbetjeve”	29
6.8. Aktiviteti 8: “Vizitë në një resort turistik - Sa eko-miqësor janë resortet tona?	31
6.9. Aktiviteti 9: Matja e marshit të ndikimit njerëzor	32
ANEKSI 1 – ZONA E MBROJTUR PARKU KOMBËTAR I LLOGARASË	33
1. PARKU KOMBËTAR “LLOGORA”	33

1.1. LLOJET KRYESORE TË BOTËS SË EGËR TË PARKUT	39
A. BIMËT - FLORA.....	39
B. KAFSHËT.....	50
C. SHPENDËT	59
D. ZVARRANIKËT	63
2. PARKU KOMBETAR DETAR KARABURUN – SAZAN.....	64
3. PEISAZHI I MBROJTUR “VJOSË-NARTË”	69
3.1. LLOJET KRYESORE TË BOTËS SË EGËR TË PARKUT	74
A. BIMËT - FLORA.....	74
B. KAFSHËT.....	90
C. SHPENDËT	97
D. DISA LLOJE TË TJERA PREZENTE NË PEIZAZHIN E MBROJTUR.....	105
4. PLANI I MENAXHIMIT TË ZONËS SË MBROJTUR.....	106
ANEKSI 2 - Lista e Festave Mjedisore	107
MODULI 2 - EDUKIMI MJEDISOR NË KURRIKULËN E RE.....	108
VEPRIMTARI PRAKTIKE	113
MJEDISI LOKAL - TIPARET E MJEDISIT NATYROR.....	113
MJEDISI NATYROR DHE JETA E NJERËZVE	113
MBROJTJA E MJEDISIT QË NA RRETHON	113
NJOHJA NË TERREN E MJEDISIT QË NA RRETHON	114
MODULI 3 - RICIKLIMI.....	115
“RRUGË” MESIMORE MBI TEMËN E MBETJEVE - DISA IDE PËR MËSUESIT	115

HYRJE

Edukimi Mjedisor përfaqëson përpjekje të organizuara për të mësuar se si funksionon mjedisi natyror dhe, në veçanti, se si njerëzit mund të menaxhojnë sjelljet e tyre dhe ekosistemet për të jetuar në mënyrë të qëndrueshme. Edukimi mjedisor si një përpjekje e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Arsimit është pjesë e kurrikulës së re dhe trajtohet në kompetencat kyç, në programet mësimore të fushave të ndryshme kurrikulare, si dhe në hapësirat që krijon kurrikula me zgjedhje për të trajtuar aspektet e tij të ndryshme.

Edukimi mjedisor vjen me disa dimensione dhe secili prej tyre duhet marrë në konsideratë në mënyrë të veçantë me qëllim që të arrihen rezultatet e dëshiruara. Kjo paketë me informacione, udhëzime dhe veprimtari praktike ka në vëmendje të nxënësit dhe nxënësit të punojnë për edukimin mjedisor, ta prekin natyrën dhe të kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit dhe në pasurimin e tij.

Edukimi mjedisor është i lidhur me ndërgjegjësimin dhe krijimin e ndjeshmërisë për mjedisin, me parashikimin e pasojave që do t'i përjetojë mjedisi në një të ardhme jo fort të largët; ka të bëjë me sfidat mjedisore që shpesh dalin përtej kufijve të mundësive dhe kujdesit për mjedisin; kanë të bëjnë me njohjen e botës dhe të jetës së mjedisit në zona të caktuara; është e lidhur me ruajtjen e cilësisë së mjedisit dhe me evidentimin në kohë të problematikave dhe shqetësimet mjedisore.

Konceptimi i kurrikulës së re e ka patur në vëmendje Edukimin mjedisor. Një nga 7 kompetencat e saj kyç është **“Kompetenca për jetën, mjedisin dhe sipërmarrjen”**. Siç përmendet edhe në përshkrimin e kësaj kompetence *“Shkollat përgatitin nxënësit për të jetuar, për të punuar në një botë të ndërlikuar dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI kërkon kompetenca për t'u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitete për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Për të zhvilluar këtë kompetencë, shkolla u krijon nxënësve kushte që të kuptojnë tërësisht ndërvarësinë ndërmjet dukurive ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë vendore dhe globale. Ajo mundëson që nxënësit të orientohen drejt së ardhmes, të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, shkolla i ballafaqon nxënësit me problemet ekologjike, për t'i ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm”*.

Në këtë këndvështrim, nga nxënësi pritet të kontribuojë në mënyrë produktive nëse ai paraqet mirë vetveten, duke vënë theksin në pikat e forta; punon në mënyrë të pavarur dhe në grup; organizon dhe udhëheq veprimtari të të nxënësve dhe shoqërore; demonstron shkathtësi sipërmarrëse, njohuri për planifikimin e punës dhe për shfrytëzimin racional të kohës; zotëron aftësi për menaxhimin e konflikteve dhe vlerësimin e rreziqeve.

Në këtë paketë jepet një informacion të përgjithshëm mbi konceptin e zonave të mbrojtura dhe kategorizimin e tyre dhe ndihmon stafin e zonës së mbrojtur dhe mësuesit të krijojnë urat e bashkëpunimit mes tyre duke e përdorur zonën e mbrojtur si një laborator mbështetës për edukimin mjedisor të fëmijëve. Një orë diturie natyre, biologjie, gjeografie, historie, arti ose edukimi fizik mund të zhvillohen e të realizohen shumë bukur pranë një

zone të mbrojtur me mbështetjen edhe të punonjësve të vetë administratës së Zonës së mbrojtur duke ndërthurur mësimin me aktivitetin krijues të fëmijëve në natyrë.

Në veçanti moduli fokusohet në vlerat dhe mundësitë që jep në këtë kuadër “Parku Kombëtar Llogara”, Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan dhe Paisazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë.

Ky modul është hartuar nën projektin: “Nga mali në det” i financuar nga CEPF.

1. BIODIVERSITETI NË SHQIPËRI

Shqipëria, shquhet për larmi të peisazheve biologjike dhe radhitet ndër vendet me biodiversitet të lartë në Evropë. Në origjinë të kësaj larmie qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktorët gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Klima e Shqipërisë është e ndryshme dhe ka katër zona të mëdha klimatike, të cilat kontribuojnë në diversitetin e pasur biologjik të vendit. Në aspektin gjeofizik dominohet nga kodra dhe male, në pjesën Lindore e Veriore dhe zonën e ulët, në pjesën Perëndimore. Maja më e lartë në vend është 2,751m mbi nivelin e detit (Mali i Korabit) dhe më e ulëta është 8m nën nivelin e detit (Tërbuf). Lartësia mesatare e vendit është 708m mbi nivelin e detit.

Shqipëria është e njohur për rrjetin e saj të pasur dhe kompleks hidrografik, i cili përbëhet nga lumenj, liqene, ligatina, ujëra nëntokësore, dhe dete. Lumenjtë kryesorë janë: Drini, Buna, Mati, Shkumbini, Semani, Vjosa, Erzeni, Ishmi, dhe Bistrica. Ekzistojnë rreth 247 liqene natyrore të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme. Ndër to, më të rëndësishmit, janë liqenet ndërkufitare të Shkodrës, Ohrit, Prespës.

Bregdeti shqiptar është 476 km i gjatë. Deti Adriatik dhe Jon kanë një ndikim të madh mbi klimën, florën dhe faunën e vendit. Përgjatë bregdetit ka shumë ekosisteme të rëndësishme në rajonin e Mesdheut, si: lagunat, dunat ranore, deltat e lumenjve, pyjet aluvional etj. Në zonën bregdetare të Shqipërisë gjenden ligatina, të tilla si: Karavastaja, Narta, Patoku, Viluni, Kune-Vaini, Orikumi, etj.

Flora shqiptare është e lidhur ngushtë me florën e rajonit të Mesdheut, si dhe me florën e Alpeve Evropiane Jugore dhe më gjerë. Ka disa prej llojeve të rralla që tregojnë lidhjet biogeografike të florës shqiptare me florën e Lindjes, madje edhe me florën e Amerikës së Veriut.

Në Shqipëri ka rreth 7,233 taksonë (lloje) bimore (përfshirë fiernat, kërpudhat, likenet, myshqet dhe algat) dhe 5,438 lloje kafshësh (duke përfshirë shpendët, gjitarët, zvarranikët, peshqit, insektet, dekapodët etj.). Rreth 32% e të gjithë florës evropiane ndodhet në Shqipëri. Shqipëria ka një larmi të pasur të florës dhe faunës me rreth 3,976 lloje të bimëve të larta dhe 756 lloje rruazore.

Pyjet mbulojnë rreth 33% të territorit të vendit, ndërsa kullotat rreth 15%. Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve, formacioneve dhe komuniteteve bimore dhe shtazore. Pjesa më e madhe e pyjeve janë përqëndruar në zonat Veri-Lindore e Juglindore të vendit.

Relievi i Shqipërisë ka krijuar kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të llojeve endemike dhe subendemike. Në Shqipëri rriten rreth 32 lloje bimësh endemike¹ dhe rreth 110 bimë të tjera subendemike.

Grupi më i madh përfaqësues janë insektet, numërohen afro 4000 lloje. Grupin më të madh e përbëjnë Fluturat.

Peshqit përfshijnë 313 lloje e nënlloje, nga të cilët rreth 64 lloje i përkasin ujërave të ëmbëla dhe 260 lloje dhe nënlloje janë detar.

¹Endemike janë llojet që rriten vetëm në vendin tonë. Subendemike janë llojet të cilat gjenden në zona të ngushta territori natyror ose në rajone të ngjashme me të jashtë territorit të vendit.

Amfibët përfaqësohen nga 16 lloje dhe Rrëshqanorët nga 36 lloje.

Shpendët përbëhen nga 323 lloje dhe Gjitarët përfaqësohen me 70 lloje.

Lista e llojeve të mbrojtura të Shqipërisë, pjesë në Listën e Kuqe të faunës dhe florës së egër, përfshijnë 405 lloje bimore dhe 575 lloje faunistike, sipas statusit të kërcënimit.

Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e saj të lartë të ekosistemeve dhe habitateve. Brenda territorit të saj gjenden ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje gjethegjere dhe pyje halorë, kullota alpine e subalpine dhe livadhe, si dhe ekosisteme të larta malore.

Vlerat rekreative që sjell larmia biologjike dhe peizazhit apo dhe shërbimet e ekosistemit janë një pasuri, të cilat mund të përdoret për të nxitur zhvillimin e ekoturizmit. Zhvillimi i konceptit të ekoturizmit dhe i shërbimeve të biodiversitetit është një drejtim i vlerësuar si i rëndësishëm, i cili krijon mundësinë e përfitimeve ekonomike, sociale dhe shpirtërore, veçanërisht për Zonat e Mbrojtura, por jo vetëm, pasi siguron përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të biodiversitetit.

2. SISTEMI I ZONAVE TE MBROJTURA MJEDISORE NË SHQIPËRI DHE KATEGORIZIMI I TYRE

2.1. Çfarë është një zonë e mbrojtur?

Sipas Ligjit për zonat e mbrojtura në Shqipëri “Zona të mbrojtura” janë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, të cilat kanë nevojë të menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore.

Jo çdo territor tokësor apo ujqor mund të shpallet një zonë e mbrojtur. Ligji thotë se për të shpallur një zonë të mbrojtur, territori duhet të plotësojë, përgjithësisht të paktën, njëren prej kriterëve të mëposhtme:

- a) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve;
- b) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve;
- c) të ketë përfaqësueshmëri;
- ç) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit;
- d) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet;
- dh) të ketë vlera shkencore;
- e) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme;
- ë) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike;
- f) ka rrezikshmëri të lartë të kërcënohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore;
- g) mund të ofrojë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Sikur vetëm njëra nga pikat e renditura më sipër të plotësohet, atëhere zona apo territori të cilit i referohemi mund të aplikohet për t'u shpallur një zonë e mbrojtur.

2.2. Kush e propozon e më pas kush e shpall një zonë të mbrojtur?

Propozimin për një zonë të mbrojtur e bën Ministri përgjegjës për Zonat e Mbrojtura pasi ka marrë mendimet e të gjithë institucioneve të specializuara dhe të qeverisjes vendore, si dhe mendimin e komunitetit lokal e shoqërisë civile, pronarëve privatë, pronat e të cilëve do të përfshihen në zonën e mbrojtur të propozuar.

Çdo organ e institucion shtetëror, qendror ose vendor, person juridik ose fizik, shoqatë jofitimprurëse ose komunitet, ka të drejtë të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura propozime për shpalljen e zonave të mbrojtura për ndryshimin ose heqjen e statusit të çdo zone të mbrojtur për zgjerimin ose zvogëlimin e kufijve të zonës dhe për zonimin e

brendshëm të tyre. Çdo person fizik a juridik ka të drejtë t'i kërkojë ministrisë që territori i vet privat ose pjesë e objekteve natyrore të veta, të shpallen ose të përfshihen në njërin nga kategoritë e zonave të mbrojtura.

Shpallja e një zone të mbrojtur dhe zonimi i saj bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin/ZM.

Përgjatë procesit të propozimit përcaktohen koordinatat, kufijtë e zonës, si dhe zonimi i brendshëm i saj në disa nënzona dhe shkalla e mbrojtjes për secilën nënzonë të përcaktuar me qëllim që pas shpalljes të jetë e qartë forma e mbrojtjes dhe bashkëveprimi njeri-naturë. Në vendin tonë është përcaktuar një model i përshtatshëm edhe i kuptueshëm për të gjithë aktorët i përbërë nga këto nënzona:

- 1) Zona Qendrore (ZQ) (niveli A i mbrojtjes)
- 2) Zona Qendrore (ZQ) (niveli B i mbrojtjes)
- 3) Zona e Përdorimit të Qëndrueshëm dhe Tradicional (ZPQT)
- 4) Zona Rekreative (ZR)
- 5) Nënzonën buferike;
- 6) Nënzonën e trashëgimisë dhe e peizazhit kulturor.

2.3. A ka tipe apo forma të ndryshme zonash të mbrojtura?

Shpallja e një zone të mbrojtur është në interesin e të gjithë grupeve të interesuar qofshin këta thjesht pronarë toke, banorë, qytetarë apo përdorues të burimeve natyrore. Kështu, dikush ka interes të mbrojë një pjesë ujore, sepse kërkon që atje të ketë mjaftueshëm peshq për të siguruar ushqim në çdo kohë sot dhe në të ardhmen, dikush mund të jetë i ineteresuar për të mbrojtur disa zona pyjore, sepse kërkon që ai dhe fëmijët e tij të kenë mundësi të sigurojnë bimë dhe kafshë

apo të kenë ujë dhe ajër të pastër në çdo kohë ose dikush tjetër kërkon të mbrojë një peisazh të bukur që i shërben çlodhjes dhe argëtimit në natyrë për fëmijët dhe familjarët.

Në këtë formë, çdo zonë tokësore apo ujore ka arsye të ndryshme pse duhet të jetë e mbrojtur. Kjo do të thotë që zona të ndryshme të mbrojtura kërkojnë përkujdesje dhe menaxhim të ndryshëm nga njëra-tjetra. Për këtë arsye, Ligji për zonat e mbrojtura rendit 6 tipe të ndryshme zonash të mbrojtura.

1. Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor/ (Kategoria I);
2. Park Kombëtar (Kategoria II);
3. Monument Natyror (Kategoria III);
4. Rezervat natyror i menaxhuar /Park Natyror (Kategoria IV);
5. Peisazh i Mbrojtur (Kategoria V);
6. Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/Zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).

(Rreth një zone të mbrojtur mund të shpallet një zonë buferike. “Zonë buferike” quhet hapësira e kufizuar, në periferi të zonës së mbrojtur, që shërben për parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjiksht të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të një zone të mbrojtur).

Të gjitha këto quhen kategoritë e zonave të mbrojtura. Kategoritë e zonave të mbrojtura respektojnë udhëzimet e përcaktuar nga IUCN që është Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës. Ky organizëm jo qeveriar botëror synon:

- të ndikojë, të nxisë dhe të ndihmojë qeveritë dhe shoqatata në të gjithë botën në ruajtjen e bashkëjetesës dhe shumëllojshmërisë së natyrës;
- të sigurojë që çdo përdorim i burimeve natyrore të jetë miqsor dhe të ruajë parimet e ruajtjes së natyrës.

Secila prej kategorive të përmendura më lartë ka një synim të veçantë e të ndryshëm lidhur me arsyen dhe formën e mbrojtjes ruajtjes dhe menaxhimit. Me pak fjalë duhet thënë se edhe tipet e rregullave të përcaktuara për secilën kategori janë të ndryshme. Kategoria e një zone të mbrojtur duhet të përcaktohet përpara se ajo të propozohet e më pas të shpallet. Mbi bazën e kategorisë së mbrojtjes të përcaktuar hartohet më pas edhe plani i rregullave dhe aktiviteteve për menaxhimin e kësaj kategorie të zonës së mbrojtur.



2.4. Tipe te tjera tipe zonash te mbrojtura

Ekzistojnë edhe tipe të tjera zonash të mbrojtura të përcaktuara nga konventa ndërkombëtare të cilat kërkojnë një vëmendje për mbrojtje të veçantë. Disa prej tyre janë si më poshtë vijon:

- Vende të Trashëgimisë Botërore (UNESCO) – sipas konventës ndërkombëtare për ruajtjen e vendeve me vlera në trashëgiminë kulturore dhe natyrore botërore;
- Rezervat e Biosferës (UNESCO) – në kuadër të programit të UNESCO Njeriu dhe Biosfera;
- Zonat Ramsar – sipas konventës për Ligatinat me rëndësi ndërkombëtare e firmosur në Ramsar, Iran;
- Zona të mbrojtura të veçanta – sipas direktivës europiane për shpendët;
- Zonat e natyra 2000 – sipas direktivës përkatëse dhe rrejtit europian të zonave të mbrojtura.

2.5. Kush i ruan dhe i menaxhon zonat e mbrojtura?

Në vendin tonë, aktualisht, autoriteti shtetëror përgjegjës për mbarëvajtjen dhe mirëmenaxhimin e zonave të mbrojtura është Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura në Shqipëri e cila varet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe mbulon të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera pronë shtetërore, që ndodhen brenda një zone të mbrojtur, bëhen nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura. Kur këto pasuri janë pronë private, ato menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me planin e menaxhimit të zonës, të miratuar nga Ministria përgjegjëse për Mjedisin/ZM.

Menaxhimi i një zone të mbrojtur bëhet mbi bazën e rregullave të përcaktuara gjatë zonimit, si dhe planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur. Stafit të zonës së mbrojtur dhe veçanërisht Renxherat (rojet mjedisore) janë personat të cilët kujdesen drejtpërdrejtë jo vetëm për ruajtjen, por edhe për menaxhimin, zhvillimin e mirëpërdorimin e burimeve natyrore në një zonë të mbrojtur.

2.6. A është e vështirë të menaxhosh një zonë të mbrojtur?

Të punosh në një zonë të mbrojtur është e vështirë po aq sa është edhe e bukur. Të kujdesesh e të punosh për natyrën është kënaqësi. Një zonë e mbrojtur shpesh konsiderohet si shtëpia e natyrës, në atë zonë të mbrojtur të zotët e shtëpisë janë pemët, zogjtë, kafshët, zvarranikët, peshqit insektet e kështu që të kujdesesh që jeta e tyre në natyrë të mos çenohet, nga askush e asnjë gjë, e t'u vish në ndihmë me sa të mundesh nuk është edhe aq e lehtë. Për këtë duhet në radhë të parë të jesh i dashuruar dhe i apasionuar me natyrën, të jesh profesionist, i vetëdijshëm dhe i ndërgjegjshëm për të respektuar planet, rregullat, për të ndërmarrë aktivitete monitoruese, përkujdesje, dhe në raste ekstreme të mos tregohesh aspak tolerant ndaj atyre që e dëmtojnë këtë natyrë me kaq shumë vlera.

Nuk duhet të harrojmë së zonat e mbrojtura në të gjithë vendin, por sidomos në zonat bregdetare e malore, shërbejnë edhe si burim ekzistence, të mirash materiale dhe të ardhurash për komunitetin. Zonat e mbrojtura vazhdojnë ta pësojnë rëndë për shkak të mosndërgjegjësimit si duhet, lakmive dhe përdorimit të tyre pa kriter. Sfidat më të madhe për ZM është ruajtja dhe mirëpërdorimi i tyre për të përmbushur objektivat dhe funksionet për të cilat ato janë krijuar dhe të jenë sa më të prekshme e të dëshiruara nga publiku e vizitorët.

3. INTERPRETIMI I EDUKIMIT MJEDISOR NË ZONAT E MBROJTURA

3.1. Çfarë është interpretimi?

Interpretimi i çështjeve për ruajtjen e natyrës ka ngjashmëri të madhe me detyrën e një përkthyesi. Zonat e mbrojtura janë tashmë pjesë e jetës publike, sepse ato kanë një kuptim e domethënie të mjaftueshme për shoqërinë tonë. Interpretimi arrin të orientojë drejt ruajtjes së një zone përmes të kuptuarit siç duhet të vlerave dhe rëndësise së saj, ai frymëzon dhe nxit publikun ta vizitojnë dhe të kujdesen për të. Interpretimi "përkthen" dijet në një mënyrë që ato të mos humbasin apo harrohen. "Interpretimi komunikon atë që është e veçantë për zonat e mbrojtura dhe, duke krijuar një kuptueshmëri më të gjerë rreth tyre, bën që ato të vlerësohen edhe më shumë e më mirë. Kjo ndihmon publikun të ketë përvoja më pozitive dhe kuptimplote. Menaxhimi dhe ruajtja e qëndrueshme e zonave të mbrojtura natyrore varen shumë edhe nga mënyra se si i interpretojmë në vlerat e këtyre zonave .

Freeman Tilden ishte një nga njerëzit e parë që vendosi parimet dhe teoritë e interpretimit në librin e tij të vitit 1957, "Interpretimi i trashëgimisë sonë". Puna e tij në Shërbimin e Parqeve Kombëtare të Shteteve të Bashkuara frymëzoi gjeneratën e interpretuesve anëmbanë botës dhe vazhdon të jetë një model përfundimtar për këtë disiplinë. Freeman Tilden shpjegon në librin e tij se INTERPRETIMI është një veprimtari edukative që për më tepër, synon të zbulojë kuptimet dhe marrëdhëniet e një trashëgimie natyrore nëpërmjet përdorimit të elementëve natyrorë origjinalë, drejtpërdrejtë në natyrë të hapur apo metodave ilustruese dhe jo vetëm thjesht komunikimit të informacioneve faktike. Një nga citimet e Tildenit ka mbetur edhe sot si një nga frazat më të cituara në literaturën interpretuese në mbarë botën: "Përmes interpretimit vjen mirëkuptimi; përmes kuptimit vjen vlerësimi; nëpërmjet vlerësimit vjen ruajtja/mbrojtja". Tilden ka përshtatur gjashtë parime të interpretimit:

Vlerëso Audiencën!

- Çdo interpretim që nuk arrin të lidhë aspak atë që shfaqet ose përshkruhet me diçka brenda personalitetit ose përvojës së publikut që keni përballë, do të jetë i pavlevshëm. Kjo do të thotë që informacioni që jepet të jetë i kuruar duke shmangur të panevojshmet.

Prekni zemrën!

- Informacioni në vetevete, nuk është interpretim. Interpretimi është ajo çka zbulohet duke u bazuar në informacion. Por informacioni dhe interpretimi janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme. Megjithatë, të gjitha interpretimet përfshijnë brenda informacionin.

Zbuloni!

- Interpretimi është një art, i cili kombinon brenda tij shumë arte dhe disiplina, qofshin ato shkencore, historike apo arkitekture. Çdo disiplinë e artit përfshirë brenda interpretimit është i kapshëm dhe i përvetësueshëm.

Bëhu artist!

- Qëllimi kryesor i interpretimit nuk është udhëzimi, por provokimi.

Sfido!

- Interpretimi duhet të synojë të paraqesë një tërësi në vend të një pjese dhe të jetë i adresueshëm për të gjitha proceset njerëzore dhe jo vetëm për një fazë të caktuar.

Holistik/Gjithëpërfshirës!

- Interpretimi i adresuar për fëmijët (le të themi deri në 12 -13 vjeç) nuk duhet të jetë një përshtatje e prezantimit për të rriturit, por duhet të ndjekë një qasje krejtësisht të ndryshme. Për të prezantuar formën më të mirë të saj, kjo do të kërkojë një program të veçantë. Pranojini fëmijët ashtu siç janë!

Kënaqësia e audiencës është një nga objektivat më të rëndësishëm të interpretimit. Interpretimi ndihmon në zhvillimin e një ndërgjegjësimit, vlerësimi dhe mirëkuptimi më depërtues për zonën e mbrojtur. Kuptimi i vërtetë i interpretimit lidhet me atë çfarë është duke u interpretuar në zemrat dhe mendjet e audiencës dhe i përgjigjet pyetjes "Përse duhet unë të kujdesem për zonën?".

Interpretimi përfshin momente të zgjimit të vlerave intelektuale dhe emocionale, ai mundëson një perceptim më të mirë, depërtim apo zbulim të njohurive të reja. Mundësitë që vizitorët të lidhen me një vend në mënyrë kuptimplote ndodhin kur një interpretues lidh me sukses burimet e prekshme të një zone të mbrojtur me kuptimet e paprekshme që ato burime përfaqësojnë.

Në thelb ekzistojnë dy mënyra për të kryer siç duhet interpretimin: *shërbimet personale* dhe *shërbimet promociionale apo mediatike* (jo personale). *Shërbimet personale* ofrojnë mundësi për audiencën që të bashkëveprojnë personalisht me një interpretues, i cili mund të jetë mësuesi apo një punonjës i zonës së mbrojtur apo edhe një përfaqësues nga komuniteti i aftë dhe profesionist. Nga ana tjetër, audiencia mund të marrë interpretim edhe përmes *shërbimeve promociionale* apo mediake si broshurat, gazetatat, dokumentaret, turet me audio, si dhe etiketat ekspozuese.

3.2. Çfarë e bën të mirë një Interpretues?

Interpretuesi duke ofruar interpretim i jep audiencës një përvojë të kënaqshme dhe të thellë, e cila mbahet mend për një kohë të gjatë. Interpretimi efektiv mund të ketë ndikim në sjelljen dhe qëndrimin e secilit prej pjesëtarëve të audiencës.

Një interpretues i talentuar do të duhet:

- të lidhë subjektin me jetën e vizitorëve;

- të shkojë përtej ofrimit të informacionit për të zbuluar kuptimin dhe të vërtetën më thellë;
- të hartojë një histori/tregim - si vepër arti - që informon, zbavit dhe kthjellon më shumë botëkuptimin;
- të frymëzojë dhe provokojë njerëzit që të zgjerojnë horizontet e tyre përmes tregimit të tij interpretues;
- të paraqesë një temë apo tezë të plotë dhe adreson personin në tërësinë e tij;
- të sjellë të kaluarën të gjallë për ta bërë të tashmen më të këndshme dhe të ardhmen më kuptimplote. Çdo vend ka një histori;
- të angazhojë veten në përzgjedhjen dhe saktësinë e sasisë dhe cilësisë së informacionit që do të paraqesë. Interpretimi i fokusuar dhe hulumtuar mirë do të jetë më i fuqishëm e domethënës se sa një fjalim apo ligjëratë e gjatë.
- të njohë teknikat bazë të komunikimit. Interpretimi cilësor varet nga njohuritë dhe aftësitë e interpretuesit, të cilat duhet të zhvillohen në vazhdimësi.
- të rrënjos në zemrat e njerëzve aftësinë dhe dëshirën për të ndier bukuritë e mjedisit të tyre rrethues për të ofruar frymëzimin shpirtëror, si dhe për të inkurajuar ruajtjen e burimeve natyrore lokale.
- të promovojë përvoja optimale përmes programeve të synuara dhe të matura, si dhe lehtësisht të dizenuara.

Pasioni për vetë zonën e mbrojtur dhe për atë audiencë e cila vjen për tu frymëzuar në këtë zonë është elementi thelbësor i një interpretimi.

Përdorimi i një gjuhe të thjeshtë është veçanërisht e rëndësishme për një interpretues. Zhargoni i papërshtatshëm mund ta armiqësojë lehtësisht me publikun e gjerë ose të shkaktojë keqkuptime. Prandaj, interpretuesi duhet të jetë në gjendje të përshtasë gjuhën e tij me atë të dëgjuesit.

Shkrimi interpretues, përveç kësaj, duhet të adresojë atë që lexuesit do të donin të dinin, me autoritetin e urtësisë dhe mençurisë, si dhe të kujdesit që vjen me të.

Njohuritë e një interpretuesi për zonën, të kombinuara me njohuritë e vetë audiencës që ka përpara, mund të ndahen përmes një teknike të përshtatshme për të siguruar një mundësi interpretuese. Sa më e mirë të jetë njohja e zonës dhe audiencës nga interpretuesi, sa më e përshtatshme të jenë teknikat e tij për të paraqitur njohuritë e tij për këtë audiencë, aq më shumë mundësi do t'i ofrohet audiencës për të formuar lidhjet e tyre personale me zonën. Të kuptuarit sa më shumë që është e mundur në lidhje me karakteristikat, interesat, pritshmëritë dhe pikëpamjet e shumta të audiencës gjatë zhvillimit të një produkti interpretues, është thelbësor për të siguruar përvoja të kënaqshme të audiencës. Teknikat duhet të jenë të përshtatshme për auditorin, zonën dhe interpretuesin. Ekzistojnë faktorë të ndryshëm rreth audiencës që duhet të merren në konsideratë kur përzgjedhim teknikat, disa prej të cilave janë më të dukshme. Moshë, gjuha amtare, çështjet e aksesit dhe përbërja shoqërore e grupit janë disa nga gjërat e para që duhen marrë në konsideratë. Faktorë të tjerë përfshijnë:

- Zona e banimit (rurale, urbane, periferike)
- Diversiteti dhe ndikimet kulturore
- Niveli arsimor
- Kushtet e vendit
- Interesat
- Stilet e të nxënit
- Etniciteti
- Gjinia
- Dinamikat e grupit
- Madhësia e grupit
- Sfondi socio-ekonomik
- Faza e jetës

Por teknikat duhet të jenë të përshtatshme edhe për zonën. Mbrojtja e zonës është me rëndësi, dhe çdo teknikë që degradon synimin për ruajtjen e zonës duhet të shmanget. Pavarësisht se cilat teknika janë përzgjedhur, një shërbim interpretues duhet të jetë i angazhuar në mënyrë aktive. Kryerja e pyetjeve provokuese mund të jetë po aq interaktive sa prezenca e audiencës në një veprimtari praktike, në këtë këndvështrim edhe përfishirja e mediave është pjesë e shërbimeve interpretuese .

3.3. Si të zhvillojmë një shërbim / produkt interpretues?

Ka qasje të ndryshme për zhvillimin e shërbimeve interpretuese sepse interpretimi është një proces shumë kreativ. Përderisa qasjet mund të ndryshojnë mes tyre, ato zakonisht përfshijnë pjesët thelbësore si vijon:

- Njohja e motivacioneve, pritshmërive dhe njohurive paraprake të audiencës për zonën apo burimet;
- Identifikimi i temave kryesore interpretuese për zonën/burimet;
- Identifikimi i qëllimeve dhe objektivave për shërbimin ose produktin interpretues;
- Identifikimi i burimeve të qarta/të prekshme dhe përzgjedhja e një prej tyre si ikonë për fokusin e shërbimit interpretues;
- Identifikimi i të pakuptueshmes që përfaqësojnë burimet e qarta/të prekshme;
- Verifikimi se kuptimet tuaja të paprekshme përfshijnë konceptet universale (si jeta, dashuria, vdekja, mbijetesa, familja) që shumica e njerëzve mund të lidhen në një farë mënyre;
- Identifikimi i audiencës tuaj specifike për shërbimin e interpretimit;

- Sygjerim i një ideje imagjinare, një filli që do të gjurmojë rrugën e saj përmes shërbimit të interpretimit dhe do të lidh të gjitha pjesët së bashku;
- Shkrimi i një deklaratë specifike tematike që shpreh këtë ide;
- Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme që lidhin burimet e prekshme me kuptimet e paprekshme që ato përfaqësojnë;
- Përzgjedhja e një strategjie bazuar në tematikën tuaj, për të mundësuar të kuptuarin intelektual dhe emocional mbi zonën/ burimin dhe rëndësinë e tij në një mënyrë të tillë që audienca të arrijë t’ju ndjekë drejt asaj ku doni ta udhëhiqni.

Modeli i procesit përfshin hapat e mëposhtëm:

Hapi 1. Zgjidhni një vend të prekshëm, objekt, person apo ngjarje që ju dëshironi që audienca të kujdeset.

Hapi 2. Identifikimi i kuptimeve të paprekshme. Secili burim i prekshëm ka një shumëllojshmëri të pabesueshme të kuptimeve të paprekshme. Audiencat dëshirojnë të lidhen personalisht me subjektin dhe/ose burimet, dhe nëse ky rrjetëzim bëhet me mjeshtëri dhe zhvillohet nëpërmjet përdorimit të një teknike specifike, kjo prodhon një lidhje mes të prekshmes e të paprekshmes në mendjen e çdo pjestari të audiencës. Ndonjëherë kjo ndodh nëpërmjet kuptimit më të mirë të kontekstit, mprehtësisë së të kuptuarit, apo zbulimit me fjalë të tjera të mendjes inteligjente. Herë të tjera lidhja vjen përmes emocioneve - duke provokuar ndjenjën e kënaqësisë, ndjeshmërisë, çudisë, shqetësimit, habitë ose krenarisë.

Hapi 3. Identifikimi i koncepteve universale. Konceptet universale janë kuptime jomateriale që janë të rëndësishme për pothuajse të gjithë (dashuria, vdekja, shëndeti, fuqia, uji).

Hapi 4. Identifikoni auditorin.

Hapi 5. Shkruani një deklaratë tematike - përfshini një koncept universal. Një temë interpretuese është një mjet që zhvillon një ide ose disa ide në mënyrë që të frymëzojë lidhjet. Një temë interpretuese nuk është një mesazh aq sa është një pikë relevante që inkurajon mendime dhe ndjesi të reja. Tema "Fuqia e ujit" p.sh. mund të formulohet si një temë interpretuese si kjo: *Fuqia e ujit për të gdhendur, zbutur dhe vazhdimisht riformuar këtë peizazh na jep mundësi që të mrekullohemi se si një lëng i dukshëm i thjeshtë mund të luajë rol kaq të thellë në çdo peizazh të planetit.*

Hapi 6. Përdorni teknika interpretuese për të zhvilluar lidhje mes mundësive për të lidhur kuptimet.

Hapi 7. Përdorni deklaratën e temës për të organizuar mundësi për lidhje dhe për të krijuar një ide ose disa ide në mënyrë kohezive. Mënyra më e mirë për të zbuluar kuptimin është përmes eksplorimit të një ideje. Për të qenë relevantë dhe provokues, një produkt interpretues duhet të zhvillojë në mënyrë kohezive një apo disa ide gjatë rrjedhës së tij. Një ide kuptimplotë tërheq, organizon dhe mban vëmendjen e publikut. Një ide kuptimplotë ofron mundësi për audiencat që të bëjnë lidhjet e tyre me kuptimet e burimit. Pa zhvillimin koheziv të ideve përkatëse, produktet janë thjesht koleksione të informatave të ndërlidhura ose vargje të rastësishme të lidhjeve të prekshme/të paprekshme - ato nuk janë interpretuese.

4. EDUKIMI MJEDISOR NË PARK

4.1. Pse është i rëndësishëm edukimi dhe ndërgjegjësimi për zonat e mbrojtura?

Zonat e mbrojtura luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit në çdo cep të botës ku ato mund të ndodhen. Kjo nënkupton ruajtjen e jetës së egër bimët, kafshët së bashku me të gjithë veçoritë dhe proceset natyrore. Zonat e mbrojtura natyrore bëjnë të mundur ruajtjen dhe mbrojtjen e planetit Tokë ashtu sikurse vetë natyra e ka krijuar atë. Ato bëjnë të mundur reduktimin e efekteve negative të ndryshimeve klimatike. Pyjet e mbrojtura si pjesë tyre ndihmojnë në thithjen e dioksidit të karbonit dhe çlirimin të oksigjenit. Ato mbajnë ajrin dhe ujin të pastër dhe ndikojnë në cilësinë e mirë të ujit të pijshëm.

Zonat e mbrojtura janë një nga trashëgimitë më të mëdha që njerëzimi mund të lërë për brezat e ardhshëm për të garantuar që pasardhësit tanë të kenë akses ndaj burimeve natyrore dhe përfitimeve materiale e jo-materiale që ato sigurojnë.

4.2. Çfarë është Edukimi Mjedisor dhe pse e përdorim atë

Edhe pse sistemi demokratik i qeverisjes në vendin tonë i ka fillesat në vitet '90 dhe bashkë me të edhe zgjimi i sektorit të shoqërisë civile, nuk mund të themi që informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit tonë mbi pasurinë natyrore dhe ruajtjen e saj daton në po të njëjtën periudhë. Puna vullnetare e stërgjyshërve, gjyshërve dhe prindërve tanë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aseteve natyrore ka lënë gjurmët e saj, por duket se vetëm vullneti i mirë nuk mjafton në ndërgjegjësimin e brezave që vijnë. Në këtë kontekst mer një vlerë të patjetërsueshme Edukimi Mjedisor (EM) i cili ka qenë i munguar për shoqërinë shqiptare dhe ka fillesat e tij me zhvillimin e shoqërisë civile në vend. EM nuk është vetëm për nxënësit e shkollave gjatë orëve të mësimi, ky është hapi i parë. Hapi i dytë është që familjet e tyre gjithashtu të jenë në gjendje të mësojnë përvoja nga fëmijët e tyre. Nëpërmjet EM, pritet të rritet gjithashtu ndërgjegjësimi mjedisor tek publiku në përgjithësi. Edukimi Mjedisor përfaqëson përpjekje të organizuara për të mësuar se si funksionon mjedisi natyror dhe, në veçanti, se si njerëzit mund të menaxhojnë sjelljet e tyre dhe ekosistemet për të jetuar në mënyrë të qëndrueshme. EM nuk duhet të ngatërrohet me Ndërgjegjësimin Mjedisor (NM) që është gjendja ose aftësia për të perceptuar, për të ndjerë apo për të qenë të ndërgjegjshëm në lidhje me mjedisin. Niveli i këtij ndërgjegjësimi mund të konfirmohet nga një vëzhgues pa qenë nevoja për të përfshirë “të

kuptuarit” apo “të mësuarit”. Ndërkombëtarisht, edukimi mjedisor fitoi njohje kur Konferenca e OKB-së për Mjedisin Njerëzor mbajtur në Stokholm, Suedi, në vitin 1972, deklaroi se Edukimi Mjedisor duhet të përdoret si një mjet për të trajtuar problemet globale mjedisore.

Në nivel Global

1972: Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor miratoi rekomandimin 96 i cili bën thirrje për aplikimin e edukimit mjedisor si një mjet për të adresuar çështjet mjedisore kudo në botë.

1975: UNESCO organizoi një konferencë ku miratoi një Kartë e cila përfshin strukturën bazë të edukimit mjedisor

1977: UNESCO në bashkëpunim me UNEP organizuan Konferencën Ndërqeveritare mbi Edukimin Mjedisor. Konferenca përcaktoi qëllimet, objektivat dhe parimet bazë të edukimit mjedisor që përdoren gjerësisht edhe në ditët e sotme.

1992: Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin miratoi Axhendën 21, ku kapitulli 36 përcakton qëllimet e promovimit të edukimit për ndërgjegjësimin e publikut dhe trajnimin duke riorientuar edukimin në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në Shqipëri

Çështjet e Edukimit Mjedisor kanë filluar të trajtohen në Shqipëri me krijimin e Ministrisë së Mjedisit në Vitin 2001. Në të njëjtën kohë një legjislacion i ri është hartuar i cili përfshin parimet globale mbi edukimin mjedisor. Në çdo dokument strategjik mjedisor çështjet e edukimit mjedisor kanë qenë ndër veprimet kryesore të trajtuara nga Institucionet Shqiptare. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit çështja e edukimit mjedisor tashmë është pjesë e programeve shkollore. Edukimi Mjedisor në vetevete fokusohet në Ndërgjegjësim dhe ndjeshmëri për mjedisin dhe sfidat mjedisore; Njohuri dhe të kuptuarit në lidhje me mjedisin dhe sfidat mjedisore; Shqetësim për mjedisin dhe ndihma për të ruajtur cilësinë e mjedisit; Aftësi për të zbutur problemet mjedisore; Pjesëmarrje dhe ushtrim i programeve ekzistuese mjedisore.

4.3. Kush dhe si mund ta zhvillojë EM?

EM mund të zhvillohet duke nisur nga institucionet qeveritare e duke përfunduar deri në familje në individin e thjeshtë dhe të ndërgjeshëm për mjedisin. Megjithatë në mënyrë më të strukturuar për të arritur qëllime më madhore se thjesht kënaqësia apo përmbushja individuale, jashtë kësaj kornize Edukimi Mjedisor gjithmonë e më shumë po shihet edhe si: 1) Shërbim i ofruar dhe 2) Praktikë e vlefshme në menaxhimin e zonave të mbrojtura. Në këto kushte në listën e aktorëve të angazhuar gjerësisht dhe seriozisht në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të EM në një park kombëtar në vendin tonë mund të përfshihet si më poshtë vijon:

✍ Institucionet arsimore publike dhe ato private

- ✍ *Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura*
- ✍ *Pushtetet vendore*
- ✍ *Organizatrat e shoqërisë civile*
- ✍ *Kompanitë e konsulencës*
- ✍ *Grupet e rinj të apasionuar pas mjedisit (ecje, zhytje, lëvizje me biçikleta etj.)*

Mënyrat se si mund të angazhohemi në mbështetje të aktiviteteve për EM janë specifike dhe të bazuara në përvojat dhe profilet e udhëheqësve të tyre megjithatë tiparet e aktiviteteve mund të grupohen dhe natyra e tyre shfaqet si më poshtë:

Politikat e EM:

Këtu nënkuptojmë politikat në nivel qendror dhe atë vendor të vendimarrjes duke nisur nga ratifikimi i konventave ndërkombëtare, hartimi i paketave ligjore mbështetëse, strategjite sektoriale, planet e aktiviteteve lokale e deri në politikat e brendshme të institucioneve përkatëse.

EM si lëndë ekstra kurrikulare nëpër shkolla:

Në shumë shkolla të vendit tonë falë programeve të mëdha ndërkombëtare, sikundër është Paketa e Gjelbër e zbatuar nga REC apo projekti CLEAN nga UNICEF etj., në sistemin e shkollimit fillor dhe 9-vjeçar është futur EM në mënyra të ndryshme, si lëndë, si orë projektesh, temash mësimore etj.. Kjo është një nismë shumë pozitive dhe duhet të vazhdojë duke u shoqëruar me zhvillimet e orëve të hapura mjedisore në natyrë dhe programi të përfshijë edhe arsimin e mesëm.

Festimi i ditëve Mjedisore:

Është një mënyrë ndërgjegjësimi dhe edukimi e ndërkombëtarizuar e cila e trajton mjedisin “një” në të gjithë globin. Lista e ditëve mjedisore gjendet në adresën

[http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_environmental_dates.](http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_environmental_dates)

Shkollat e gjelbërta:

Janë një praktikë jo shumë e zhvilluar në vend, por që vitet e fundit po merr jehonë dhe interes. Ideja pas këtij aktiviteti është që shkollat të kthehen në modele ndërtesash ekologjike të cilat zbatojnë praktika të mira mjedisore sikundër është ngrohja me burime të rinovueshme energjie, kompostimi, ndarja e mbetjeve, përdorimi i eneve të qelqit dhe sa me pak plastikë etj., dhe mbi të gjitha ngritja e një kopshti ekologjik në shkollë në të cilin fëmijët zhvillojnë orë të hapura dhe mësojnë mbi bimët, insektet, si të mbjellin perime, si të kujdesen për to etj.

Trajnime dhe programe mjedisore:

Këtu përfshijmë të gjitha projektet dhe programet e zbatuara në kontribut të plotësimit të objektivave të EM nga shoqëria civile apo komuniteti në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm që operojnë në vend.

Ku mund ta zhvillojmë EM për Parkun Kombëtar të Llogarasë?

Nëse mendojmë për vendet më të përshtatshme për zhvillimin e efektshëm të orëve të Edukimit mjedisor atëherë duhet patjetër të dalim në natyrë dhe ta eksplorojmë atë me të gjitha shqisat tona. Në klasë mund të flasim pa fund mbi rëndësinë e mjedisit, për zhvillimin e qëndrueshëm, për rëndësinë dhe bukurinë e parqeve natyrore; mund të tregojmë fotografi të ndryshme jo vetëm të zonës ku jetojmë, por gjithashtu edhe të ndajmë kuriozitetet nga e gjithë bota; mund të kryejmë eksperimente apo të pikturojmë atë çka ndiejmë apo imagjinojmë megjithatë asnjëherë nuk mund të nxisim perceptimin dhe konceptimin e reales tek nxënësit. Këto metoda janë të largëta dhe


ndihmojnë në informimin dhe orientimin e mendimeve të nxënësve drejt natyrës dhe mjedisit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjshmërisë njerëzore, por ato nuk shërbejnë që nxënësit ta ndiejnë natyrën dhe jetën që i rrethon. Ata nuk mund të përjetojnë fuqinë e saj dhe të miqësohen me të, nuk mund ta kuptojnë rëndësinë e veprimeve të tyre dhe rolin e rëndësishëm në vendimarrje. Parku Kombëtar i Llogarasë është ndër të tjera një destinacion shumë i njohur turistik dhe kjo ja rrit akoma më shumë vlerën atij dhe e rrit përgjegjshmërinë tonë për ta ruajtur dhe mirëmenaxhuar.

5. RRJETI AKTUAL I ZONVE TË MBROJTURA

Aktualisht në Shqipëri administrohen 487,503.5ha sipërfaqe të ZMM ose 16.96% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit, sipas kategorive të ZMM si më poshtë:

Nr.	Kategoria IUCN	Numri i ZMM	Sip. Ha	%/Sip e ZMM
1	Rezervat Strikt Natyror	2	4,800.0	0,98%
2	Park Kombëtar	15	211,884.5	43.46%
3	Monument Natyre	750	3,470.0	0.71%
4	Park Natyror	23	151,770.4	31.13%
5	Peizazh i Mbrojtur	5	97,333.6	19.9%
6	Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara	4	18,245.0	3.74%
	TOTALI		487,503.5	100%

Figura 1. Harta – Rrjeti i ZMM, Korrik 2018



6. AKTIVITETE EDUKUESE DHE NDËRGJEGJËSUSESE QË MUND TË ZHVILLOHEN ME FEMIJËT ME FOKUS ZONËN E MBROJTUR

6.1. Aktiviteti 1 : *Eskursion Edukativ në Zonën e Mbrojtur “Të jesh një renxher”*

Mjetet: Bllok dhe laps, dylbi një shabllon me një specie simbol të zonës, bojë vaji që nuk dëmton drurin dhe një model certifikate për adoptimin e një peme.

Qëllimi i aktivitetit: Informimi mbi vlerat specifike të vlerave natyrore të zonës dhe rëndësia e ruajtjes dhe zhvillimit të tyre. Familjarizimi me zonën dhe punonjësit e zonës së mbrojtur.

Aktiviteti duhet të zhvillohet në bashkëpunim me stafin e zonës së mbrojtur (renxherat). Renxherat mund të drejtojnë grupin e fëmijëve dhe të mësuesve në terrenin e zonës së mbrojtur. Ata u sugjerojnë fëmijëve të luajnë rolin e renxherave të rinj dhe së bashku vëzhgojnë dhe inspektojnë terrenin e zonës së mbrojtur. Për gjatë eskursionit renxherat flasin për llojet kryesore të faunës dhe florës së zonës duke bërë edhe demonstrime të drejtpërdrejta apo edhe vëzhgime me dylbi. Ata i nxisin nxënësit të mbajnë shënime për çdo specie që vëzhgojnë, problematikat që diskutojnë apo inspektojnë së bashku. Së bashku me fëmijët për zgjedhin një pemë të veçante në zonë dhe e adaptojnë atë duke plotësuar një model certifikate adaptimi të përgatitur më parë nga vetë renxherat. Plotësimi i certifikatës u jep mundësinë fëmijëve të studiojnë pemën dhe strukturën e saj që nga kurora e gjetheve dhe lëvorja e trungut e deri tek mjedisi ku jeton dhe dëmtimet aktuale apo rreziqet që i kanosen në të ardhmen. Formati i certifikatës adaptuese lejon mundësinë që fëmijet t'i vendosin një emër/pseudonim pemës që adoptojnë, të improvizojnë një vizatim të saj apo një poezi të shkurtër. Për të lënë një shenjë miqësore që kjo pemë i përket tashmë një grupi nxënësish mbi pemë me anë të shabllonit dhe bojës vendoset shenja e species simbol. Nga ky moment fëmijët janë të ndërgjegjshëm që kur të vijnë përsëri në zonën e mbrojtur, aty do të jetë duke i pritur edhe miku i tyre me i ri “Pema që adoptuan” për të cilin ata do të kujdesen dhe do të interesohen në vazhdimësi.

Gjatë eskursionit renxherat nxisin frymëzimin dhe bashkëpunimin mes nxënësve dhe mësuesve për realizimin e aktiviteteve të tjera edukuese në shkollë apo në zonën e mbrojtur duke marrë shkas nga eskursioni mësimor dhe edukativ.

Certifikatë

Adopto një pemë

Lloji i pemës _____

Pseudonimi _____

Vendndodhja _____ Mosha _____

Perimetri _____ Lartësia _____

Pamja

a) Trungu _____

b) Lëvorja _____

Fotografi e pemës

c) Degët _____

d) Gjethet _____

e) Rrënjët _____

f) Frutat _____

g) Lulet _____

h) Gjendja e pemës _____

Përshkrimi i habitatit (Përshkruaj mjedisin rreth pemës, kafshët, lulet etj.):

Një poezi të shkurtër

Arsyeja e birësimit (Pse zgjodhët këtë pemë, çfarë ju tërhoqi tek ajo):

Cilat janë rreziqet që mund t'i kanosen pemës?

Si do ta mbronit ju atë? _____

Adoptuar nga:

DATA:

6.2. Aktiviteti 2: Rindërtimi i një ekosistemi në klasë

Qëllimi: Për të mbajtur të gjallë në kujtesën e fëmijëve të gjithë përvojën e fituar në eskursionin e zhvilluar në terrenin e zonës së mbrojtur, mësuesit i ndihmojnë fëmijët në shkollë për të improvizuar specie të veçanta apo ekosisteme të caktuara përmes pikturave, vizatimeve apo punimeve artistike.

Paisjet: Letra me ngjyrë dhe të bardha, vinovil, gazeta, bojëra, penel, bimë, lule, gjethe të thara, veshje dhe materialet të ndryshme duke përfshirë edhe mbetje shtëpiake që mund të ripërdoren.

Aktiviteti: Fëmijët ndihmohen se si të nxisin fantazinë e tyre për të realizuar vizatime, piktura apo improvizime me punime artistike të specieve të veçanta, bimë, kafshë apo ekosisteme specifike të zonës së mbrojtur. Me anë të veshjeve ata mund të improvizojnë një bimë apo një kafshë, mund të realizojnë me mjete plastike gazeta, vinovil dhe bojëra një maket me ekosistemin që ju ka lënë më shumë mbresë. Punimet e tyre shpesh mund të shoqërohen edhe me elemente të vogla natyrore (guaska, rëre, barishte e gjethe të thara, boçe pishë të rëna etj.)

Këto punime mund të vendosen në një kënd të klasës dhe më pas të jenë pjesë ndihmëse ilustrative e procesit të mësimin. Punimet mund të jenë edhe pjesë e një ekspozite dhe konkursi punimesh brenda shkollës e ndërmarrë në kuadër të një dite mjedisore.

Një grupi fëmijësh mund t'i kërkohet të vizitojë ekosistemin e improvizuar rregullisht për të parë nëse zona ka dëmtime apo ka ndryshuar në një farë forme duke përfshirë këtu edhe mbetjet apo mbeturinat përreth saj. Ata mund të kërkojnë për të parë dhe ndonjë tip të ri shpendi apo kafshë ose specie të sapolindura. Në përfundim të çdo vizite nxënësit mund:

- të bëjnë ndryshimet në këndin e tyre të punimeve,
- të diskutojnë për atë që kanë vëzhguar
- të mbajnë shënime mbi procesin e monitorimit që kanë kryer.

6.3. Aktiviteti 3: Zonat e Mbrojtura, pjesë e historisë dhe gjeografisë sonë

Qëllimi: Shpesh në kurrikulat shkollore historia lokale specifike e zonës nuk është e përfshirë. Kur nxënësit ndërveprojnë me më të moshuarit e fshatit apo të qytetit dhe diskutojnë me ta historinë e zonës së tyre, ata mbartin mbi vetë emocionin e vlerave të vendit të tyre të jetesës dhe të popullsisë që jeton atje. Ndjesia e përvetësimit/pronësisë së kësaj trashëgimie historike rrit vetëvlerësimin për të dyja palët si për fëmijët, ashtu edhe për të moshuarit dhe ndihmon që

njohuritë lokale, historia dhe tradita të mbeten të gjalla e të mos shuhet asnjëherë. Duke kuptuar dhe njohur më mirë historinë lokale mund të ndikojë ndjeshëm në mendimet e mësuesve dhe të nxënësve lidhur me rrethinat ku ata jetojnë dhe mund të sigurojë një mënyrë praktike për të ushtruar nxënësit të mësojnë më shumë për mjedisin dhe natyrën e lokalitetit të tyre.

Paisjet: Çdo nxënës duhet të ketë një bllok dhe një laps për të mbajtur shënimet. Materialet artistike varen nga rezultatet.

Aktiviteti: Ky aktivitet synon të ndihmojë dhe mbështesë komunikimin ndërveprues midis fëmijëve dhe të moshuarve në komunitetin e tyre ndërsa mbledhin histori interesante lidhur me ekosistemet në lokalitetin e tyre. Përpara se të kryhet aktiviteti, mësuesit duhet të jenë takuar vetë me më të vjetrit e njohur të zonës, për t'u shpjeguar qëllimin e takimit me fëmijët dhe fiksojnë me ta një ditë dhe orë takimi për fëmijët. Mësuesit i përgatisin paraprakisht fëmijët duke kërkuar prej tyre të formulojnë 3-5 pyetje përpara se të shkojnë në takim. Përgjatë takimit, nxënësve do t'u kërkohet të mbledhin histori lokale mbresëlënëse, si p.sh., ndërtimi i varkave të kohëve të shkuara apo peshkimi, shfrytëzimi i zonës dikur, flora dhe fauna më e njohur dhe më e përdorur, histori specifike për vende apo specie.

Sugjerime: Nxënësit mund t'i lidhin zbulimet e tyre duke i shkruar historitë që kanë mbledhur në formën e një proze apo në formën e një poezie, ose ata mund të nxiten që këto histori t'i lidhin në mënyra akoma më kreative, p.sh., si një shfaqje dramatizimi me disa ose vetëm me një aktor, ose si një teatër me kukulla. Këto mund të jenë si punime individuale ose si projekte të realizuara në grup. Mësuesit mund të ndihmojë nxënësit për të nxjerrë një vijë kohore të fshatit të tyre me ngjarje të rëndësishme lokale. Shembujt do të përfshijnë:

- Zhvillimi: Për shembull, kur është ndërtuar për herë të parë në fshat apo qytet porti, banka apo një shkollë e madhe.
- Fatkeqësitë natyrore: Për shembull, stuhi, përmbytje etj;
- Ndryshimet graduale: Për shembull ndryshimet në praktikën e peshkimit apo prezantimi i teknologjive të reja.

Nxënësit mund të vizatojnë një hartë të zonës duke treguar ku artizanet lokale dhe peshkatarët shkonin dikur për të mbledhur apo peshkuar në ekosistem. Nxënësit përdorin terminologjinë lokale kur etiketojnë vende të rëndësishme si pikat e peshkimit apo vendet e rëndësishme për grumbullim bimësh. Hartat e përgatitura mund të përdoren si bazë për të realizuar hulumtime të tjera në të ardhmen. Nxënësit duhet të rinovojnë hartën çdo 6 muaj ose çdo vit dhe të shohin ndonjë ndryshim që vihet re.

6.4. Aktiviteti 4: Të kuptojmë ekonominë tradicionale lokale

Qëllimi: Ti bëjmë nxënësit të mendojnë aktivisht rreth mënyrave dhe llojeve të aktiviteteve jetësore lokale në komunitetin e tij që varen dhe janë të lidhura fort me ekosistemet natyrore.

Paisjet: bllok shënimesh, laps, lapsa me ngjyra, aparat fotografik dhe një hartë e zonës. Nëse aparati nuk është i mundur fëmijët mund të skicojnë personin që po intervistojnë. Nëse edhe harta nuk është e mundur, fëmijët pyesin personin që po intervistojnë për t'i ndihmuar të skicojnë një hartë me pikat kryesore të interesit.

Përdor një fletë pune për të shënuar përgjigjet e marra gjatë intervistës (shiko shembullin më poshtë).

Aktiviteti: Identifikohet një ekspert (p.sh., marangoz, ndërtues varkash, zejtar, peshkatar, mbledhës bimësh apo grumbullues prodhimesh deti) dhe fiksohet takimi për të kryer intervistën. Nëse fëmijët janë të grup-moshave të ndryshme ata ndahen në disa grupe më të vogla dhe kështu realizohet intervista me disa ekspertë.

Pyetësi më poshtë është hartuar për të realizuar një intervistë me peshkatarët. Pyetësi mund të përdoret si një model për kryerjen e ushtrimit, por kjo nuk do të thotë se nuk jeni të lirë për ta përshtatur atë si mendoni ju më mirë; mos nguroni të përfshini idetë tuaja duk iu përshtatur rrethanave dhe stilit të zonës tuaj. Realizoni pyetësor të ngjashëm për të intervistuar persona që merren me shfrytëzimin e ekosistemeve të tjera në zonë.

Një shembull pyetësi: Punësimi Lokal – Peshkimi

Emri _____

Mosha _____

Adresa _____

Numri i telefonit _____

1. Në çfarë moshe ke nisur të peshkosh? Si e nise këtë punë?
2. Çfarë lloje peshqish kapni zakonisht?
3. A peshkoni vetëm apo në grup?
4. Çfarë mjetesh ju nevojiten kur peshkoni?
5. Përafërsisht sa është sasia apo pesha e asaj që peshkoni?
6. Ku është vendi ku ju peshkoni zakonisht? Më bëj një shenjë në hartë të lutem?
7. Sa larg bregut shkoni ju sot? Sa larg shkonit kur ishit më i ri?
8. Si e dini se kush është vendi më i mirë për peshkim?
9. Si e ndani më pas atë që keni kapur?
10. Si e përpunoni atë që keni kapur?
11. Ku e shisni atë që keni peshkuar? Kush ju ndihmon ju në familje?
12. A ju sjell peshkimi të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur familjen tuaj?
13. Çfarë aftësish të veçanta duhet të ketë një person për ta çuar përpara këtë lloj aktivitetit e për të bërë karrierë?
14. A do t'ia rekomandonit këtë profesion të rinjve të sotëm?

15. Kush ka qenë deri tani përvoja juaj më e bukur ndërsa keni qenë në det të hapur/ lumë/liqen duke peshkuar?

Sugjerime për punën në klasë pas intervistës:

1. Shkruaji përgjigjet e intervistës në formën e një historie të treguar nga peshkatari/marangozi/ndërtuesi i anijeve etj.
2. Vizato një hartë dhe trego se ku njerëzit sigurojnë burimet e tyre.
3. Ndërto një kalendar sezonal për të shënuar aktivitetet vjetore.
4. Ku shkon ajo që peshkohet? Ndërto një diagramë rrjedhëse për të kuptuar kërkesën e tregut dhe rrjetet e furnizimit.
5. Krijo një diagramë të marrëdhënieve energjike midis mbijetesës së peshkimit dhe ekosistemit nga i cili varet.
6. Përshkuaj gjendjen e zonave më të preferuara për peshkim.
7. Krahaso informacionin e mbledhur me atë çfarë ju keni mësuar në eskursionet që keni realizuar në ekosisteme të ndryshme.

6.5. Aktiviteti 5: Takim me menaxherët e zonës së mbrojtur

Qëllimi: Stafi profesionist i zonës së mbrojtur do të luajë rolin e lektorit duke ndarë me nxënësit kënaqësitë dhe vështirësitë e të punuarit në administrimin e një zone të mbrojtur. Nxënësit do të familjarizohen me stafin dhe do ta ndejnë veten pjesë të skuadrës që punon për mbrojtjen e parkut apo të zonës së mbrojtur si një pasuri që u përket të gjithëve. Nxënësit do të kenë mundësi të kuptojnë se cilat janë aktivitetet që ndërmerren për të ruajtur vlerat natyrore në zonën ku ata jetojnë.

Aktiviteti: Mësuesit ftojnë përfaqësues të stafit të zonës së mbrojtur, për të realizuar një diskutim me fëmijët në klasë. Fjalimi i të ftuarit do të zgjasë 30-60 minuta dhe do të përshkruajë zonën ku ai është i përfshirë për ta ruajtur dhe menaxhuar, cilat bimë apo kafshë apo ekosisteme janë të mbrojtura në atë zonë, pse kjo zonë është kaq e rëndësishme, si dhe theksimi i llojeve të aktiviteteve menaxhuese që ata janë duke ndërmarrë në zonë.

Pyetjet e mëposhtme mund të shërbejnë si një udhërfyes për punonjësin e zonës së mbrojtur:

- *Ku punoni ju dhe pse ajo është një zonë e mbrojtur?* Përshkruaj ekosistemet dhe merr në konsideratë kafshët, bimët dhe faktorë të tjerë të veçantë e të rëndësishëm për zonën. Përshkuaj çështjet kryesore me të cilat është përballur kjo zonë dhe arsyet pse mbrojtja e saj është e nevojshme.

- *Çfarë masash mbrojtëse jeni duke zbatuar aktualisht në zonë?* Sqaro çfarë statusi mbrojtje ka zona dhe çfarë specimesh mbrohen sipas këtij statusi p.sh., mbrojtja e vendeve të folezimit, kufizimin e peshkimit dhe ndalimin e nxjerrjes së burimeve natyrore);
- *Çfarë lloji menaxhimi i nënshtrohet zona?* Për shembull, nëse zona menaxhohet nga shteti/komuniteti/privati. Jep një pasqyrë të strukturave menaxhuese dhe regjimit menaxhues (p.sh., kufijtë, zonat dhe patrullimet);
- *Cilat janë aktivitetet që mund të realizohen në një zonë të mbrojtur?* Përshkruani disa nga aktivitetet më interesante të menaxhimit (p.sh., etiketimi i breshkave, monitorimit me bazë komunitetin i foleve, aktivitetet e restaurimit dhe ato turistike).

Nxënësit mund të diskutojnë gjithashtu mbi aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara në zonën e mbrojtur. Lektorit duhet ta shoqërojë bashkëbisedimin me ilustrime apo prezantime në PP.

6.6. Aktiviteti 6: Konkursi i vizatimeve për natyrën

Qëllimi i lojës: Njohja e natyrës përreth dhe zbulimi i bukurive ku jetojnë fëmijët

Mosha: Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme

Periudha: 1-2muaj

Madhësia e Grupit: Pa limit-nxënësit e interesuar janë të mirëpritur të marrin pjesë

Pajisjet: letër, lapsa me ngjyra, bojëra etj.

Mënyra si të veproni:

Para së gjithash, mësuesit informojnë nxënësit rreth rëndësisë së mjedisit natyror përreth nesh e në mënyrë të veçantë për Parkun Kombëtar të Llogarasë, Karaburunin dhe Sazanin. Mësuesi apo Stafit i Administratës së Zonave të Mbrojtura bën prezantime në klasa, apo edhe për një grup nxënësish. Prezantimi ka për qëllim të informojë në lidhje me aktivitetin e vizatimit për natyrën.

***Admirimi i natyrës**

Në një periudhë 2-3 javore rekomandohet të mendohet për natyrën. Pas hyrjes, fëmijët marrin kohë për të parë natyrën rreth tyre. Ajo mund të jetë në shkollë, në shtëpi. Ajo mund të jetë me familjarët, miqtë ose me veten e tyre. Është e rëndësishme që fëmijët të vëzhgojnë dhe të bëhen të vetëdijshëm për natyrën që i rrethon. Fëmijët fillojnë të admirojnë mjedisin ku ata jetojnë.

***Vizatimet**

Në një periudhë 2-3 javore t'i dedikohet vëzhgimit dhe vizatimit pas hyrjes. Fëmijët janë të mirëpritur që të vizatojnë me çdo mjet, të tilla si: thëngjill, lapsa, ngjyra, shumës, pluhura etj.

***Paraqitja**

Pas një periudhe 2-3 javore vizatimi, fëmijët pjesëmarrës paraqitën vizatimet dhe shkollat i

mbledhin vizatimet.

****Përzgjedhja dhe Nominimi***

Çdo shkollë tani është gati për të bërë një përzgjedhje të punëve ‘të mira’. Në varësi të numrit të pjesëmarrësve zgjidhen disa punimeve nga çdo klasë, grup klasash paralele të një viti ose në të gjithë shkollën. Për punimet e shkëlqyera, një certifikatë mund të nënshkruhet dhe t’u jepet fëmijëve.

****Ekspozita***

Është një ide e mirë për të treguar përzgjedhjen e vizatimit në çdo shkollë. Është gjithashtu e rekomanduar për të bërë një ekspozitë në sallën publike, bashki etj., për tu treguar punimet familjes dhe të afërmëve të tyre. Kjo është një mundësi mirë për komunitetet lokale që të vlerësojnë punën. Një praktikë e tillë çon në rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor për publikun e përgjithshëm gjithashtu.

6.7. Aktiviteti 7: “Marshimi i Mbetjeve”

Qëllimi: Të nxisë nxënësit të mendojnë për hedhjen dhe menaxhimin e mbeturinave, ndërlikimet që sjellin mbeturinat e jo-bio degradueshme për mjedisin, ndikimin e tyre në ekosistemet lokale. Ky aktivitet mund të kryhet në kuadër të një aktiviteti tjetër ekskursioni ose si pjesë e një dite të pastrimit të Parkut nga shkolla.

Pajisjet: Secili nxënës duhet të mbajë një fletore dhe stilolaps për të bërë shënime dhe t’i jepet një qese plastike e madhe (p.sh., një qese plehërash) për të mbledhur mbeturinat.

Aktiviteti: Merrni një grup fëmijësh për një shëtitje prej një deri në dy orë përgjatë parkut. Gjatë udhëtimit, fëmijëve duhet t’u kërkohet të mbledhin çdo mbeturinë ose mbeturina me origjinë nga njerëzit që ata gjejnë, dhe për t’i vendosur ato në qese plastike. Pasi të kthehen në klasë, nxënësit duhet të shqyrtojnë të gjitha sendet që kanë mbledhur dhe t’i klasifikojnë ato sipas materialit që janë bërë (p.sh., druri, cope, plastike, gome etj.). Duke përdorur tabelën më poshtë, nxënësit duhet të identifikojnë kohën e nevojshme për çdo lloj të mbeturinave të grumbulluara për t’u biodegraduar. Për të paraqitur gjetjet e tyre, bëni një tabelë me mbetjet që nxënësit mblodhën dhe kohën që i duhet atyre për t’u degraduar. Mbani një diskutim me nxënësit për metodat e ndryshme të hedhjes së mbeturinave dhe prezantoni konceptin e riciklimit, duke përdorur idetë e udhëzimeve për diskutim si në vijim:

- Pyesni nxënësit që të kategorizojnë sende të ndryshme sipas pasojave mjedisore të prodhimit, përdorimit dhe hedhjes apo asgjësimit të mëvonshëm (p.sh., sa energji duhet të marrë për të bërë artikullin?) Çfarë ndikimi ka mbi ekosistemin gjatë përdorimit të tij? Sa kohë do të duhet për të biodegraduar dhe cilat ndikime negative mund të kenë në ato në mjedis si mbeturina?);

- Kërkojuni nxënësve të bëjnë një hartë të lidhjeve gjeografike midis prodhuesve, përdoruesve të këtyre artikujve, vendeve në planet ku merren burimet për prodhimin e tyre si dhe ku mund të shihen ndikimet mjedisore;
- Bëni grupet të ndajnë gjetjet e tyre, duke përdorur hartën për të treguar lidhjet;
- Duke përdorur listën e pasojave mjedisore të secilit artikull, diskutoni mënyrat alternative për të bërë, përdorur, hedhur ose zëvendësuar artikujt që do të kishin një ndikim më të vogël mjedisor. Sigurohuni që të përfundoni me një shënim pozitiv dhe shpresëdhënës - të gjithë mund të ndihmojmë duke bërë më të mirën që mundemi në kërkimin e zgjidhjeve më krijuese për jetesë të qëndrueshme;
- Përfundoni me një rishikim të mësimit dhe kërkoni nga nxënësit të shpjegojnë se si mund të bëjnë një ndryshim në jetën e tyre personale për të zvogëluar gjurmën e tyre ekologjike.

Koha e nevojshme për biodegradimin e artikujve apo materialeve të ndryshme të mbeturinave.

SENDE MBETURINË	KOHA E PËRAFËRT E MARRË PËR SHKATERRIMIN/BIODEGRADIM
Peshqirë letre	2-4 javë
Koçan molle	2 muaj
Pëlhurë pambuku	1-5 muaj
Litarë	3-24 muaj
Lëkura portokalli	6 muaj
Kafshë e ngordhur	Më pak se 1 vit
Çorape leshi	1 vit
Kompensatë	1-3 vjet
Bisht cigareje	1-12 vjet
Karton qumështi	5 vjet
Dru i pikturuar	13 vjet
Qese plastike	10-50 vjet
Shishe plastike	50-80 vjet
Sandale gome/flip-flops	75 vjet
Kuti teneqeje	50-100 vjet
Pelena	200 vjet

Kanaçe alumini	200-500 vjet
Filxhan polisterol	500 vjet
Shishe qelqi	1 milion vjet

6.8. Aktiviteti 8: “Vizitë në një resort turistik - Sa eko-miqësor janë resortet tona?”

Qëllimi: Të kuptohet ndikimi i turizmit në mjedis dhe të nxisë nxënësit të mendojnë se si turizmi mund të bëhet më miqësor me mjedisin.

Pajisjet: Secili nxënës duhet të mbajë një fletore dhe stilolaps për të bërë shënime. Grupet që do të vizatojnë hartat duhet të mbajnë 2-4 fletë të mëdha të letrës së vizatimit dhe lapsa me ngjyra/shkumësa/stilolapsa.

Aktiviteti: Zgjidhni një hotel apo resort pranë shkollës apo në zonë. Merrni leje nga hoteli për t'i sjellë nxënësit të kryejnë studimin e tyre. Shpjegojini me kujdes aktivitetin dhe sqaroni nëse është e lejueshme të bisedoni me mysafirët/klientët në hotel.

Ndajini fëmijët në tre grupe më të vogla.

- Grupi A: do të bëjë vëzhgime për hotelin dhe rrethinën e tij dhe të nxjerrë një skemë/hartë.
- Grupi B: do të intervistojë turistët, do të zbulojë se nga kanë ardhur dhe do të evidentojë tre përvojat më të mira dhe tre më të këqijat që kanë pasur gjatë udhëtimit të tyre në zonë.
- Grupi C: do të intervistojë stafin e hotelit për mënyrën se si hoteli përdor energji dhe burime për të vlerësuar se sa ekologjikisht miqësore është.

Pyetjet që ata do të pyesin duhet të vendosen përpara udhëtimit dhe të shkruhen. Vlerësoni secilën në një shkallë nga 1 deri 5, ku 5 pikë janë për përgjigjen pozitive në funksion të respektit ndaj mjedisit, dhe 1 pikë për përgjigje rreth aktiviteteve që dëmtojnë mjedisin. Disa shembuj janë:

- Përdorimi i "çelësit të energjisë" që lejon që energjia elektrike të ndizet vetëm kur mysafiri vendos çelësin e dhomës në pozicionin “kaloni”;
- Përdorimi i gazit në vend të energjisë elektrike për gatim;
- Përdorimi i frigoriferëve (CFC) në kuzhinat dhe dhomat;
- Përdorimi i paneleve diellore për ngrohjen e ujit dhe për ndriçimin në natyrë;
- Përdorimi i ajrit të kondicionuar në dhoma/shtëpiza;
- Përdorimi i pajisjeve për kursimin e ujit në tualete;
- Ku është blerë ushqimi dhe nëse përdoren shumë mallra të importuara;
- Si përpunohen ujërat e zeza - a ka resorti/hoteli impiantin e tij të përpunimit të ujërave të zeza?

- Si përpunohen mbetjet, duke përfshirë planet për të minimizuar mbeturinat, klasifikimin, riciklimin, hedhjen etj;
- A i mbështet hoteli projektet lokale të komunitetit?
- A inkurajon hoteli klientët e tij për të blerë prodhime nga grupet e vetë-ndihmës, grupet e grave dhe artizanëve të zonës?
- A ka hoteli një qendër interpretimi për vlerat e natyrës në zonë për të mësuar turistët mbi natyrën dhe kulturën dhe çfarë duhet bërë dhe çfarë nuk duhet bërë?

Interpretimi i rezultateve: Në varësi të numrit të pyetjeve që kërkohen, llogarisni pikët maksimale (p.sh., nëse janë bërë 20 pyetje, rezultati maksimal i mundshëm do të jetë 100). Nëse vlerësimi është afër maksimumit vlerësimi të mundshëm, kjo tregon se janë ndërmarrë veprime serioze për ta bërë hotelin miqësor ndaj mjedisit. Një vlerësim më i ulët i rezultatit tregon se më shumë duhet të bëhet për të përmirësuar veprimet/masat.

Puna në klasë: Diskutoni gjetjet dhe kërkoni që çdo ekip të bëjë një prezantim të gjetjeve të tyre. Nxitini nxënësit për të kryer një *auditim* të ngjashëm në shtëpinë e tyre për të përcaktuar se sa miqësorë me mjedisin janë aktivitetet e tyre. Cilat fusha mund të përmirësoheshin? Sa e lehtë është të ndikojnë në familjen e tyre për t'i bërë gjërat ndryshe? Etj.

6.9. Aktiviteti 9: Matja e marshit të ndikimit njerëzor

Qëllimi: Të lejojë nxënësit të eksplorojnë llojet e aktiviteteve njerëzore që mund të kenë ndikim në ekosistemet natyrore në lokalitetin e tyre përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë.

Pajisjet: Secili nxënës duhet të mbajë një fletore dhe stilolaps për të bërë shënime.

Aktiviteti: Merrni një grup fëmijësh për një shëtitje prej një deri në dy orë përgjatë një pylli pranë zonës së tyre. Gjatë ecjes, fëmijët duhet t'u kërkohet të vëzhgojnë dhe të shënojnë të gjitha aktivitetet njerëzore që ata ndeshin. Në çfarë aktivitetesh përfshihen njerëzit? Aktivitetet mund të shkojnë nga gjuetia, prerja e drurëve, ndërtim, shitja e suvenireve ose hedhja e plehrave. Fëmijët duhet të vëzhgojnë se çfarë lloj mjetesh përdorin personat që gjejnë në park/pyll; Nëse personat që gjejnë janë të përfshirë në aktivitete çlodhëse dhe lloji ni tyre (ecje, shëtitje me biçikletë, me ecje, gomar apo kalë, piknik etj.)?

Interpretimi: Në kthimin në klasë, fëmijët mund të nxiten për të diskutuar mbi aktivitetet që ata vëzhguan, cilat aktivitete u vëzhguan më së shumti dhe çfarë ndikimesh negative të mundshme mund të kenë aktivitetet e vëzhguara për ekosistemet aty pranë.

ANEKSI 1 – ZONA E MBROJTUR PARKU KOMBËTAR I LLOGARASË

1. PARKU KOMBËTAR “LLOGORA”

Vendndodhja: Qarku i Vlorës.

Sipërfaqja totale: 1,010 ha

Statusi: Park Kombëtar, Kategoria II, IUCN; miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 11.11.1966.



Figure 1 - harta e Parkut Kombëtar Llogora

Sipërfaqja e parkut ekzistues të Llogorajt është e vogël dhe ka një bukuri të rrallë dhe me interes të theksuar shkencor, rekreativ dhe ekoturistik. Gjendet afro 40km në Jug-Lindje të qytetit të Vlorës, në kufirin hapsinor midis detit Adriatik dhe deti Jon. Formohet nga një pellg ujëmbledhës brenda të cilit përfshihen 800ha pyje dhe pjesa tjetër kullotë, livadhe dhe vende shkëmbore, tepër të thepisur. Afro gjysma e sipërfaqes ka pjerrësi mbi 30 gradë, me kundrejtimit Veri-Perëndim, me lartësi nga neveli i detit që varione nga 450-2018m, maja e Qores. Toka është e murrme pyjore dhe livadhore malore, mbi gëlqeror. Bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare, nënzona malore Jugore. Në këtë park gjenden të gjitha zonat e bimësisë së vendit tonë: Zona e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare, me lartësi 470-600m; Zona e dushkajave, në lartësitë 600-800m; Zona e ahut, në lartësitë 800-1300m dhe Zona e kullotave alpine, në lartësitë 1300-2000m. Për të mundësuar realizimin e objektivave të ruajtjes së parkut studimet e më vonëshme kanë marrë në konsideratë të gjithë rajonin: Llogara, Rrëza e Kanalit, Karaburun, Laguna e Orikumit, Lugina e Dukatit dhe Gjiri i Dukatit. Ky rajon dallohet për llojshmërinë e tipeve të habitateve dhe pasurinë në lloje të florës dhe faunës. Shumë prej tyre janë lloje që ruhen në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal. Një gamë e gjerë ekosistemesh me male të lartë (deri në 2000m), lugina alpine dhe subalpine, lloje të ndryshme pyjesh (të përzier halorë me gjethegjerë), kullota, habitate bregdetare, prezencën e burimeve ujore të pijshëm; burimet karstike, laguna, përrenj, shpellat etj. Flora dhe bimësia në këtë rajon është e pasur dhe interesante, njihen rreth 1400 lloje të bimëve të larta. Kjo shpjegohet me praninë e llojeve terciare ose relike (Tisi), me ndikimi i florave të tjera të rajonit Egje, me male të larta dhe barriera deti, me marrëdhënien njeri-naturë, duke krijuar habitate shumë komplekse të bukura (natyrore, gjysmë natyrore, të modifikuara, artificiale) dhe peizazhe. Me interes shkencor janë shoqërimet bimore: Pishë e zezë e thjeshtë mbi gëlqeror, përzierjet Bredh me Pishë të zezë, Bredh me Panjë mali, Bredh me Mëllezë, Bredh me Pishë të zezë e Mëllezë; Bredh me Panjë e Mëllezë, Rrobulli me Pishë të zezë; Mëllezë e thejstë, Buxo-Pinetum nigrae, Pinus nigra-Quercus cocciferae, etj. Këto shoqërimi janë të gërshetuar me nën pyll, ku mbizoteron Bushi, Urthi etj. Gjendet dhe grumbuj me moshë të vjetër mbi 150-200 vjet. Llojet kryesore janë: Pisha e zezë (Pinus nigra), Bredhit të Maqedonisë (Abies borisii-regis), Rrobulli (Pinus heldreichii), Tisi (Taxus bacatta), Panja fletëgjerë (Acer obtusatum), Mëllëza (Ostrya carpinifolia), Bushi (Buxus sempervirens), Urthi (Hedera helix), Trëndafil qeni (Rosa canina), Murrizi (Crataegus monogyna), Ashja (Ilex aquifolium) llojet e dëllinajve dhe të lisave, etj. Takohen lloje endemike e subendemike dhe shumë lloje të rallë e të kërcënuar. Afër Qafës së Llogarasë takohen drurë me forma kurrorash mjaft interesante, të transformuar nga erërat, ndër ta veçohet "Pisha Flamur", një monumet i rrallë i natyrës. Në lartësinë mbi 1100m, veç florës së pasur të kullotave, gjendet Sherebeli dhe Çaji i malit, në sasi të konsiderueshme. Bimët mjekësore dhe aromatike përbëjnë një pasuri me vlera ekonomike dhe shkencore, disa prej tyre janë shumë të rralla. Llojet kryesore që takohen në këtë rajon janë: Bar pezmi (Achillea millefolium), Bari i bletës (Melissa officinalis), Mentha pulegium, Agulicia (Primula veris), Mëllaga e pyllit (Malva sylvestris), Rigon i bardhë (Origanum vulgare), Sherebela (Salvia officinalis), Çaj mali (Sideritis roseri), Xhërrokulli vjeshtor (Colchicum autumnale), disa lloje kærpuhash si

Kërpudha e Çezarit (*Amanita caesarea*), Kërpudha e Ariut (*Boletus edulis*) dhe një numër të konsiderueshëm dru frytor. Në sajë të karakteristikave gjeografike rajoni përfaqëson habitate interesante për entomofaunën. Takohen rreth 93 lloje të fluturave. Gjithashtu janë identifikuar 10 lloje të amfibëve (bukura e dheut, bretkoca e përrenjve, etj); 28 lloje të reptilëve (nëperkat, breshka e zakonshme, etj); 105 lloje shpendësh (shqiponja e malit, huta, skifteri, korbi, thëllëzat, qukapiku, pëllumbi i egër, turtulli, mëllenja, bilbilat e shumë zogj të tjerë stinorj); 55 lloje të gjitarëve: Ujku (*Canis lupus*), Baldosa (*Meles meles*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Lepuri i egër (*Lepus europaeus*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Ketri (*Sciurus vulgaris*), Shqarthe-Kunadhja gushëbardhë (*Martes foina*), etj.

Parku ofron peizazh të bukur e mahnitës në brendësi dhe në vende karakteristike e pika dominuese. Nga Qafa e Cesarit, përfshihet Karaburuni, Gryka dhe Fusha e Dukatit dhe Laguna e Orikumit; Deti Jon, koni madhështor i Përroit të Thatë, Gërxhet e thepisura të maleve të Vetëtimës (Akrokeraunet ose Malet e Rrufeve), fshatrat: Palasë, Dhërmi, Vuno etj; nga maja e Qorres (2018m) dhe ajo e Paliskës (1702m) hapet panorama e fshatrave të luginës së Shushicës e me tej. Parku përshkohet nga rruga automobilistike Vlorë – Himarë - Sarandë dhe nga disa rrugë këmbësorësh dhe shtigjet në drejtime të ndryshme, që ndihmojnë për zhvillimin e ekoturizmit e të aktiviteteve të tjera argëtuese-sportive. Në mes të parkut janë ngritur fshati turistik dhe mjaft komplekse shërbimesh. Zona e parkut shërben për edukimin e publikut, pasi lidhet edhe me disa ngjareje historike. Qafa e Cesarit, e cila mban emrin e perandorit Jul të Romakëve, në vitin 48 p.e.r, gjatë inkursionit të vet kundër Pompeut, kaloi në këtë qafë. Në park gërshetohet klima e freskët malore dhe detare, duke e bërë atë tërheqës në çdo stinë të vitit. Në pranverë, verë dhe vjeshtë, pylli, livadhet, kreshtat, dhe majat e zhveshura, burimet e famshme krijojnë një harmoni drithëruese ngjyrash, që shpesh përcillet përmes kartolinave apo fotove që botohen nëpër revista, por që kurrsesi nuk kanë atë bukuri që shijohet duke ardhur këtu. Dimri, shpesh me vellon e tij të bardhë të borës, i jep atraksion të veçantë turistik. Parku, prej kohësh, përbën një destinacion turistik tepër të kërkuar. Shërben si urë tranziti për bregdetin e Jonit dhe ka potencial të madh për zhvillimin e ekoturizmit, sportet malore, turet dhe udhëtimet. Parku përdoret kryesisht për ecje në natyrë dhe ture. Shpati shkëmbor në Jug të Llogorasë shërben për gara ndërkombëtare të fluturimeve dhe parashutizmit. Parku dhe gjithë zona afër tij bëjnë pjesë në krahinën etnogeografike të Labërisë, e cila dallohet për tradita të pasura, si: vallet dhe këngët polifonike karakteristike, veshjet tradicionale, kulinaria, sidomos me mish të pjekur qengji; arkitektura dhe mënyra e veçantë e ndërtimit të banesave të mëdha të familjeve të hershme patriarkale me shumë anëtarë. Në këto banesa, dallohet dhoma e miqve, që rregullohet dhe mobilohet me kujdes të veçantë. Në park sapo është ngritur edhe Qendra e Vizitorëve. PK Llogara administrohet nga AdRZM Vlorë, nëpërmjet Administratës së parkut.

Kategorizimi i Zonës së Mbrojtur të Llogora-Karaburunit

Mbështetur në kërkesat e mësipërme, rekomandohet një model katër-zonal, bazuar në kategoritë e mëposhtme të Zonave të Menaxhuara të zonës nën projekt:



Figure 2 - Harta e zonimit të Parkut Kombëtar Llogora-Karaburun-Sazan

- ◆ Zona qendrore
- ◆ Zona rekreative
- ◆ Zona e përdorimit tradicional

◆ Zona e përdorimit të qendrueshëm

Për çdo zonë jepet një përshkrim i synimeve për të cilat ajo krijohet. Në të tregohet qëllimi i menaxhimit dhe ruajtjes së zonës si dhe përshkruhen aktivitetet prioritare në të. Më tej argumentohen duke përshkruar:

- ◆ Aktivitetet e lejuara (ato aktivitete të cilat nuk kërkojnë aprovim menaxhimi individual sa herë që ato ndermerren)
- ◆ Aktivitete të papajtueshem (ato aktivitete të cilat konsiderohen qartësisht të papajtueshem me qëllimet e zonës dhe që përgjithësisht nuk lejohen të kryhen në atë zonë me përjashtim të rrethanave të veçantanta) , dhe
- ◆ Aktivitetet që kërkojnë aprovim menaxhimi (ato aktivitete të cilët nuk janë qartësisht të papajtueshëm me qëllimet e zonës, por të cilët mund të kenë impakte negative dhe që për këtë arsye kërkojnë aprovim rast pas rasti; në disa raste mund të kërkohet edhe një vlerësim i ndikimit në mjedis).

Në këtë park ndodhen këto nënzona:

- I. **Nënzona Qendrore.** Përfshin habitate natyrore dhe zona fito-klimatike, pyje natyrore dhe të vjetër, tipare gjeologjike dhe gjeomorfologjike, habitate ligatinore dhe riparine. Zonat kyç përfshijnë pjesë të Parkut Kombëtar të Malit të Çikës - Llogara dhe Rreza e Kanalit, dhe disa areale të zgjedhur përgjatë Gadishullit të Karaburunit (p.sh. parcelat e *Quercus macrolepis*), dhe monumente të natyrës. Në këtë nënzona zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara: Aktivitete që vijnë në kundërshtim me qëllimet e zonës përfshijnë: gjuetinë, shfrytëzimi i pyjeve, mbledhja e paautorizuar, shkatërrim ose shqetësim të florës dhe faunës së egër vendase; menaxhimin e habitateve përkundrejt kontrollit/largimit të llojeve jo vendase; kullotja e gjësë së gjallë dhe çdo forme bujqësie; veprimtari pyjore; leje e pa autorizuar e çdo mjeti (përfshi edhe varkat); magazinim, hedhja ose shkarkimi i mbetjeve përfshi dhe mbetjet e patrajuara; ndërtimi dhe vënia në punë e faciliteteve industriale; ndërtimi i vendeve të banimit; çdo përdorim kimikatesh (plehërues, biocides, etj.) gurrora, miniera; largimi i agregateve dhe futja e llojeve jo native.
- II. **Nënzona rekreative.** Zonat që mund të akomodojnë një aktivitet të gjerë edukativ, mundësi rekreacioni dhe lehtësira të tjera të lidhura me to, në mënyrë që të respektojnë funksionet e Parqeve Kombëtare, vlerat ekologjike dhe peisazhin natyror/kultural. Në këtë zonë zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes sipas ligjit të ri Nr. 81/2017 të ZM, ku ndalohen: aktivitetet që shkojnë në kundërshtim me qëllimet në zonë, përfshijnë gjuetinë, shfrytëzimin e pyjeve, mbledhjen e paautorizuar, shkatërrimin apo shqetësimin e florës dhe faunes së egër vendase; menaxhimin e habitatit në vend të kontrollit/largimit të llojeve jo vendas; kullotjen e bagëtive dhe çdo forme tjetër bujqësie; veprimtaritë mbi pyllin; leje të pa autorizuara nga çdo lloj mjeti (përfshi edhe varkat); hedhjen apo grumbullimin e plehrave përfshi edhe mbetjet e patrajuara; ndërtimin venbanimeve përveç atyre me leje të posaçme për përdorim

turistik në Parkun e menaxhuar; ndërtimi i hoteleve komerciale, restoranteve, parkingjeve fushave sportive dhe shesheve të lojrave; ndërtimin dhe funksionimin e objekteve industriale; guroreve, minierave, largimin e agregateve dhe introduktimin e llojeve jo vendase.

- III. **Nënzona e përdorimit tradicional.** Kjo zonë u bën të mundur banorëve rezidentë të përhershëm apo sezonale në Parkun Kombëtar, të vazhdojnë mënyrën e tyre të jetesës me mjete tradicionale. Zona lejon subjektin publik të respektojë kufijtë e fushës rezidente dhe aktivitetet ekonomike. Vizitorët mund të shijojnë të njëjtat aktivitete dhe vlera si në Zonën Recreative RZ2, por gjithashtu duhet të njohin metodat e kultivimit tradicional dhe menyrat e jetesës. Në këtë zonë të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit të ri (2017) “Për zonat e mbrojtura”, ku mund të ushtrohen veprimtari me karakter rikrijues, edukativ, ekoturistik, si dhe përdorimi tradicional i tokës, në harmoni të plotë me ruajtjen e natyrës dhe të vlerave shoqërore e kulturore të komunitetit vendas.
- IV. **Nënzona e Përdorimit të Qëndrueshëm (ZPQ).** Kjo zonë siguron ekzistencën dhe kryerjen e veprimtarive të reja ekonomike brenda në Parkun Kombëtar, gjithnjë vetëm nëse ato përputhen me strategjinë e zhvillimit të qëndrueshëm. Kur gjenden pranë një qendre të banuar, ajo siguron një funksion të brendshëm buferik dhe një aktivitet intensiv ekonomik. Aktivitete në kundërshtim me qëllimet e zonës që përfshijnë: mbledhjen e pa autorizuar të prodhimeve të dyta, shkatërrimin ose shqetësimin e florës dhe faunës së egër vendase, depozitimin, grumbullimin dhe hedhjen e plehrave dhe mbetjeve të patrajuara, nxjerrjen, largimin e agregateve, ndërtimin dhe venien në punë të objekteve industriale (të pa shoqëruara nga Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe leja mjedisore) dhe futjen e llojeve jo vendase.

1.1. LLOJET KRYESORE TË BOTËS SË EGËR TË PARKUT

A. BIMËT - FLORA

a. Pisha e zezë (*Pinus nigra*)



Është dru që arrin një lartësi deri në 45m dhe diameter 1-1,5m. Zhvillon fuqimisht rrënjët anësore. Kërçelli është i drejtë, i rregullt dhe me pak deformime në pjesën e sipërme. Në moshë të re fomon një lëvore të trashë, me të çara të thella, në formë pllakash, në ngjyrë të përhimë në të zezë. Lëvorja është thuajse e lëmuar. Druja është e pasur me rrëshirë, ka nyje në ngjyrë të kuqe-gështenjë, e cila tek drurët e rinj mungon. Kurora vezake-piramidale, relativisht e dendur, me degë të vendosura në mënyrë qerthullore, me kohë zgjerohet dhe duket si e shtypur në formë ombrelle. Bisqet janë të zhvilluar, në ngjyrë të verdhë të murrme, të shndritshme deri në të errët, të trashë, të shogët.

Sythat janë të mëdhenj, deri në 2,4cm të gjatë, cilindrike deri vezake-konike, që mbarojnë me një majë, me rrëshirë, në ngjyrë hiri në të bardhë. Halat nga dy së bashku, të grumbulluara në majën e biskut, të gjata 8-14cm, të forta, me majë shpuese, anës me dhëmbë të imët, në ngjyrë të gjelbër të errët, qëndrojnë 4-6 vjet.

Në fund të pranverës duket çifti i parë i halave të gjelbra. Boçet mashkullore janë në ngjyrë ari 1,5-2,5cm të gjata, dalin 5-20 së bashku në bisqet e vitit të kaluar. Boçet femërore janë në ngjyrë të kuqe të hapët, nga 2 së bashku. Boçet e pjekura janë simetrike, pa bisht ose me bisht shumë të shkurtër, janë vezake deri vezake-konike (4-8(10)x3-5cm), në ngjyrë gështenjë të shndritshme, mellugat në anën e poshtme janë në ngjyrë të murrme të zezë, kanë karenë të mprehtë, apofize të dalë me një kërthizë të murrme të errët, të pajisura disa herë me një gjemb të shkurtër. Boçet shfaqen në Prill-Qershor, piqen në vjeshtën e vitit të dytë dhe hapen në pranverën e vitit të tretë. Farat janë 5-6mm të gjata, me flatër të murrme të shndritshme. Shumëzohet me farë. Pyjet me pishë të zezë ripërtërihen shumë mirë në mënyrë natyrore. Periodiciteti i frytifikimit është dy-tre vjeçar. Drurët frytifikojnë në masiv në moshën 20-25 vjeçare. Është lloj me rritje të shpejtë. Në kushtet e vendit tonë manifeston një amplitudë ekologjike të gjerë. Është lloj i krahinës mesdhetare, dritëdashës, ndonëse duron një fare hijezimi. Në përgjithësi ka kërkesa të pakta ndaj klimës dhe tokës. Është jashtëzakonisht rezistente ndaj thatësisë së zgjatur dhe të nxehtit të madh, po ashtu duron shumë mirë ngrincat e erërat e forta. Preferon më tepër kundrejtimit Jugore, Jug-Lindore e Jug-Perëndimore. Nuk i pëlqejnë vendet me lagështirë. Mbin si në toka të formuara mbi shkëmbinj serpentinare edhe gëlqerorë, duke ndikuar fuqimisht në procesin e tokëformimit. Mund të vegjetoj shumë mirë edhe në kushte stacionale të vështira, ku llojet e tjerë nuk shkojnë ose japin rezultate të dobëta, mbi shpate të pjerrëta e më toka të cekëta, skeletiko-gurishtore dhe shkëmbore. Pra, pisha e zezë, është një lloj me plasticitet të theksuar, stacionet e së cilës mund të shkojnë nga 250-300m deri në 600-1600m mbi nivelin e detit, që përfaqëson përhapjen e zakonshme të pishnajeve të vendit tonë.

Pisha e zeze është përdorur gjerësisht për pyllëzimin e këtyre vendeve, ku ka dhënë përgjithësisht rezultate të mira, duke gjelbëruar terrenin, mbrojtur tokën e shpateve nga gërryerja e duke siguruar sasira të konsiderueshme material drunor. Në këtë mënyrë janë krijuar masive të bukur me Pishë të zeze në kodrat e Pukës e të Fushë-Arrësit, tek Guri i Bardhë (Burrel), Shënmërisë në Tiranë, Moravës në Korçë, Gramoz të Kolonjës etj.

b. Bredhi i Maqedonisë (*Abies borisii-regis*)

Është një nga drurët më të bukur të vendit tonë. Arrin dimensione të mëdha, 35-40m i lartë, 1-2m i trashë. Në kushte optimale, arrin lartësinë 50-60m dhe trashësi prej 3-4m. Ka sistem rrënjor boshtor, të thellë. Kërçelli është i drejtë. Lëvorja, në moshë të re, është e lëmuar, ngjyrë të hinjtë të gjelbër. Druja është e bardhër, e butë, e lehtë, elastike, pa nyje të dallueshme. Kurora është e dendur, e ngjeshur, në formë cilindrike-piramidale. Degët janë të vendosura horizontalisht, në qerthuj të rregullt.



Bisqet në ngjyrë hiri të gjelbëreme, të lëmuar, me qime të shkurtra, me gjurmët e halave në formë rrethore. Sythat janë të vegjël, vezakë, të vendosur në qerthuj nga 3-5, shyte, pa rrëshirë. Halat të vetmuara, vizake, që përfundojnë me një bisht të shkurtër e të përkulur, janë 1,5-3cm të gjata. Lulet janë një seksore; mashkulloret janë boçe pak a shumë të gjera e të zgjatura, të verdhëreme në të gjelbër ose të kuqerremta; femëroret kanë ngjyrë të gjelbër, të vendosura më tepër në majen e kurorës. Është bimë monoike. Boçet e pjekura janë 10-20cm të gjata dhe 3-5cm të gjera, të ngritura përpjetë. Boçet piquen në vjeshtën e vitit të parë. Farat janë në ngjyrë të verdhëreme-të murrme. Bredhi shumëzohet kryesisht me farë dhe në raste shumë të rralla në mënyrë vegetative. Bredhi rradhitet ndër halorët që paraqet kërkesa më të mëdha ndaj kushteve stacionale. Ka kërkesat të larta ndaj lagështisë dhe ka ndjeshmëri të madhe ndaj ngricave. Në vendin tonë Bredhi është i përhapur kryesisht në zonën fitoklimatike të Ahut si në Alpet e Veriut, Tropojë, Kukës, Pukë, Mirditë, Dibër, Mat, Tiranë, Librazhd, Gramsh, Pogradec etj., Në Shqipërinë e Jugut takohet në Korçë, Hotovë të Përmetit, Ersekë, Gjirokastrë etj., Bredhi është ndër halorët më me vlerë për ekonominë pyjore të vendit tonë. Druri i bredhit ka cilësi të mira. Përdoret në industrinë e letrës e të celulozës, në prodhimin e mobilieve, të veglave muzikore, të shkrepeve, në ndërtim, për nxirrejen e rrëshirës dhe të vajrave eterike. Është një nga drurët më të përdorshëm për ripyllezime, gjelbërim në parqe dhe si pemë e vitit të ri.

c. Rrobulli (*Pinus heldreichii*)



Rrobulli, nga parnja e jashtme i përngjet Pishës së zezë. Është dru që arrin një lartësi 20-25m dhe një diametër 30-40(50)cm. Ka sistem rrënjor boshtor, të degëzuar. Kërçelli është i drejtë dhe në shpate të pjerrëta harkohet në bazë. Lëvorja është më e hollë se e Pishës së zezë, e drurëve të rinj është e mbushur me rrëshirë, ndërsa e drurëve të moshuar është në ngjyrë të murrme dhe e çarë pllaka-pllaka.

Lëvorja e degëve të holla, për shkak të mbresave të halave të rëna, duket si lëkurë gjarpëri. Druri i Rrobullit është më i miri i halorëve tanë. Blana është e ngushtë, në ngjyrë të verdhëreme, ndërsa myja ka ngjyrë gështenjë në të kuqe, është e imët, elastike dhe e lehtë në të punuar, ka qëndrueshmëri të mirë për një kohë të gjatë karshi lagështirës. Kurorën e ka piramidale, me degë horizontale me pak hala, në majë. Sythat janë si ato të Pishës së zezë, por pak më të vegjël, vezake deri konike, me majë dhe me pak rrëshirë. Halat janë nga dy bashkë, 6-9cm të gjata dhe 1,5mm të gjëra, të forta, në ngjyrë të gjelbër të errët, më me pak dhëmbë anës se sa ato të Pishës së zezë, me 2-11 kanale rrëshinore, qëndrojnë 5-6 vjet. Fryti është një boçe, vezake-konike (7-8cmx2,5cm), me mëlluga të sheshta, me një thumb në mes, të cilat kanë ngjyrë mishi të hapët. Boçet piquen në vjeshtën e vitit të dytë. Farat janë rreth 5mm të mëdha, të pajisura me flatër, rreth 2,5cm të gjatë. Fara mbin pas 8-10 ditësh, fuqia mbirëse është 70%. Rrobulli shumëzohet me farë. Ripërtëritet shumë mirë në mënyrë natyrore. Në vitet e para të jetës Rrobulli ka një rritje të ngadaltë, ndërsa më pas intensifikohet së tepërmi, deri në moshën 60-80 vjeçare si rezultat i aftësisë së madhe reaguese ndaj kushteve të mjedisit, në krahasim me halorët e tjerë. Në këtë mënyrë, Rrobulli, megjithëse ka prodhimtari të ulët, por në kushtet e vështira stacionale në të cilat rritet, mund të konsiderohet si lloj me prodhimtari të lartë. Rrobulli është lloj pyjor me amplitudë të gjërë ekologjike. Në kufirin e sipërm të përhapjes, Rrobulli gjëndet më tepër në kundrejtimit Jugore dhe Jug-Lindore. Rrobulli njihet si lloj kryesisht i formacioneve gëlqerore. Në vendin tonë, në sipërfaqe jo të vogla, përhapet edhe në formacione ultrabazike. Takohet kryesisht në brezin e tokave të murme pyjore dhe livadhore-malore e më pak në tokat e kafejta. Tokat janë të cekëta e shumë të cekëta, të thata, të varfra, shpesh herë mbin drejtpërdrejt mbi formacione shkëmbore. Në tokat e lagëta thuajse nuk takohet asnjëherë. Rrobulli është lloj dritëdashës dhe grumbujt pyjore që ai formon kanë karakter të theksuar heliofil. Jeton normalisht 400-500 vjet, ndërsa në stacione me kushte të mira deri në 1000 vjet.

d. Tisi (*Taxus bacatta*)

Dru i vogël, që në kushte të përshtatshme, arrin lartësinë 10-15(20)m, por më shpesh takohet në formë shkurreje. Kërçelli është i drejtë, me kanale. Lëvorja në ngjyrë të hinjtë-kuqërreme, rripet në pllaka dhe përmban një alkaloid toksik për kafshët, i quajtur taksinë.



Kurora është vezake-konike ose e rrumbullakosur, e zhvilluar deri afër tokës, me masë gjetthore të pasur e të dëndur, në ngjyrë të errët, me degëzim qerthullor. Sythat të grupuar në majë të bisqeve, janë shumë të vegjël, me mëlluga të gjelbra të verdhëreme, disa janë të qetë për një kohë të gjatë dhe zhvillohen pas prerjes ose krasitjes së drurit. Halat janë të vetmuara, vizake (10-35x2mm), pak koserake, të buta, të mprehta ose të thepta, por jo gjëmbore, të gjelbra të errëta nga sipër, ndërsa në anën e poshtme në ngjyrë të gjelbër të hapet, me dy vija gojëzore pak të dukshme, qëndrojnë në dru 4-8 vjet. Lulet janë një seksore. Boçet mashkullore janë të shumta, rruzullore, të verdha; femëroret të vetmuara, mëllugore, të gjelbra. Lulëzon në Janar-Prill. Është bimë dioike. Fryti është një boçe në trajtë bërthokle nuzullore (15-25mm e madhe), me një pështjellëse mishtake të kuqe të ëmbël, e zbuluar në majë, piqet brenda vitit. Fara është e murrme, 6-7mm e madhe, helmonjëse. Druri është homogjen, me blanë (shenja) të bardhë dhe myje të murrme-të kuqërreme, i fortë, i rëndë, pa aromë, me karakteristika mekanike të shkëlqyeshme (rezistence mekanike, elasticitet), shumë dekorativ, pa kanale rrëshinore. Shumëzohet me farë dhe në mënyrë vegetative me lastarë, me kalema dhe përpanjë (këmbëza). Frytifikon nga mosha 20 vjeçare dhe për çdo vit. Rritet shumë ngadale. Rreth moshës 10 vjeçare, dhe në kushte të favorshme, mezi arrin 1m lartësi. Jeton 2000-3000 vjet. Kërkon klimë oqeanike ose malore të lagët. Preferon stacionet e mbrojtura e të hijezuara, vendoset në tokat e murrme, pyjore të formuara mbi gëlqerorë, me copa gurësh gjatë horizontit, lehtësisht acide, të ajrosura, me rregjim normal lagështirë. Është lloj me temperament të theksuar hijedashës, duke u zhvilluar normalisht edhe në 1/100 e ndriçimit normal. Tisi rritet në pjesën më të madhe të Evropës në pyjet fletore e halorë hijedashës, si Ahu e Bredhi, të vendosur nga 300-1800m lartësi mbi nivelin e detit. Tek ne takohet me pakicë në ekzemplarë të vetmuar ose në grupe të vegjël në të gjithë tipet e ahishteve si në Llogara, Rovje e Bishnicë, Valbonë, Mbasdeje etj. Tisi ka cilësi të mira të drurit, por është dëmtuar shumë për shkak të toksicitetit të frytit dhe gjetheve të tij për kafshët. Druja përdoret në zdruktartari për prodhimin e orendive të imta, në skulpturë, për objekte të tornuara, për prodhimin e lapsave, të instrumentave të vizatimit dhe të peshimit etj. Përdoret, gjithashtu, për qëllime zbukurimi në parqe, lulishte dhe anës rrugëve, duke i dhënë formën e dëshiruar nëpërmjet qethjes dhe krasitjes.

e. Panja fletëgjere (*Acer obtusatum*)



Rritet si dru 15-20 m i lartë. Bisqet janë me push ngjyrë ulliri. Gjethet janë të rënshme, të përkundrejta, përgjithësisht më të gjera se të gjata (5-15x10-18cm), me shumë push në faqen e poshtme, me 5 vriguj me majë shyte, prej nga e ka marrë edhe emrin (krahaso obtusatum). Lulet në ngjyrë të verdhë-limoni, të grupuara në vastake të varur, çelin në Prill-Maj. Fryti është një dyshojzë me flatra të gjata, të cilat formojnë një kënd të drejtë ose pak më të ngushtë, piqen në Gusht-Nëntor.

Shumëzohet me farë dhe nxjerr shumë lastare kur pritet. Preferon klimën e zonës së gështenjës dhe të ahut dhe toka pjellore e të shkrifëta, të formuara mbi shkëmbinj gëlqerorë. Takohet edhe në toka të dobëta, të cekëta e gurishtore. Është rezistente ndaj thatësirës, më dritëdashëse dhe më nxehtësidashëse se Panja e malit. Lloj kryesisht me areal (përhapje) ballkanik, por takohet edhe në Siçili dhe Korsikë. Në vendin tonë gjendet kryesisht në zonën e gështenjës dhe në nënzonën e ngrohtë ahut, ndërmjet (400)500-1500(1600)m lartësi mbi nivelin e detit, e përhapur në formë ekzemplarësh të veçuar, grupe të vegjël, në pyje të përzier dhe shumë rrallë në grumbuj të thjeshtë, si në Malësinë e Madhe, Munellë e Martanesh, Lurë, Librazhd, Mokërr, Gorë, Opar, Llogara, etj. Druri është shumë i kërkuar në prodhimin e mobilieve, të rrimesos, të instrumenteve muzikore, për prodhimin e pjesëve të tornuara etj. Mund të përdoret edhe për pyllëzime. Vlerësohet edhe si lloj dekorativ për tu mbjellë gjatë rrugëve dhe në parqe.

f. Mëllëza (*Ostrya carpinifolia*)

Dru me lartësi 15-20m. Kërçelli është i drejtë dhe i rregullt, i pa brinjëzuar. Lëvorja e lëmuar, e kuqerremtë, me lentiçela tërthore, të bardhëreme në moshë të re, e kuqe e errët, që plasaritet, në pllaka të vogla e të gjata, në moshën e pjekurisë.



Druri në ngjyrë rozë të errët, i rëndë, i fortë, me pore të shpërndara, me fibra më të drejta dhe rrrathë vjetor më të rregullt se sa të Shkozës së bardhë, me rreze palcore pak të dukshme. Kurora është konike e zgjatur, e mbledhur, me pak e shtrirë se e Shkozës, me degët e reja me pak qime. Sythat janë vezake, shyte, me shumë mëlluga, në ngjyrë të gjelbër të hapët dhe pak a shumë të shogët. Gjethet të thjeshta, të këmbjeryera, të rënshme, vezake të thepta, (5-10x2-6cm), me buzët dyfish të sharruara, me bisht të shkurtër (5-15mm), të shndritshme nga sipër dhe më pak qime në sqetullat e nervaturave të poshtme, me 11-17 palë nervatura të dyta, pak të dukshme.

Është bimë monoike me lule të grupuara në lëvare të varur; mashkulloret duken që nga Shtatori, janë cilindrike, rreth 4-8(12)cm të gjatë, të grupuar nga 2-3 në skaje të bisqeve, me 4-10 thekë; femëroret më të shkurter (3-5cm) dhe më të gjerë, skajore, në fillim të ngritur përpjetë, pastaj të varur. Lulëzon në Mars-Maj. Fryti është një aken i lëmuar i mbrojtur nga një brakte gjethore, me push, me buzë të ngjitura në formë të një traste të zgjatur (1-2cm), në ngjyrë të bardhë të verdhëreme, të bashkuara në frytesa 6cm të gjata dhe 1-3cm të gjera, piqet në Shtator-Tetor. Fara 4-5(10)mm e madhe, pak si e shtypur, me disa qime në majë. Shumëzohet me farë. Lastaron fuqishëm sa herë që pritet. Është lloj termo dhe heliofil, që preferon stacionet me toka gëlqerore të pasura e të freskëta, por shkon edhe toka të thata e të diellëzuara. Mëllëza është lloj i krahinave malore mesdhetare, ku te ne takohet kudo, duke formuar grumbuj të vegjël e përzier me dushqe, panja, shkoza, murriza, frashër të bardhë etj, duke u ngjitur deri në 1200-1300(1500)m lartësi mbi nivelin e detit. Mund të përdoret për krijimin e pyjeve në terrenet e degraduara. Druri përdoret kryesisht për djegie dhe për vegla të ndryshme bujqësore dhe për orendi që kërkojnë dru të fortë.

g. Bushi (*Buxus sempervirens*)



Në kushte stacionale të favorshme mund të arrijë deri në 8m lartësi, por rregullisht Bushi mbetet një shkurre kaçubore. Bisqet të verdhëreme, me 4 kënde, kur janë të rinj. Druri është i fortë, i ngjeshur, me strukturë të imët, në ngjyrë të bardhë në të verdhëreme. Gjethet i ka të qëndrueshme, të përkundrejta, të thjeshta, të lëkurta, vezake-eliptike (1-3x1,5cm), të gjelbra të errëta nga sipër, më të zbehta nga poshtë, me buzë të plota, me erë të rëndë. Lulet janë të vogla, të verdha të gjelbëreme, të grupuara në tufa në sjetullat e gjetheve, çelin në Mars-Maj. Fryti është një kapsulë me tre të ndara dhe me 3 qoshe. Farat janë të zeza dhe të shkëlqyshme, piqen në Korrik-Gusht.

Shumëzohet me farë dhe në mënyrë vegetative. Ka rritje të ngadalshme. Kërkon klimë të ngrohtë dhe të butë. Është i përhapur në vendet gurishtore e të diellëzuara, nga bregdeti deri në zonat malore dhe në brendësi të vendit, në toka të tipeve të ndryshme, të thata e të varfra, por jo të rënda, preferon terrenet serpentinore e gëlqerore. Duron shumë mirë hijezimin dhe thatësirën e madhe. Ka një areal të gjerë që shtrihet nga Evropa Qendrore e Jugore, në Afrikën Veriore e në Azinë e Vogël, deri në Kaukaz. Tek ne takohet gjithkund deri në 1200m mbi nivelin e detit, duke mbuluar, vende-vende, sipërfaqe të gjëra. Takohet, gjithashtu, edhe i përzier me drurë dhe shkurre të zonës së Dafinës, Gështenjës dhe Ahut. Mbillet shpesh si lloj dekorativ në parqe e lulishte dhe për të krijuar gardhe të gjelbër, ndërsa druri i tij përdoret për përgatitje veglash e orendish shtëpiake e bujqësore që kërkojnë rezistencë, si edhe për të gdhendur skulptura.

h. Urthi (*Hedera helix*)



Është bimë kacavjerëse që disa herë rritet deri në 20-50m e gjatë dhe 10-15cm e trashë në bazë. Në rastet, kur nuk ka mbështetëse merr trajtën e një shkurreje zvarritëse. Kërçelli dhe bisqet nxjerrin rrënjë adventive me qime thithëse, me anën e të cilave kapet pas lëvorës së drurëve, shkëmbinjëve ose mureve. Lëvorja formon një ritidom mëllugor ngjyrë hiri. Bisqet janë të verdhë të hinjtë, me qime ylllore.

Gjethet janë të qëndrueshme, të këmbyera, 4-10cm të gjata, jo të njëjlojta: në bisqet jo pjellore me 3-5 vriguj trekëndore, me buzë të plota, të gjelbra të errëta në faqen e sipërme, të zbehta dhe me nervature të bardhëreme nga poshtë; në bisqet lulore janë vezake-rombrike, të pavrigulluara dhe në ngjyrë të gjelbër me të hapet. Bishti i gjethes ndonjëherë është me i gjatë se llapa. Lulet janë të bardha të gjelbra, të tipit pesë, të grupuara në ombrella skajore. Çelin shumë vonë, Shtator-Tetor. Fryti është rrushk rruzullor i zi, me diametër rreth 6mm, me 4-5 fara, piqet në pranverën e ardhshme. Në mënyrë natyrale shumëzohet me farë, lastarë, shpatulla dhe kalema. Ka një amplitudë të gjerë ekologjike, por preferon klimën e ngrohtë e të butë dhe vuan nga të ftohtit e madh; preferon tokat gëlqerore e të pasura në humus, i reziston mirë tymit e gazrave. Është hijedashës. I përhapur në Evropën Jugore deri në Kaukaz. Në vendin tonë takohet kudo mbi kërcejtë e drurëve, nëpër shkëmbinj, mure e gjerdhe, që nga zonat fushore deri në 1800m lartësi mbi nivelin e detit. Lloj shumë i çmueshëm për gjelberimin vertikal.

i. Trëndafil qeni (*Rosa canina*)



Është shkurre që nuk kalon 2-3m lartësi. Degët i ka të pajisura me gjemba të fuqishëm, të cilët janë me majë të përkulur, të shtypur anash dhe me bazë shumë të gjerë. Sythat janë të vegjël, të kuq. Gjethet janë të rënshme, të këmbyera, të përbëra, tekpendore dhe me ndajgjethëza të ngjitura me bishtin, me 5-7 gjethëza vezake ose eliptike 2-4cm të gjata, me buzë njëfish të sharruara ose disa herë dyfish të sharruara, të shogëta në të dy faqet ose me push të lehtë në nervaturat.

Lulet janë skajore, të vetmuara ose nga 2-5 së bashku, me diametër 4-5cm, me 5 petla në ngjyrë trëndafili ose të bardha dhe 5 nënpetla të mprehta. Çelin në Maj-Korrik. Fryti është i shumëfishtë, i formuar nga një pjesë mishtake elipsoidale, e kuqerremtë, me prejardhje nga shtrati lulor, që mbyll brenda akena të shumtë e të vegjël me qime.

Piqet në Gusht-Shtator. Shumëzohet me farë, kalema, shpatulla etj. Shkurre dritëdashëse e klimës së temperuar. Rritet në toka me përmbajtje të lartë bazash të këmbëshme, të thata deri të shkriçeta, disa herë të ngjeshura. Është i përhapur në Evropën Qendrore dhe Jugore. Në vendin tonë takohet kudo edhe me shumë nga llojet e tjerë të trëndafilave të egër në formë tufash, kryesisht në grumbujt pyjorë të rralluar, në skaj të pyjeve etj, deri në 1600m mbi nivelin e detit. Rëndësi paraqet fryti i trëndafilatit të egër, i cili është i pasur me vitamina C, D, P, etj. si edhe me lëndë të ndryshme sheqerore, acid nitrik etj. Lulet janë laksative. Frytet janë astringjent, pastrues të gjakut dhe luftojnë sëmundjen e skorbutit. Rrënjët kanë qënë përdorur dikur si ilaç kundër tërbimit.

j. Rigon i bardhë (*Origanum vulgare*)



Bimë barishtore shumëvjeçare, me lartësi 30-80cm, aromatike. Me kërcëj të drejtë, pak të rrënjëzuar e pasur me qime gjëndërore. Ka gjethe të përkundrejta, me bisht të shkurtër, vezake këndrejta, të veshura me qime, bojë hiri. Lulet me bisht të shkurtër dhe të grumbulluara në kalinj të stërgjatur në mes të kërcëjve, të bardha, rrallë të kuqërremta.

Lulëzon nga fundi i muajit Qershor deri nga mesi i Gushtit. Rigoni është i zakonshëm dhe gjendet në lartësitë deri në 800-1000 m mbi rrafshin e detit, në vende me barë, në shkurreta, në çeltira pyjesh ose e kultivuar. Shtrirja gjeografike e rigonit tregon qartë dhe kërkesat e kësaj bime për klimën dhe tokën. Bimë mjekësore që i grumbullohen: e gjithë bima (Herba). Përdoret në mjekësi kryesisht në dhimbjet e gojës, të dhëmbëve, kundër ftohjes dhe gripit, bronkitisit, gjithashtu përdoret dhe si çaj. Po kështu përdorime gjen dhe në gatime të ndryshme.

k. Sherebela (*Salvia officinalis*)

Bimë shumëvjeçare, në formë shkurre, me lartësi 40-50cm, shpesh edhe 1m. Kërcejtë, në përgjithësi janë shumë të degëzuar; degët njëvjeçare janë të buta, me ngjyrë hiri në krem, me push, të holla. Degët e vjetra kanë lëvore me luspa ngjyrë hiri në kafe. Çdo vit degët e sipërme thahen, kurse të poshtmet nuk pësojnë ndonjë ndryshim.



Gjethet janë të përkundërta, gjatore-vezake dhe të ngushta-eliptike, të trasha, të rrudhura, shpeshherë të pajisura me dy penda të vogëla, me push të dëndur ngjyrë hiri, me erë të këndshme dhe shije të hidhur. Gjethet e sherebelës në vendin tonë rriten 3-12cm të gjata dhe 0,4-2,8cm të gjëra. Ngjyra e gjetheve ndryshon sipas klimës dhe tokës, nga e gjelbër në hiri, nga hiri në të verdhë, me nuanca hiri të verdhë ose me nuanca hiri të gjelbër në të verdhë ose krejtësisht të gjelbër. Lule të mëdha, ngjyrë manushaqe ose blu në vjollcë, rrallë të bardha. Ato formojnë një kalli të rremë të gjithanshëm prej vermicelash me 3 deri 8 lule të pajisura me një brakte vezake në formë zëmre. Kupa në formë kambane ka pesë dhëmbë. Kurora është dybuzore, ka dy thekë, një vezore me vriguj të parregullt. Shtyllëza është e thjeshtë. Kreza është e çarë në dysh. Fryti përbëhet nga 4 akene 2-3mm të gjata dhe 2mm të gjëra, me ngjyrë kafe të errët deri në të zeshkët, kurse në pjesën e brendshme janë të bardha. Farat piqen në periudhën Gusht-Shtator. Lulëzimi ndryshon sipas pozicionit gjeografik dhe klimës. Në zonën e shkurreve mesdhetare lulëzimi fillon nga fillimi i Majit dhe ndonjëherë vazhdon deri në fund të Qershorit, kurse në zonën e dushkut fillon nga fundi i Maj dhe vazhdon deri me fillimin e muajit Korrik. Është e përhapur kudo, nëpër shkëmbinj të gëlqeror dhe faqet e maleve etj. Sherebela është bimë me kërkesa të pakta për tokën, tipike kserofite mesdhetare, prej 150-1200m lartësi nga niveli i detit. Përshtatet në çdo lloj toke, por më mirë zhvillohet në toka gëlqerore, në vende të ngrohta e të mbrojtura nga erërat. Në vendin tonë është përqendruar kryesisht në pjesën Perëndimore të territorit, të vijës diagonale Shkodër-Leskovic, në zonën që ka të gjitha karakteristikat e klimës mesdhetare, sidomos në formacionet gëlqerore me klimë të nxehtë e të thatë. Gjethet e sherebelës përmbajnë esencë, me përbërje kryesisht tujon, acetat linalili, kamfur, borneol, α e β pinen, acetat bornili, saponinë, glukozë, vitamin B₁ e C, rrëshirë etj. Përdoret në trajtë: Infuzi, Verë mjekësore, Tinkture, Cigaresh dhe Banjoje. Përgatesat e sherebelës përdoren në mjekësinë popullore. Këshillohet kundër djersitjes së natës, e mrekullueshme për qetësimin e dhimbjeve reumatizmale, kundër djersitjes së këmbëve. Sherbea është një tonik i mrekullueshëm. Esenca përdoret në industrinë e sapunit, të kozmetikës dhe të parfumerisë dhe si lëndë e pare për sintetizimin e lëndëve të tjera aromatike. Sherebela është një kullotë shumë e mirë mjaltëse.

1. Çaj mali (*Sideritis roeseri*).



Është bimë barishtore shumëvjeçare, që rritet deri në 40cm lartësi. Ka një sistem rrënjor të dobët dhe jo të futur thellë në tokë. E gjithë bima është e veshur me push të bardhë në të hirtë. Kërcejtë në përgjithësi i ka shumë të lulëzuar. Degët njëvjeçare janë shumë të buta, me ngjyrë hiri në krem, me push.

Gjethet janë 10-60mm të gjata dhe 6-20mm të gjëra, kanë formë gjatore deri në të ngushtë

vezake, të përmbysura, të plota ose me dhëmbëza. Lulesa është e përbërë nga 5-20 qerthuj të rënë dhe secili ka 6-10 lule të verdha deri në të verdhë të çelur. Lulëzon zakonisht në muajt Qershor-Korrik, në varësi nga kushtet klimatike dhe lartësisë nga niveli i detit. Çaji ka një periudhë të gjatë lulëzimi. Fillon nga fundi i muajit Qershor, intensifikohet në muajt Korrik e Gusht dhe fillon të bjerë në ditët e para të Shtatorit. Në fillim lulëzojnë lulëritë e degëve kryesore, pastaj, në periudhat e mëvonshme, nga degëzimet e dyta dalin lulëritë të tjera. Kështu që dhe vjelja e luleve duhet të kryhet periodikisht me lulëzimin e plotë, duke i prerë ato me gërshërë, deri në nivelin e kaçubes. Lidhja e farës fillon nga fundi i Korrikut, vazhdon gjatë Gushtit dhe rrallë shkon deri në 15 Shtator. Çaji i Malit në vendin tonë është më i përhapur në pjesën Jug-Lindore, por gjendet edhe në krahinat në Jug të Shkumbinit. Takohet nëpër shpate gëlqerore, në kullota dhe në male si në Korçë, Devoll, Kolonjë, Tepelenë, Gjirokastër, Përmet, Berat, Gramsh, Sarandë, Vlorë, etj. I përket zonave me klimë mesatare, shtrihet në lartësitë 1000-1800m mbi nivelin e detit. Preferon tokave me formacione të thata gëlqerore, vende shkëmbore, vende me gurë të rrallë dhe shtrat të butë. Bima shtohet me farë, me bimë të marra nga flora spontane si dhe me fidanë të përgatitur në fidanishte. Përdoren majat e lulëzuara të cilat grumbullohen në kohën e lulëzimit. Kryesisht përdoret si çaj e gjithë bima dhe gjen përdorim në mjekësinë popullore, rekomandohet kundër ftohjeve, bronkitit dhe si pije e ngrohtë.

m. Xhërrokulli vjeshtor (*Colchicum autumnale*)



Bimë barishtore shumëvjeçare, me lartësi 10-40cm, me gjethë lineare heshtore, me qepujkë nëntokësore deri 4cm. Gjethet, që dalin në pranverë, janë lineare heshtore, 20-30cm të gjata dhe 1-3cm të gjëra, me ngjyrë të gjelbër të errët dhe të bashkuara formojnë një rozetë, në mesin e së cilës formohet fryti. Lulëzon në periudhën Mars-Shtator. Lulet e mëdha dhe të bukura, kanë ngjyrë jargavani të çelur dhe të renditura në cima njëpjellëse.

Perigoni (mbështjellj) në trajtë kambane, rreth 10cm i gjatë, përbëhet nga 6 ndarje. Ka 6 thekë. Vezorja është trekëndëshe, e lirë. Në pranverën nxjerr gjethet dhe frytet, ndërsa në verë frytet piqen, duke lëshuar farat; gjethet thahen dhe mbi to nuk mbetet as një gjurmë e bimës. Në vjeshtë cikli i zhvillimit përsëritet. Fryti është një kapsulë eliptike, që del gjatë muajve Prill-Maj, i madh sa një arrë, oboval, i përbërë prej 3 karpelash të bashkuara, që çahen në majë, kur arrihen, piqet në Qershor-Korrik. Kapsolla përmban shumë fara të vogëla me ngjyrë të murrme. Qepa është e trashë sa një gisht, 3-4cm e gjatë dhe 2-3cm e gjërë. Zhvillimin e saj të plotë e ka në pranverë.

Gjatë kësaj kohe, qepa e vjetër, që i ka konsumuar rezervat ushqimore, thahet, fishket dhe formohet qepa e re, që nxjerr mbi tokë 1-3 lule. E përhapur në livadhe me lagështi të zonës kodrinore dhe malore. Gjendet edhe në vende jo shumë të thata dhe me tokë të mirë. Bimë mjekësore që tradicionalisht është përdorë kundër zjarmisë, alergjisë, mjekimin e reumatizmit, për izolimin e kolkicinës dhe të alkaloidëve, etj. Qepujka dhe farat përmbajnë alkaloidë shumë helmuese si kolkicina, sheqerna, asparaginë, acid kelidonik etj. Farat përdoren në trajtë tinkture. Kolkicina e pastër përdoret në trajtë pluhuri ose tablete. Bima ka shumë rezultate të mira si mjet antikanceröz, në leuçemi, kundër kruarjes që vjen nga sëmundjet dhe cerrozën e mëlçisë; në mjekimin e alergjisë, të rrugëve të frymëmarrjes, kollës spastike etj. Tradicionalisht është përdorë kundër zjarmisë, alergjisë dhe mjekimin e reumatizmit.

n. Kërpudha e Çezarit (*Amanita caesarea*)



Është kërpudhë ushqyese me shije shumë të mirë me kapelë në formë topi e mbuluar me një mbështjellës të bardhë që pëlqet kur kërpudha rritet, por qëndron edhe më tutje në bishtin e saj. Kërpudha e re e posadatur mbi tokë është e ngjashme me një vezë. Bishti i kërpudhës është i gjatë 12-15cm dhe ka ngjyrë të verdhë të zbehtë, është i hollë dhe me unazë karakteristike.

Ka ngjashmëri me kërpudhën helmuese *Amanita muscaria*, e cila për dallim në shumicën e rasteve ka njolla të bardha dhe bisht të bardhë që dallon nga Amanita e Cezarit. Rritet në pyllin e dushkut në lëndina të vogla të ngrohta dhe me dritë. Është më e rrallë në krahasim me kërpudhat tjera të zakonshme. Përdoret e tërë pjesa mbitokësore (dorëza dhe kapela) si ushqim dietik ose si mëlmesë në ushqime të ndryshme.

o. Kërpudha e Ariut, Pankushe (*Boletus edulis*)



Kërpudhë ushqyese e kualitetit të lartë dhe shumë e rëndësishme. Kapela e gjerë 7-30cm ngjyrë e kafenjtit ose kafenjtit të errët. Dorëza e kërpudhës (trungu) është i gjatë 8-25cm, ngjyrë të bardhë ose gati e kafenjtit të çelët. Mjaft e shpeshtë në pyllin e dushkut, gështenjës dhe ahut. Zakonisht më e shpeshtë është në pyjet e dushkut, sidomos në pyje ku depërton nga pak drita.

Përdoret dorëza dhe kapela si ushqim dietik ose si mëlmesë në ushqime të ndryshme.

B. KAFSHËT

1. Ujku (*Canis lupus*)



- Gjatësia e përgjithëshme (pa bisht):120-140cm;
- Gjatësia e bishtit: 35-48cm ;
- Veshët: 22-26cm ;
- Lartësia në shpatull: 75-90cm;
- Këmba e pasme:21-27;
- Pesha: 25-50kg (max 60 kg);
- Jetëgjatësia:15-16 jet.

Ngjyra e përgjithëshme e trupit e hirtë e hapur në erët dhe e verdhë në hiri me nuanca të zeza. Dimorfizmi seksual (dallimi midis mashkullit dhe femrës) është pak i dukshëm dhe konsiston në dimensionet më të mëdha dhe pamjen më robuste që ka mashkulli. Zëri është ulërima karakteristike, ka shumë të zhvilluar shikimin, ndigjimin dhe nuhatjen. Ujku mund të ndëgjojë zhurma qoftë edhe të intesitetit të vogël deri në 8km distancë, ndërsa mund të kapë me nuhatjen e tij aroma deri në 3km larg. Jashtëqitja e Ujku është si e qenit, por me qime. Gjurmët e ujkut janë të ngjashme me ato të një qeni të madh me ndryshimin se ato janë eliptike (9x7cm) e jo të rrumbullakta si tek qeni dhe të vendosura në vijë të drejtë jo në zigzak si te ky i fundit. Rrezja ditore e lëvizjes është 40-50km, kur ka të vegjël në strofkë vetëm 3-6km. Ujqërit kanë zakonin të ecin varg njëri pas tjetrit, duke shkelur në gjurmët e tyre dhe vetëm në pengesa gjurmët ndahen. Në vrap ujqërit ecin me rreth 60 km/orë. Në rast nevoje mund të notojë si qeni me të cilin edhe mund të kryqëzohet. Në vjeshtë dhe në dimër grumbullohet në kope të përbëra nga 7-16 krerë, brenda të cilave ka një hierarki kur kopeja del për të gjuajtur e ku ndahen rolet: ujq që ndjekin gjahun, të tjerë që bëjnë pritën etj. Gjuetia udhëhiqet nga një mashkull i fuqishëm (më rrallë femër e ritur). Kopeja është një bashkësi e mbyllur. Ujku është kafshë pylli me aftësi adaptuese të gjërë. Kafshë nate e shoqërushme, jeton i vetëm ose në çift vetëm në verë. Armiq të vërtetë ka njeriun dhe sëmundjen e tërbimit. Në Evropë kjo specie është e përhapur kryesisht në pjesën Lindore të kontinentit. Në vëndin tonë Ujku është një kafshë autoktone që gjëndet në zonat malore të vëndit në lartësitë 800-2000m, e shumë rrallë në zonën kodrinore e në fusha. Biotopi i tij janë pyjet dhe sipërfaqet me shkure të cilat i sigurojnë kushte për tu fshehur gjuajtur e folezuar. Monogam (vetëm 1 partnere), çiftet formohen në periudhën Dhjetor-Shkurt, mbas luftrash të ashpra midis meshkujve për të fituar femrat. Kryqëzimi ndodh në Shkurt-Mars. Mashkulli vazhdon të qëndrojë me femrën edhe mbas kryqëzimit, deri në rritjen e të vegjëlve. Strofka vendoset në një zgavër në tokë përfundi ndonjë druri të rëzuar në ndonjë zgavër shkëmbi Afër strofkës duhet të ketë ujë të pijshëm. Bara vazhdon 62-63 ditë. Këlyshët pillen në strofkë, ata janë të verbër dhe të shurdhër për 9-16 ditë. Tre javët e para femra nuk i le anjëherë këlyshët vetëm, duke i ushqyer me qumësht, në këtë kohë atyre ju dalin dhëmbët e qumështit.

Ajo ushqehet nga Mashkulli. Mbas 6 javësh këlyshët fillojnë të hanë mish gjysëm të tretur, të cilin ia u vjellin prindërit, pastaj të pa tretur dhe më vonë gjah të gjallë të cilin e mbytin vetë. Në moshën 15-28 javëshe këlyshëve iu zhvillohet plotësisht sistemi i dhëmbëve. Në Tetor këlyshët ndjekin prindërit në gjueti, duke formuar kështu tufat e ujqve. Familja prishet gjatë periudhës së kryqëzimit të ardhshëm. Ushqehet me mish duke vrarë vertebrorë të mëdhenj si kaproj, derra të egër, lepuj, por edhe kafshë të buta si dele, dhi, lopë, njëthundrakë, por ujku në rast nevojë konsumon edhe minj, insekte, fruta etj. Duron deri një javë pa ngrënë, pastaj mund të hajë deri 10-15kg mish njëherësh.

2. Baldosa (*Meles meles*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 75-94cm;
- Gjatësia e bishtit: 15-19cm;
- Gjatësia e veshëve: 9-11cm;
- Pesha: 10-16kg. maksimum 20kg;
- Jetëgjatësia: 5 vjet.



Baldosa e ka ngjyrën e shpinës dhe anëve hiri, kurse barkun dhe këmbët të zeza. Dy breza të zinj që fillojnë nga turiri kapin sytë veshët dhe përhapen në trup prapa kokës. Pjesa tjetër e kokës është e bardhë. Ka shumë të zhvilluar dëgjimin dhe më pak nuhatjen, kurse shikimin e ka të dobët. Poshtë bishtit afër vrimës anale ka një gjendër me sekrecion të jashtëm, që lëshon një lëng me erë të kaqe. Baldosa është kafshë plantigrade (ecin me majë këmbë) me putrat e mëdha, të çveshura e me kthetra të gjata. Sistemi i gjurmëve është karakteristik dhe vlen si element identifikimi. Baldosa noton dhe i qëndron besnike vendit të jetesës. Është kafshë e mbrëmjes dhe e natës. Në dimër nuk ushqehet, por ri në strofkë dhe pi vetëm ujë por nuk bie në letargji. Është e përhapur në Evropë dhe Azi. Në Evropë përfshin gati të gjithë kontinentin, me përjashtim të ekstremit verior. Tek ne gjëndet kudo si në fushë edhe në mal, por më dendur takohet në zonën kodrinore. Biotopi i saj janë pyjet, sidomos ato të fletore dhe zonat me shkure afër tokave bujqësore, vreshtave e livadheve, ku gjen ushqim. Baldosa iu largohet vëndeve të urbanizuara. Është kafshë më pak e varur nga mjedisi pyjor. Baldosa kryqëzohet në Janar-Mars, kur femra mund të bashkohet me më shumë meshkuj të të njëjtit klan, por mund të kryqëzohet edhe në kohë të tjera të vitit, prandaj këlyshë baldose shifen gjatë gjithë vitit. Veza e fekunduar qëndron e pa fiksuar në muret e uterusit për 10 muaj, pra nuk zhvillohet. Pastaj për rreth dy muaj veza zhvillohet dhe pjellja ndodh në Mars-Prill. Për ndërtimin e strofkës baldosa hap galeri me një shpejtësi të mahnitëshme në vjeshtë, të cilën e shtron me bar të thatë për futjen e të cilit hyn mbrapsht në galeri duke e mbajtur barin me këmbët e para. Këlyshët lindin të verbër, të shurdhër e me barkun pa qime dhe qëndrojnë kështu për 28-35 ditë. Pjell gjithësej 2-7 këlyshë, të cilët ushqehen me qumësht për 2,5-3 muaj.

Gjatë kohës, që është me të vegjël, familja mbahet nën kontroll nga femra, e cila merr përsipër edhe stërvitjen e të vegjëlve. Sjellje tipike e familjes së baldosës, gjatë lëvizjeve të gjata, është i ashtuquajtur “*vrapimi në kolonë indiane*”, e cila ka në krye nënën, ndërsa këlyshët që vijnë pas lidhen midis tyre me nënën duke kapur e shtrënguar midis dhëmbëve bishtin e atij që është përpara. Këlyshët bëhen të pavarur në moshën 6 mujore, kurse të aftë për riprodhim në moshën 1,5-2 vjeçare. Konsumon kërmij, insekte, larva, vezë e zogj të vegjël, këlyshë lepur, por edhe ushqim bimor si misër, rrush, fruta të ndryshme, ehuj, lënde, kërpudha, tubera dhe filiza të njomë. Është më pak i specializuar për konsumimin e mishit.

3. Dhelpra (*Vulpes vulpes*)



- Gjatësia e përgjithëshme e trupit:80-90cm;
- Gjatësia e bishtit:30-40cm;
- Lartësia në shpatull:35-40cm;
- Gjatësia e këmbës së pasme:12-16cm;
- Pesha: 2-7kg (max 10kg).

Ngjyra në përgjithësi e kuqeremtë, me variacione duke qënë shpina e kuqeremtë, kurse pjesët e poshtëme të trupit mund të jenë të bardha në të verdha ose të erëta, gri deri në të zezë. Maja e bishtit është e bardhë. Pjesët e poshtëme të veshëve dhe ekstremitetet e këmbëve të zeza. Tek dhelpra haset fenomeni i albinizmit dhe melanizmit. Këlyshët janë ngjyrë kafe të erët me një njollë të bardhë në gjoks dhe në ballë. Ndron qimen vetëm në pranverë. Gjurma e dhelprës ka dimensionet 6x4cm. Zëri i Dhelprës është murmuritje ose lehje. Nën bisht, 7-8cm nga rëza , ka një gjëndër aromatike me sekrecion të jashtëm. Dhelpra është kafshë jo e shoqërushme, e muzgut dhe e natës, me përjashtim të periudhës së riprodhimit dhe kur zona është e qetë. Ditën pushon në shkure të dendura, në zgavra drurësh etj. Noton mire. Armiqtë e Dhelprës janë Ujku, Shqiponja e malit, Bufi i madh, si dhe tërbimi. Dhelpra ka një areal mjaft të gjërë në plan botëror. Në Evropë gjëndet thuajse kudo me përjashtim të Maltës, Kretës dhe Islandës. Dhelpra është besnike e vëndit ku ka lindur. Për t’u riprodhuar, në kushte natyrore, një çift dhelprash ka nevojë për një teritor prej 3-8km². Monogam dhe kryqëzimi ndodh në strofkë, në Janar-Shkurt. Strofka është një galeri me një të zgjeruar me dy ose më shumë hyrje, të cilën e hap vetë duke e përdorur për disa vjet rrjesht ose me interval. Mund të qëllojë që të ndodhet në të njëjtën strofkë në galeri që lidhen, por në të zgjeruara të veçanta së bashku me Baldosën dhe Macen e egër. Bara zgjat 52-53 ditë e cila fillon në Shkurt. Pjell në Prill-Maj në të zgjeruarën e strofkës 4-6 këlyshë të cilët për 12-14 ditë janë të verbër. Në 3-4 javët e para të jetës këlyshët ushqehen vetëm me qumësht. Në këtë faze femra nuk e lejon mashkullin t’u afrohet këlyshëve, por pranon prej tij ushqimin që ai bie. Pastaj njëlloj si tek Ujku ata fillojnë të hanë ushqim gjysëm të tretur e pastaj të pa tretur. Megjithatë dhënia e qumështit vazhdon deri në 3 muaj.

Në fund ata shkojnë me prindërit në gjueti për të mësuar. Këlyshët arrijnë moshën e maturitetit në një vit. Dhelpra femër është në gjëndje të riprodhohet deri në moshën 10 vjeçare, ndërsa mashkulli pak më gjatë. Ushqimi bazë i Dhelprës janë minjtë, por konsumon edhe insekte, bretkoca, larva, peshk, shpendë të buta ose të egra, lepuj, këlyshë derri ose kaprolli, vezë si dhe ushqim me origjinë bimore si rush, mollë, dardha, kumbulla etj. Për këtë mënyrë jetese Dhelpra, njëlloj si ujku dhe çakalli, stërvit të vegjëlit e saj, duke i marrë në gjueti e duke iu mësuar mënyrën e të ushqyerit dhe të kapjes së presë. Në këtë proces marin pjesë të dy prindërit.

4. Derri i egër (*Sus scrofa*)



- Gjatësia e përgjithshme: 90-180cm;
- Gjatësia e bishtit: 20-30cm;
- Lartësia në shpatull: 70-100cm;
- Peshë: 60-150kg, (disa 200kg, e rrallë 300kg);
- Jetëgjatësia: 10 vjet.

Duke patur një përhapje shumë të gjërë Derri i egër ka më se 36 nënspecie, dhe takohet në Kroaci, Bosnjë, Serbi, Kosovë, Shqipëri, Bullgari dhe Greqi. Ngjyra e trupit është e murme e hirtë ose e murme në kafe në të zezë, ndërsa qimja e dendur, por e ashpër. Këlyshët kanë qime më të buta ngjyrë kafe në të verdhë, me breza gjatësorë ngjyrë të hapur që zhduken nga muaji i 5-6 i jetës. Tek Derri haset fenomeni i albinizmit. Dimorfizmi seksual shprehet tek dhëmbët e qenit, të cilët janë më të fuqishme e dalin më shumë nga goja tek mashkulli. Zëri i Derrit të egër është njëlloj si i Derrit të butë. Vrapon me trokth si rregull me një shpejtësi prej 20km/orë, por në rast nevojë mund të vrapojë me shpejtësi më të madhe që mund të arrijë në maksimum 70km/orë. Në rajonin e barkut ka 6 palë sisë. Gjurmët kanë dimensionet 9x6cm dhe në to dallohen si gjurmët e thundrave të mëdha, ashtu dhe ato të thundrave të vogla. Janë shumë të zhvilluara shqisat e nuhatjes dhe ndëgjimit e më pak të shikimit. Noton mirë. Te kjo kafshë është shumë e zhvilluar ndjenja e familjes, po kështu ajo e jetës shoqërore dhe e jerarkisë. Normalisht tufat e Derrave formohen në Nëntor dhe përbëhen nga një femër me këlyshët tashmë të ndarë (këputur) plus bijat e saj, të një ose dy vitesh më parë me këlyshët e tyre gjithashtu të ndarë dhe afërsisht të të njëjtës moshë plus meshkuj deri 1,5 vjeçarë si dhe femra shterpa që kanë lidhje gjaku dhe udhëhiqen nga një femër e rritur me përvojë. Tufat kanë teritorin e tyre të kullotjes, i cili mbrohet në kufijtë e tij nga tufat e tjera. Në modhën 18 mujore meshkujt formojnë tufa të veçanta, pa jerarki e që prishen shpejt. Meshkujt e rritur bëjnë jetë të vetmuar dhe mund të pranojnë shoqërinë e një ose dy meshkujve të rinj të nënshtruar, të cilët i afrohen femrave vetëm në periudhën e kryqëzimit. Çdo mashkull i maturuar, në periudhën e kryqëzimit, krijon sipërfaqen e tij të influencës me një numër femrash që i zotëron.

Në dimër flenë në pyll duke u vendosur ngjitur përbri njëri tjetrit, kurse në verë veç e veç. Në Evropë gjëndet në të gjithë kontinentin, me përjashtim të pjesës veriore. Në vëndin tonë gjen kushte zhvillimi prej bregut të detit deri në zonat e larta malore, por optimumin e ka në zonën e dushqeve. Është kafshë e muzgut dhe e natës, që ushqehet në pyjet fletorë dhe fshihet e fle në imshtat (makie, shkurre) e dendura. Preferon pyjet me shtrirje të madhe sepse do qetësi. Dikur rigorozisht kafshë pylli, Derri i egër sot gjëndet kudo mjafton ti plotësohen kërkesat e tij për ushqim, për vënde me ujë e baltë për tu zhgryer dhe për imshtaja ose makje të dendura për tu fshehur. Dëndësia normale në kushte bio-ekologjike normale është 0,5-1 Derra për 100 hektarë. Poligam (shumë partner), mbas luftës midis meshkujve për të zotëruar teritore të riprodhimit e për pasojë femrat. Në muajin Dhjetor ndodh kryqëzimi. Bara vazhdon 15 javë, mbas të cilës ndodh pjellja në Prill-Maj në strofkë e cila është në fakt një gropë natyrale e shtruar me gjethe e myshk brenda një imshtaje të dendur. Pjell 3-6(10) këlyshë të cilët e kanë shikimin që në lindje. Për dy javët e para gjatë të cilave këlyshët pijnë vetëm qumësht nëna dhe të vegjëlit qëndrojnë në imshtën e dendur ku janë lindur dhe dalin prej aty vetëm kur “*imprintingu*” të ketë përfunduar. Në këtë kohë këlyshët fillojnë të hanë edhe ushqim, por dhënia e qumështit vazhdon mbasi këputja ndodh në moshën 5 mujore. Këlyshët braktisin strofkën qysh në lindje, të pavarur bëhen në moshën 1 vjeçare, ndërsa të aftë për riprodhim në vitin e dytë të jetës. Në kushte të mira ushqimi femrat mund të kryqëzohen qysh kur mbushin 1 vit. Konsumon ehuj, lënde lisi, bar të njomë, rizoma, patate, miser, por edhe minj, insekte, këlyshë lepuri, keca kaprolli kur mund ti kapë, etj. Në kërkim të ushqimit mund të përshkojë 20-40km në natë. Ka nevojë për ujë të pijshëm si dhe për baltë për zhgryerje.

5. Lepuri i egër (*Lepus europaeus*)



- Gjatësia e përgjithëshme:55-65cm;
- Gjatësia e bishtit:7,5-10cm;
- Gjatësia e veshëve:12-15cm;
- Pesha:3,5-5 kg;
- Jetëgjatësia:5-12,5vjet.

Sekset nuk kanë ndryshim në pamjen e jashtme. Ngjyra e zakonshme është e hirtë në të kuqeremtë e hapur e cila në dimër erësohet drejt të zezës. Këmbët e para i ka me 5 gishta të pasmet me 4. Ndër ndijimet ka të zhvilluar ndigjimin dhe nuhatjen. Zëri i maskullit është një lloj murmurime, që dëgjohet në periudhën e kryqëzimit. Këlyshët e vegjël kanë në ballë një njollë të bardhë gjatoshë e cila zhduket me ritjen e tyre. Kakërdhitë i ka kafe të mbyllur. Është i përhapur në Evropë dhe Azi.

Në vëndin tonë kudo, por më të favorshme janë zonat nga 200-400m megjithëse, mund të takohet deri edhe në 2000m lartësi. Terrenet më të përshtaçme janë ato bujqësore të alternuara me pyje të cilët të zenë 10-15% të sipërfaqes. Rrezja e lëvizshmërisë është 1-3km. Lepuri i egër është kafshë e muzgut dhe e natës, jo e shoqërueshme, po të mos shqetësohet lëviz edhe ditën. Pengesat nuk i kapërren, por i përshkon. Lepuri i egër është një kafshë që mëson lehtë, kështu po qe se i shpëton një rreziku ruhet gjithmonë prej tij edhe kur ai nuk është më. Vrapon duke bërë rrathë, që kryqëzohen me një shpejtësi maksimale prej 60-70km/orë. Noton rrallë dhe vetëm kur detyrohet. Tek lepurit i egër mund të hasen individë që sillen si poligamë, por edhe individë që kanë natyrë monogame. Periudha e riprodhimit është Janar-Gusht. Femra në afsh lëshon gjurmë sekrecioni nga gjëndrat ano-gjenitale dhe ato të kokës. Këto të fundit gjenden në gojë prandaj femra lëpihet për të shpërndarë aromën e kësaj gjëndre. Të njëjtin qëllim ka edhe kalimi i këmbëve të para mbi fytyrë ose të fërkuarit e fytyrës mbas shkurreve. Të gjitha këto nxisin mashkullin për riprodhim. Foleja është një gropë natyrale e mbrojtur dhe fshehur në mes të shkurreve dhe drurëve. Bara zgjat 42-43 ditë. Këlyshët lindin të veshur me qime dhe me sytë hapur, të cilët femra i pjell veç e veç. Pak ditë pas pjelljes ka një kryqëzim të ri deri sa brenda një periudhe riprodhimi lepurit i egër mund të bëjë 3-4 barqe këlyshësh. Numri i këlyshëve në një pjellje është 2-5. Këlyshët 5 ditët e para pijnë vetëm qumësht, pastaj fillojnë të hanë nga pak ushqim mbasi dhënia e qumështit vazhdon rreth 3 javë. Në moshën 5-6 javore këlyshët bëhen të pavarur. Konsumon bar të freskët, hasëlle, degëza, sythe, lëvore, llastarë e fruta etj. Pi rrallë ujë, sepse atë e siguron nga jeshillëku dhe vesa. Konsumon gjithashtu edhe kafshë të vogla të ngordhura, insekte si dhe disa lloje kakërdhish të vetat.

6. Kaprolli (*Capreolus capreolus*)



- Gjatësia e përgjithshme: 95-135cm;
- Lartësia në shpatull: 63-73cm;
- Bishti: pa bisht;
- Pësha: ♂17-30kg; ♀13-22kg;
keci porsapjellë 1,2-1,6 kg ,
1 javor 2kg, 4-5 javor 3,5kg , 8-9 muaj 9-12kg;
- Jetëgjatësia: 15-17 vjet.

Midis mashkullit dhe femrës nuk ka ndryshime në pamjen e jashtëme me përjashtim të brirëve që i ka vetëm i mashkulli. Gëzofi është i kuq në kafe, me qime më të shkurtër e më të rrallë në verë dhe i hirtë i mbyllur në kafe, me qime më të dendur e më të gjatë në dimër. Buza e sipërme e Kaprollit është e zezë, kurse e poshtmjia dhe mjekra e bardhë. Sytë i ka të mëdhenj e me shkëlqim të kadifenjtë.

Njolla e bardhë rreth anusit është më e madhe tek femra dhe ka formën e zemrës, kurse tek mashkulli më e vogël dhe me formën e veshkës. Ndër shqisat ka të zhvilluara nuhatjen dhe ndëgjimin e më pak shikimin. Kaprolli është kafshë dite që i qëndron besnik vëndit të jetesës. Ka shumë të zhvilluar instiktin e teritorializmit dhe nëqoftëse nuk ndiqet, s'ka pretendime për qetësinë. Ndron qimen dy here në vit, në Prill-Maj dhe në Tetor. Kaprolli mund të kërcejë deri 2m në lartësi dhe 6m në gjatësi. Kur ndiqet në distancë të shkurtëra mund të vrapojë me shpejtësi deri 70 km/orë. Gjurmët e kaprollit sikurse për të gjitha kafshët e tjera janë element determinimi. Në pranverë dhe verë kaprolli është kafshë e pa shoqërushme, ndërsa në vjeshtë dhe në dimër e shoqërushme, duke formuar grupe prej 10-15 krerësh. Është i përhapur në Evropë dhe Azi. Në vëndin tonë gjëndet në pyjet e Vermoshit, Selcës, Munellës, Gojanit, Fanit, Tropojës, Bizës, Stërblevës, Stravajt, Hotovës, Tomorrit etj. Kaprolli është kafshë e anëve të pyllit, pyjeve të ndërprera me çeltira dhe e vëndeve të hapura. Preferon pyjet e përzjerë me nënpyll të pasur, po kështu pyjet e rinj dhe zonat me shkure. Dëndësia normale e një zone kaprolli të mbarështruar është 5-25 kaproj për 100ha. Kafshë poligame tek kaprolli mashkulli përkufizon territorin e tij, duke fërkuar brirët pas shkureve qysh në Prill-Maj. Madhësia e territorit është e ndryshme duke varjuar nga 5-10ha në zonat më të mira në 20-30ha në ato më të varfra. Në zonë nuk lejohen meshkujtë tjerë veç se kur janë shumë të nënështruar. Kryqëzimi ndodh në Korrik-Gusht gjë që diktohet nga egzistenca e shtigjeve të shkelura reth grupeve të drurëve ose shkureve që krijohen nga ndjekja e femrës nga mashkulli. Si rregull meshkujt luftojnë midis tyre për zotërimin e femrës të cilën mbas kryqëzimit e braktisin për të bërë një kryqëzim të ri. Me përfundimin e fazës së kryqëzimit meshkujt bëjnë jetë të vetmuar. Mbas fekondimit veza qëndron 4 muaj e pa zhvilluar, pastaj fillon zhvillimin i cili përfundon mbas 5,5 muajsh. Ka femra që kryqëzohen në Dhjetor dhe në këtë rast veza fillon zhvillimin menjëherë i cili përfundon për 5,5 muaj. Kaprolli pjell 2 (më rallë 1-3) keca, në periudhën Prill-Qershor, në një pyll të dendur, veç e veç të cilët lindin me shikim dhe mbas 3-4 orësh çohen dhe pijnë qumësht. Kecat kanë ngjyrë kafe në të kuqeremtë me rrjeshta njollash të bardha në shpinë të cilat zhduken pas 6 javësh. Dy javët e para, kur ata pijnë vetëm qumësht nuk e ndjekin dot nënën e tyre prandaj me çfaqjen e një rreziku me shënjën e saj shtrihen në tokë, duke qëndruar të pa lëvizur ndërsa nëna mer rrezikun mbi vehte. Mbas kësaj moshe kecat marrin vrapin njëlloj si kaprolli i rritur. Dhënia e qumështit vazhdon rreth 50 ditë edhe pse kecat fillojnë të hanë edhe ushqim të gjelbër. E gjithë puna për ushqimin dhe kujdesin e kecape kryhet nga femra. Kecat bëhen të pavarur në pranverën e ardhëshme, kur të mbushin 1 vjet. Pjekurinë seksuale e arrijnë në moshën 2 vjeçare, ndërsa zhvillimin e plotë meshkujt e arrijnë në moshën 3-4 vjeçare, kurse femrat 2-3 vjeçare. Për kaprollin një rëndësi të veçantë ka trofeu i cili përbëhet nga brirët. Tek kecat meshkuj, brirët e para dalin në Gusht-Shtator dhe rrëzohen në Nëntor-Janar. Në vitet që vijnë në vazhdim brirët formohen në Shkurt-Mars, fërkohen për t'u pastruar nga lëkurëzat në Mars-Prill dhe rrëzohen në Tetor-Nëntor e kjo përsëritet çdo vit. Është konstatuar se zhvillimi maksimal i brirëve arrihet në moshën 5-6 vjeçare, kurse pas moshës 7-8 vjeçare vërehet një regres i vazhdushëm. Kaprolli ka shumë kërkesa ndaj ushqimit. Kafshë barngrënëse, por e zgjedh ushqimin duke mos kullotur rradhë. Në pranverë preferon gjethet e buta të drurëve, kotiledonet e ehujve të mbirë, tërfil, barëra të ndryshme të

egra ose të kultivuara, lënde lisi, ehuj ahu, mollë etj. Në dimër konsumon bisqe, gjethe lisi dhe ahu të thata, likene, hasëlle etj.

7. Ketri (*Sciurus vulgaris*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 32-45cm;
- Bishti: 14-24 cm;
- Pesha: 230-480g;
- Jetëgjatësia: 8-10 vjet.

Ketri është çfaqur në Evropë përpara akullnajës Würm. Lloj me origjinë palearktike. Sot paraqitet në arealin e tij disa nënspecie.



Gëzofi është i kuqeremtë, në verë dhe kafe në gri, nganjëherë gati i zi, në dimër, kurse pjesa e poshtëme e trupit e bardhë. Në dimër në majë të veshëve ka një tufë qimesh të gjata. Ketri ndron qimen në pranverë. Këmbët e pasme i ka më të gjata se të parat, kurse bishtin e ka të gjatë e me qime të gjata. Është kafshë dite, që nuk hyn në letargji, por në kohë të keqe mund të rrijë disa ditë në fole pa dalë fare. Këmbët e para i ka me 4 gishtërinj, të pasmet me pesë. Gjurmët e Ketrin mund të vihen re në tokë ose në borë të freskët si për të ecurit normal ashtu dhe për vrap, të cilat i ka që të dyja me kërcime. Është kafshë dite e shoqërushme, kurse natën e kalon në strofkë. Në mëngjez çohet shumë herët dhe gjatë ditës pushon disa here. Bën kërcime të gjata dhe kacaviret me lehtësi, duke ecur edhe me kokën poshtë. Jashtë periudhës së çiftëzimit meshkujt formojnë grupe të vogla. E dëmtojnë Zardafi, Macja e egër dhe falkoniformët (shpendët grabitqarë). I përhapur në Evropë dhe Azi. Në vëndin tonë është i përherëshëm. Gjendet kudo në pyje, në malet e lartë, deri në zonën kodrinore, por nuk ngjitet më shumë se 2000m lartësi. Preferon pyjet halorë, por gjendet edhe tek fletorët, ndërsa kur nuk shqetësohet gjendet edhe në parqe e kopsht, brenda qëndrave të banuara. Lloj monogam, kryqëzimi ndodh në periudhën Janar-Qershor. Meshkujt luftojnë për zotërimin e femrës. Bara zgjat 36-42 ditë. Këlyshët pillen në strofkë 1-8 dhe janë të verbër për një muaj. Strofka ndërtohet në formë sferike me diameter 20-50cm me degë e degëza e cila brenda shtrohet me bar, myshqe e qime. Shpesh mund të shfrytëzohet çerdhet e korvideve si të laraskës etj. Dhënia e qumështit vazhdon 5-6 javë, kurse në moshën 7-8 javëshe bëhen të pavarur. Ketri pjell 2-3 herë në vit. Maturiteti i këlyshëve arrihet në një vit. Konsumon fara halorësh, lënde lisi, fruta pylli, kërpudha, bar, lëvore druri e më pak larva milimgonash dhe vezë shpendësh që folezojnë mbi drurë ose zogj të vegjël të porsaçelur dhe insekte. Ka zakonin të grumbullojë ushqime në strofkë që i konsumon pastaj gjatë dimrit ose kur ato mungojnë.

1. Shqartheni-Kunadhja gushëbardhë (*Martes foinea*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 40-50cm;
- Gjatësia e bishtit: 23-26cm;
- Lartësia në shpatull: 13cm;
- Këmbe e pasme: 8-9cm;
- Pështa: 1,1-2,3kg;
- Jetëgjatësia: 10 vjet.



Ngjyra e gëzofit është kafe në gri, kurse në gjoks ka një njollë të bardhë që shtrihet edhe në dy këmbët e para. Putrat i ka pa qime, kështu që gjurmët e kunadhes janë të qarta në tokë të butë dhe në dëborë. Ndër ndijimet më të zhvilluar ka shikimin dhe pastaj nuhatjen. Jashtëqitjet i ka në formë presjesh të holla e të zeza. Kunadhja konsiderohet më shumë kafshë e mbrëmjes dhe e natës. Lëviz edhe ditën, por më pak se Zardafi. Është kacavjerëse e mirë, por hipën në drurë më rrallë. Në vënde të caktuara grumbullon ushqime për dimër. Armiq natyralë ka Shqiponjën e malit, Bufin e madh, Dhelprën dhe tërbimin. Edhe Kunadhja si Zardafi zbutet me lehtësi. Është e përhapur në Evropë dhe Azi. Në Evropë gjëndet në të gjithë kontinentin, me përjashtim të pjesës Veriore dhe të ishujve britanikë. Në vëndin tonë është kafshë e përherëshme dhe më e shpeshtë se Zardafi, duke jetuar në zona më të ulta. Jeton në guroret e braktisura, shpatet e kodrave dhe maleve me gurë, por edhe në pyje të këtyre zonave deri 2000m lartësi. Nganjëherë mund të haset edhe afër qendrave të banuara. I qëndron besnik vëndit të jetesës. Monogam, kryqëzimi ndodh në Korrik-Gusht. Bara zgjat 8,5 muaj (230 ditë), por edhe në këtë rast veza e fekunduar mbetet e pa zhvilluar për një kohë të gjatë. Zhvillimi i vërtetë i embrionit bëhet brenda një muaji. Pjellja e këlyshëve ndodh në Mars-Prill në strofkë, e cila vendoset në një zgavër natyrale druri ose shkëmbi që rregullohet nga femra. Këlyshët lindin të verbër e të shurdhër për 34-38 ditë. Këlyshët 2-5 në numur, deri 7 javë ushqehen me qumësht, pastaj fillojnë të hanë edhe ushqim që ju sillet nga prindërit. Këputja ndodh në moshën 90 ditore, kurse të pavarur bëhen kur i afrohen moshës 4 mujore. Pjekurinë seksuale e arrijnë në moshën 1-2 vjet, moment kur arrijnë dhe peshën e të riturve. Konsumon minj, këlyshë lepuri, shpendë të egra dhe të buta, kërma, vezë, mjaltë, por edhe fryta të ndryshme. Konsiderohet si një kafshë gjaksore, e cila kur gjahu është i bollshëm vret më shumë nga sa ka nevojë për tu ushqyer. Është shumë e kujdesëshme dhe ndron territor gjuetie, kur konstaton se dikush e ndjek, duke u larguar me kilometra të tëra.

C. SHPENDËT

1. Huta (*Buteo buteo*).

- Gjatësia e përgjithëshme: 51-57cm ;
- Krahu: 7,8-25,5cm;
- Hapja e krahëve: 113-128cm;
- Pesha: ♂ 550-850g; ♀ 700-1200g;
- Jetëgjatësia: 25 vjet.



Ndër rrëmbenjësit e ditës Huta është më i denduri. Pa dimorfizëm seksual, ngjyra e përgjithëshme e trupit është kafe e mbyllur me njolla të bardha në bark dhe në pjesën e poshtëme të krahëve. Numuri i njollave është i ndryshëm nga individi në individ. Në bisht ka breza transversale të ngushtë në ngjyrë kafe dhe hiri mjaft të dendur. Lëkura në bazën e sqepit dhe këmbët janë të verdha, sqepi afërsisht i zi, sytë të murme në të kuqeremta ose të verdhërreme. Shpend i qëndrueshëm. Huta mendohet se ka shikimin më të shkëlqyer ndër shpendët rrëmbenjës. Në pjesën më të madhe të Evropës është e përherëshme, por në pjesën veriore të kontinentit është vetëm veronjëse, në dimër zbresin në Jug një pjesë deri në Afrikën e veriut. Në vëndin tonë është i përherëshëm, kurse në dimër më me shumicë. Haset dhe folezon kudo nga zonat e ulta deri në male. Biotopi i saj janë pyjet, sidomos ato të fletorëve si dhe fushat, vëndet djerë, livadhet kënetorë, luginat e lumenjve. Monogam në pranverë, në periudhën e kryqëzimit, fluturon në lartësi të mëdha, duke formuar rrathë pa rrahur krahët e duke nxjerë klithma karakteristike. Çerdhen e ndërton mbi drurë të lartë, në bigëzimin e degëve kryesore, të cilën e ndërton me degë e degëza të thata e pastaj material të butë, të cilën e përdor për disa vjet duke e riparuar. Nuk okupon çerdhet e të tjerëve. Në Mars-Prill femra pjell 2-4 vezë, me dimensione 5,7x4,6cm, të bardha, me njolla të hirta të kuqeremta e kafe. Inkubacioni vazhdon 35 ditë, ndërsa zogjtë janë nidikolë² për 6-7 javë. Megjithëse në moshën 1,5-2 mujore fluturojnë vazhdojnë të mbeten të varur nga prindërit për problemin e ushqimit deri në fund të verës. Pjekurinë seksuale e arrijnë në moshën 2 vjeçare. Konsumon minj, lepuj, reptile, brekoca, insekte, kërma dhe rallë shpendë. Kap në fole të vegjëlit e lepurit dhe të shpendëve që folezojnë në tokë si thëllëzat, shkurtat etj.

²Shpendët që nuk braktisin folenë përnjëherë dhe të vegjëlit qëndrojnë deri në momentin që janë të aftë për të fluturuar, quhen "nidikolë".

2. Shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 76-79cm;
- Krah: 60-65cm;
- Hapja e krahëve: 204-220cm;
- Pesha: ♂2,8-4,5kg, ♀3,8-6,7kg;
- Jetëgjatësia: 25 vjet.



Nuk ka dallime në ngjyrosje midis mashkullit dhe femrës. Ngjyra e përgjithëshme kafe e mbyllur me përjashtim të kokës dhe pjesës së sipërme të qafës, të cilat janë bojë bronxi. Barku është më i erët kurse rëza e bishtit është ngjyrë hiri tek të riturit dhe e bardhë tek shpendët më të rinj. Të rrinjtë kanë gjithashtu ngjyrë kafe më të erët se të rriturit, kurse në krahë kanë njolla të bardha.

Baza e sqepit dhe gishtat janë të verdha, sqepi i murrmë në gri, ndërsa sytë dhe tarsi të murrme. Monogam, çiftet formohen për të gjithë jetën. Folenë e bën në zgavra shkëmbenjsh të thepisur, (në kufirin e sipërm të vegjetacionit pyjor), të madhe me thellësi 90cm dhe diametër 2-3m. Në muajin Mars-Prill femra pjell 2 vezë, me dimensione (7,7x6cm) e ngjyrë të bardhë në gri ose të verdhëremë me njolla kafe të erët dhe të kuqeremta. Inkubacioni vazhdon 45 ditë dhe fillon mbas pjelljes së vezës së pare, gjë që bën që të vegjlit të kenë diferencë në moshë arsye për të cilën më i vogli shpesh nuk arin të mbijetojë. Në moshën 68 ditëshe zogjtë fillojnë e dalin në buzë të çerdhes, ndërsa fluturojnë dhe bëhen të pa varur në moshën 11 javëshe. Zogjtë e Shqiponjës së malit bëhen të aftë për riprodhim në moshën 4-6 vjeçare. Territori i folezimit ka rreze të madhe (reth 12 km) brenda të cilit ajo nuk lejon të folezojë çift tjetër. Në mungesë të shkëmbinjve të përshtaçëm për folezim çerdhen mund ta bëjë edhe mbi drurë të lartë. Për të gjitha këto arsye Shqiponja shtohet shumë ngadalë. Si rregull ha mish të freskët e më rrallë kërma. Gjuan lepuj, kecat e Dhisë së egër, të Kaprollit, rosa dhe vertebrorë të tjerë. Arin të ngre me kthetrat e saj deri 3,5-4kg. Në rast nevoje, për mungesë ushqimi, mund të konsumojë edhe breshka. Është e përhapur në Evropë, Azi, Afrikën veriore dhe Amerikën e veriut. Në Evropë është e përherëshme dhe dimëronjëse. Në vëndin tonë është i përhershëm dhe i zakonshëm, duke qënë shpend tipik i zonave të larta malore, me shkëmbenj, kullota dhe pyje. Në dimër, kur koha keqësohet shumë, zbret në zona më të ulta, por gjithmonë larg vëndbanimeve të njeriut.



3. Thëllëza e malit (*Alectoris graeca*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 33-36cm;
 - Krahë: 15-17cm;
 - Hapja e krahëve: 45-55cm;
 - Peshë: 400-800g;
- Jetëgjatësia: 5-6 vjet; në robëri mbi 10 vjet.

Pjesa e sipërme e trupit e përhime në të murrme e shpëlarë me një ngjyrë të kuqe si të uthullës. Gushën e ka të bardhë të rrethuar nga një brez i zi, kraharorin të përhimë të shpëlarë nga nuanca e uthullës, kurse barkun ngjyrë kanelle të zbehtë. Në hijet puplat përshkohen nga rripa të përhimë, të zinj, të bardhë të verdhë dhe ngjyrë gështenje, që pasojnë njëri tjetrin. Pendët e para të fluturimit i ka të murme, me mjekrën e jashtëme ngjyrë ndryshku të çelur, kurse pendët e bishtit ngjyrë kanelle me përjashtim të çiftit të mesit. Sqepin, rrethin e syve dhe këmbët i ka të kuqe. Femra në ngjyrosje është si mashkulli, por diçka më e zbehtë dhe më e vogël. Tek shpendët e reja, të pa maturuara, mungon rripi i zi i gushës. Thëllëza e malit preket nga dukuria e albinizmit³. Thëllëzat e malit kanë zakon të zgjohet herët në mëngjes dhe të fillojnë këngën, si dhe të zhgryhet në pluhur. Ndron pendët mbas riprodhimit në Korrik-Gusht. E dëmtojnë të gjithë llojet e rëmbenjësve. Thëllëza e malit është një shpend autokton i Evropës Jugore. Vëndi ynë gjëndet në qëndër të përhapjes natyrale të saj, gjë që shpjegon vitalitetin e madh dhe plasticitetin e lartë ekologjik që ky lloj ka në vëndin tone. Takohet nga Jugu në Veri, nga bregu i detit e deri në 1500-2400m, kudo ku i sigurohet minimum i kërkesave të saj ndaj biotopit, qetësisë dhe ushqimit. Duke që në lloj i përherëshëm në dimër spostohet në kuota më të ulta. Biotopi i saj janë faqet malore me gurë, sigomos gëlqerorë të veshur me pak shkure. Më me shumicë gjëndet në pjesën Jugore e Jug-Lindore të vëndit. Shpend monogam, gjatë dimrit jeton në tufa, ndërsa nga gjysma e dytë e Shkurtit-fillimi i Marsit fillon të formojë çifte. Folenë e ndërton në tokë, në mes të vegjetacionit rrëzë shkureve ose nën strehimin e gurëve, midis barishteve të ndryshme etj. Ndërton fole të thjeshtë pa shumë kujdes. Depozitimi i vezëve fillon qysh në ditët e fundit të Prillit dhe vazhdon deri nga dhjetëditori i dytë i Qershorit. Pjell gjithsej 8-14 vezë me interval pjelljeje një në 2-3 ditë, me ngjyrë të bardhë në të verdhë, pa njolla ose me njolla shumë të vogla në ngjyrë të kuqeremtë në të murme me dimensione 4,0x2,9cm. Inkubacioni zgjat 24 ditë. Gjatë pjelljes dhe ngrohjes së vezëve femra tregohet shumë e kujdesshme dhe e lidhur me folenë. Largohet prej folesë vetëm kur rreziku është shumë afër. Mashkulli, i cili nuk merr pjesë në ngrohjen e vezëve, qëndron rrotull folesë mbi ndonjë gur dhe këndon, duke marrë mbi vehte

³Albinizmi përfaqëson një grup të anomalive gjenetike, që lidhen me sintezën e melaninës; rrjedh nga latinishtja "albus" që do të thotë "i bardhë".

rezikun dhe mbasi rreziku largohet rikthehet në teritor. Zogjtë janë nidifugë (të pavarur disa ditë pas lindjes).

Femra i mban zogjtë në fole dhe rrotull saj rreth 4 ditë, pastaj ata ndjekin nënën e tyre në kërkim të ushqimit. Nga dhjetëditëshi i fundit i Korrikut zogjtë fillojnë të fluturojnë mirë, kurse në Tetor familjet bashkohen për të formuar tufa prej 15-20 krerësh, të cilët kështu kalojnë dimërin. Ushqimi përbëhet nga fara graminoresh e më pak leguminozesh të egra dhe të kultivuara si dhe nga insekte e invertebrorë të tjerë të vegjël. Njëherazi gëlltit edhe guralecë për tretjen e ushqimit. Shumëkush ka dëgjuar të flitet për zërin e thëllëzës, i cili dëgjohe në të zbardhur të ditës atje ku ka thëllëzë. Nga vëndet shkëmbore ku zakonisht thëllëzat kalojnë natën ato zbresin më poshtë për të kullotur, ndërsa në orët e mesditës u drejtohen burimeve dhe rrëkeve për të pirë e pastaj vëndeve të fshehura nëpër shkurre e në të çarat e shkëmbinjve për të pushuar.

D. ZVARRANIKËT

1. E Bukura e Dheut (*Salamandra salamandra*).

Është e zezë me pika të verdha ose vija në një shkallë të ndryshme. Nganjëherë mund të shfaqen hije të kuqe dhe portokalli, ose përzierjen me të verdhë, sipas nënspecifikimeve. Salamandra mund të jetoj edhe për më shumë se 50 vjet. Preferon pyjet gjethore, pasi dëshiron të fshihet në gjethë të rënë dhe rreth trungjeve të pemëve me myshqe.



Ka nevojë për rrjedha të vogla ose pellgje me ujë të pastër në habitatin e tyre për zhvillimin e larvave. Kalojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre të fshehur nën dru ose objekte të tjera. Janë aktivë në mbrëmje dhe natën, por në ditët me shi janë aktive edhe gjatë ditës. Dieta përbëhet nga insekte të ndryshëm, merimangat, krimbat e tokës, por herë pas here mund të hanë edhe bretkoca e reja. Peshon rreth 40gr, mund të rritet deri në 15-25cm e gjatë. Meshkujt dhe femrat duken shumë të ngjashme, përveç gjatë sezonit të mbarështimit, kur dallimi më i spikatur është një gjëndër e fryrë rreth çarjes së mashkullit. Kjo gjëndër prodhon spermatopore, të cilat i tërheq femra, duke fekunduar vezët e saja. Larvat zhvillohen brenda femrës, derisa të lindë një metamorfë (i vogël) e formuar plotësisht. E Bukura e Dheut gjenden në shumicën e Evropës Jugore dhe Qendrore. Në vendin tonë gjendet më së shumti në lartësi midis 250-1800m lartësi nga niveli i detit.



Bretkoca e pemëve (*Hyla arborea*)



**Nepërka
(*Vipera ammodytes*)**



Breshka e zakonshme (*Testudo*)



Zhaniku i zielbër (*Lacerta*)

2. PARKU KOMBËTAR DETAR KARABURUN – SAZAN

Vendndodhja: Parku Kombëtar i Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit shtrihet në kufirin mes detit Adriatik dhe Detit Jon. Parku Kombëtar Detar mbulon zonën detare përgjatë vijës bregdetare të gadishullit të Karaburunit dhe ishulli i Sazanit shtrihet në Qarkun e Vlorës. Gadishulli i Karaburunit dhe ishulli i Sazanit është pjesë e Bashkisë së Vlorës. Parku Kombëtar i ekosistemit natyror detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit është shpallur më 28 prill 2010 nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtar “Karaburun-Sazan” është 12.570,82 ha, ku zona detare pranë Karaburunit përbëhet nga 9.848,95 ha dhe zona detare pranë ishullit të Sazanit përbëhet nga 2.721,87 ha.



Zonat e Menaxhimit

Në këtë kuadër, duke pasur parasysh kushtet reale të vendit, kategoritë e menaxhimit dhe përvojat e kaluara dhe duke përdorur praktikat më të mira ndërkombëtare, sistemi i mëposhtëm i zonimit mund të përdoret.

1. **Zona Qendrore (ZQ)** ku zbatohet niveli i parë i mbrojtjes. Kjo përfshin zonat me performancë shumë të lartë natyrore, me pak ose aspak ndërhyrje nga veprimtaritë njerëzore si: 1) zona rreth ishullit të Sazanit jo më larg se 1 km nga bregu; 2) pjesa perëndimore e Karaburunit deri 200 metra larg bregut. Në pjesën veriore, perëndimore dhe jugore (deri te Kepi Jugor) të ishullit të Sazanit ka shkëmbinj nënujorë dhe formacione koralogjene shumë të rëndësishme. Ka gjithashtu shkëmbinj nënujorë interesantë në pjesën lindore të ishullit ngjitur me Kepin e Shënkollit.

Bregdeti jugor i ishullit mbulohet me livadhe të Posidonia-s. Pjesa perëndimore e Karaburunit është gjithashtu e pasur në formacione koralogjene dhe veçori interesante nënujore gjeomorfologjike, shkëmbinj nënujorë dhe shkëmbinj. Prioritet këtu është ruajtja e natyrës,

biodiversitetit (livadhet e Posidonia-s, formacionet koralogjene), monumentet natyrore (Falëzat e Sazani), llojet e rrezikuara (koralit i kuq, shkëmbshpuesi, kerr/rufjo, ylli i detit, delfini i zakonshëm, breshka e ujit/breshka e detit, etj.), peizazhe unike tokësore dhe detare (shkëmbinjtë nënujorë dhe shkëmbinjtë), veçori të jashtëzakonshme natyrore gjeomorfologjike dhe paleontologjike pa ndonjë ndërhyrje mbështetëse të përhershme. Në këtë zonë zbatohet niveli i parë i mbrojtjes. Zbatimi i ligjit sigurohet nga administrata e ZM-së me anë të patrullimit dhe vënies në zbatim të rregullave dhe qasjeve rreptësisht të përcaktuara.

Veprimtaritë që nuk lejohen: Zhvillimi i veprimtarive të mëposhtme është rreptësisht i ndaluar brenda Zonës Qendrore: zhytja, noti dhe zhytja me tub ajrimi/snorkelling (plazhet dhe banjat e diellit), peshkimi, shëtitjet me varkë(ekskursionet), hedhja e spirancës, ankorimi, lundrimi, lundrimi me kajak/kaike, të gjitha llojet e sporteve ujore, trafiku detar, të gjitha llojet e zhvillimit të infrastrukturës, nxjerrja e mineraleve, mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike, zhvillimi i akuakulturës dhe të gjitha veprimtaritë ushtarake.

2. Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME), ku zbatohet niveli i dytë i mbrojtjes. Kjo përfshin zonat me performancë të lartë natyrore me habitate natyrore shumë të rëndësishme apo biotope të llojeve të rralla dhe rrezikuara. Prioritet është ruajtja e biodiversitetit, zonave natyrore dhe peizazheve me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime shpirtërore, shkencore, edukative/arsimore dhe integrimi i menaxhimit të zonës së mbrojtur me përdorimin e qëndrueshëm dhe të ekuilibruar. Zona përfshin: 1) zonën rreth ishullit të Sazanit që nuk përfshihet në Zonën Qendrore; 2) zonën rreth gadishullit të Sazanit nga Kepi i Shën Vasilit deri në kufirin jugor të parkut që nuk është përfshirë në zonat e tjera.

Veprimtaritë që nuk lejohen: Zhvillimi i veprimtarive të mëposhtme është rreptësisht i ndaluar brenda Zonës së Menaxhimit Efektiv: zhytja, noti dhe zhytja me tub ajrimi/snorkelling (plazhet dhe banjat e diellit), peshkimi, hedhja e spirancës, trafiku detar, të gjitha llojet e zhvillimit të infrastrukturës, nxjerrja e mineraleve, mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike, zhvillimi i akuakulturës dhe të gjitha veprimtaritë ushtarake.

3. Zona e Rekreacionit (ZR), ku zbatohet niveli i tretë i mbrojtjes. Kjo zonë ka një performancë të mirë natyrore. Ajo përkufizohet si një zonë që përmban territore të përshtatshme tokësore, ujore dhe detare ku kombinimi i veprimtarive, produktet tradicionale të komunitetit, bizneset dhe turizmi janë në përputhje me standardet e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Ajo përfshin: 1) zonën nga kepi i Shën Janit tek kepi i Gallovecit; 2) nga kepi i Gjuhëzës te Moli i Jugut dhe në jug deri te zona qendrore; 3) nga gjiri i Bristanit te Shpella e Duk Gjonit, dhe 4) nga plazhi i Llovizit te gjiri i Gramës deri në jug te gjiri i Shën Andreas.

Veprimtaritë që nuk lejohen: Zhvillimi i veprimtarive të mëposhtme është rreptësisht i ndaluar brenda Zonës së Rekreacionit: trafiku detar, nxjerrja e mineraleve, dhe mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike, zhvillimi i akuakulturës dhe të gjitha veprimtaritë ushtarake.

4. **Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm (ZZHQ)**, ku zbatohet niveli i tretë i mbrojtjes. Zona ka një performancë natyrore të kënaqshme. Ajo përfshin zonën e parkut nga Kepi i Shën Vasilit te Kepi i Gjuhëzës. Përparësi ka harmonizimi i mbrojtjes së biodiversitetit, natyrës dhe peizazhit nëpërmjet bashkërendimit të menaxhimit të zonës së mbrojtur me zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik. Kjo zonë duhet të mundësojë ndërveprimin e harmonizuar të natyrës dhe kulturës nëpërmjet ruajtjes së cilësisë së peizazhit, përdorimit tradicional të vazhdueshëm të burimeve, manifestimin e zakoneve tradicionale, sociale dhe kulturore, dhe shmangien dhe parandalimin ku është e nevojshme e zhvillimit të veprimtarive të papërshtatshme në madhësi dhe/ose përmbajtje. Ndërmjet qëllimeve kryesore të kësaj zone është gjithashtu sigurimi i përfitimeve ekonomike dhe kontributi në përmirësimin e jetesës së vendasve duke përdorur mallrat natyrore, shërbimet apo përfitimet që vijnë nga format e përshtatshme të turizmit.

Veprimtaritë që nuk lejohen: Zhvillimi i veprimtarive të mëposhtme është rreptësisht i ndaluar brenda Zonës së Zhvillimit të Qëndrueshëm: trafiku detar, nxjerrja e mineraleve, dhe mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike, zhvillimi i akuakulturës dhe të gjitha veprimtaritë ushtarake.

Bimësia, kryesisht kserofile, përbëhet më tepër nga lloje barishtore dhe më pak nga shkurre të rralla të llojit të makies. Duke qenë e pabanuar dhe zonë rreptësisht e ndaluar ushtarake gjatë periudhës komuniste, ishte një “tullë e gjelbër” e natyrës sonë, që dallohej për biodiversitet të lartë dhe të rëndësishëm në Mesdhe: livadhe, pyje Pishe të zezë (*Pinus nigra*) dhe Rrobulli (*Pinus peuce*, *Pinus leucodermis*), Bredhi i Maqedonisë (*Abies borisii-regis*), Ilqe (*Quercus coccifera*), Valanidh (*Quercus macrolepis*), makie mesdhetare, bimësi e shkëmbinjve detarë. Kati litoral është i shprehur mjaft mirë. Në territorin e këtij rezervati shënohet kufiri verior i aleancës *Oleo Ceratinion* dhe i qepës së detit (*Scilla maritima*).

Këtu takohen lloje endemike e subendemike si dhe lloje të rralla e të kërcënuara Tisi (*Taxus baccata*), Lojfata (*Ceratonia siliqua*) etj. Në territorin e RNM/PN janë evidencuar: 10 tipe habitatesh natyror (2 habitate parësorë), 8 lloje, floristike të rëndësishme, 5 lloje, endemike dhe 1 lloj, të Aneksit IV, të Direktivës së Habitatit. Grupimet kryesore janë ata të kullotave të thata mesdhetare, pyjeve të çlirët me valanidh (*Quercus ithaburensis* subsp. *macrolepis*) e ndonjë tjetër dushk gjetherënës, makies me Ilqe (*Q.ilex*) e më rrallë me Dafine (*Laurus nobilis*), garrigave e friganeve, të ndryshme etj.

Me interes në këtë rezervat janë lloji endemik *Sesleria albanica*, lloji i rrallë si *Crocus dalmaticus*, shkurrëza *Hypericum haplophylloides*, Tisi (*Taxus baccata*), Xhirokulli vjeshtor (*Colchicum autumnale*), etj.

PKD është gjithashtu një burim i mirë për blegtori, turizëm, ndoshta dhe veprimtari të tjera zhvilluese, por menaxhimi i tyre duhet bërë me kujdes për moskeqësimin e biodiversitetit. Kështu, nëse ka plane për krijimin e mëtejshëm të fshatrave turistike, atëherë ato duhet të mos përfshihen në kufijtë e zonës. Problem kryesor është gjithashtu prania e zjarreve gjatë verës si dhe mbikullotja.

Zona ka potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit dhe të ekoturizmit. Por fillimet e tij janë më tepër kaotike dhe spontane, që po dëmtojnë vlerat e mëdha ekologjike.

Llojet detare me interes kombëtar në zonën Karaburun-Sazan (sipas Listës së Kuqe Shqiptare 2007

<i>Leshterikët e detit</i>	<i>Gastropodët</i>	<i>Maja squinado</i>
<i>Posidonia oceanica</i>	<i>Patella caerulea</i>	<i>Paguristes oculatus</i>
<i>Cymodocea nodosa</i>	<i>Monodonta turbinata</i>	<i>Palaemon serratus</i>
<i>Leshterikët (algat e detit)</i>	<i>Diodora graeca</i>	<i>Palinurus elephas</i>
<i>Cystoseira amentacea var. spicata</i>	<i>Haliotis lamellosa</i>	<i>Penaeus kerathurus</i>
<i>Lithophyllum byssoides</i>	<i>Aporrhais pespelecani</i>	<i>Scyllarus arctus</i>
<i>Lithophyllum trochanter</i>	<i>Ranella olearia</i>	<i>Ekinodermët</i>
<i>Tenarea tortuosa</i>	<i>Charonia tritonis variegata</i>	<i>Paracentrotus lividus</i>
<i>Bornetia secundiflora</i>	<i>Zonaria pyrum</i>	<i>Ophidiaster ophidianus</i>
<i>Catenella caespitosa</i>	<i>Tonna galea</i>	<i>Centrostephanus longispinus</i>
<i>Digenea simplex</i>	<i>Dykapakorët/Bivalvorët</i>	<i>Peshqit</i>
<i>Polyphysa parvula</i>	<i>Mytilus galloprovincialis</i>	<i>Hippocampus guttulatus</i>
<i>Sfungjerët</i>	<i>Lithophaga lithophaga</i>	<i>Mola mola</i>
<i>Geodia cydonium</i>	<i>Pinna nobilis</i>	<i>Zvarranikët</i>
<i>Spongia officinalis</i>	<i>Pteria hirundo</i>	<i>Caretta caretta</i>
<i>Hippospongia communis</i>	<i>Glossus humanus</i>	<i>Fokat</i>
<i>Raspailia viminalis</i>	<i>Ostrea edulis</i>	<i>Monachus monachus</i>
<i>Petrobiona massiliana</i>	<i>Pecten jacobaeus</i>	<i>Cetacetë</i>
<i>Knidarët</i>	<i>Solen marginatus</i>	<i>Delphinus delphis</i>
<i>Aurelia aurita</i>	<i>Chamelea gallina</i>	<i>Tursiops truncatus</i>
<i>Chrysaora hysoscella</i>	<i>Tapes decussatus</i>	
<i>Actinia cari</i>	<i>Venus verrucosa</i>	
<i>Bunodactis verrucosa</i>	<i>Krustacetë</i>	
<i>Cladocora cespitosa</i>	<i>Alpheus dentipes</i>	
<i>Corallium rubrum</i>	<i>Callinassa tyrrhena</i>	
<i>Eunicella singularis</i>	<i>Crangon crangon</i>	
<i>Eunicella cavolini</i>	<i>Dardanus arrosor</i>	
<i>Anelidët</i>	<i>Eriphia verrucosa</i>	
<i>Sabella spallanzani</i>	<i>Galathea intermedia</i>	

3. PEISAZHI I MBROJTUR “VJOSË-NARTË”

Vendndodhja: Qarku i Vlorës.

Sipërfaqja totale: 19,738ha.

Statusi: Peizazh i Mbrojtur, Kategoria IV, IUCN; miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 80, datë 22.10.2004.



Figure 3- Harta e Peisazhit te Mbrojtur Vjose-Narte

Ndodhet ndërmjet grykëderdhjes së Vjosës deri në Vlorë. Përfshin zonën bregdetare ligatinore të Nartës; kodrat e Mishikarta, Ciplaku, Kisha dhe Babica e Vogël; Ishullin e Zvërnecit, Pusine Mezinë dhe Pyllin të Sodës. Bëjnë pjesë: fusha e Akërnisë, kodrat e Panajasë, rrjedhja e Vjosës, laguna e Nartës dhe e Kallëngës dhe pylli i PishëPoros. Fusha e Akërnisë, ish tokë kënetore, u zëvendësua nga toka bujqësore. Kodrat e Panajasë (246m) përbëhen nga molasa të buta, me të cilat lidhet shkalla e madhe e copëtimit të relievit, makia mesdhetare dhe ish pylli i dushkut, i kthyer në ullishta dhe vreshta. Laguna e Nartës (41,5km²) në skajin Jugu kufizohet me kodrat e ulëta terrigjene të Triportit, brezit litorali mbuluar me pisha, si dhe dy kanale me të cilë laguna komunikon me detin. Laguna ka thellësi të vogël 1,2m dhe maksimalja rreth 2m. Pjesa veriore e

lagunës është kthyer në kripore në fillimet e viteve 1950. Kriporja zë rreth 1500ha dhe ndahet nga laguna me argjinaturë. Dallohet për botë të gjallë të pasur dhe të larmishëm, kryesisht të shpendët ujqor. Laguna e Kallëngës (450 ha) është lagunë e cekët. Përdoret për peshkim, në grykën e kanalit, ku është vendosur dajlani. Pylli i Pishë-Poros, është i përmendur edhe për duna ranore, deri në 6-8m lartësi, dhe për bimësinë psamofite, higrofile dhe halofite. Pjesa kryesore mbulohet nga pylli i pishës mesdhetare. PM është i njohur për florën e veçantë dhe larminë e habitateve, me vlera të veçanta shkencore, ekologjike dhe ekonomike (bimë mjekësore, aromatike, industriale dhe dekorative). Mendohet se rriten rreth 800 bimë enësore. Takohen rreth 25 lloje bimësh të rrezikuara, ndërsa dy lloje janë endemike shqiptaresi *Orchis albanica* dhe *Orchis paparisti*; ndërsa 67 lloje cilësohen me interes ekonomik dhe shkencor. Në këtë PM, dallohen tipe të ndryshëm habitatesh: natyrore me shtrirje tepër të kufizuar; gjysmënatyrore dhe artificiale me shtrirje dominuese; habitate ujore dhe tokësore, të përbëra nga shumë nënhabitatë, si: kënetat të përkohshme e të përhershme, kanale kullimi dhe ujitjeje, rezervuarë me ujë të ëmbël, pyje aluvionale dhe të pishës, bimësi mesdhetare në ishullin e Zvërnecit dhe në kodrat rrethuese. Fundet e lagunave të Nartës dhe të Kallëngës mbulohen nga *Zostera noltii*, dhe *Ruppia cirrhosa*. Njëherazi mbizotëron bimësia halo-higrofile e përfaqësuar nga *Phragmites australis*, *Typha angustifolia* etj. Pyjet aluvionale përfaqësohen nga llojet: *Populus alba*, *Populus nigra*, *Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix amplexicaulis*, *Alnus glutinosa*, *Platanus orientalis*, *Ulmus minor*, *Ulmus glabra*, *Fraxinus angustifolia*, *Tamarix parviflora*, etj.,

Pylli i Pishës (1200ha) përfaqësohet nga disa lloje mesdhetare si: *Pinus maritima*, *Pinus pinea* dhe *Pinus pinaster*; dhe shkurret *Pistacia lentiscus*, *Erica manipuliflora*, *Myrtus communis* etj. Ishulli i Zvërnecit mbulohet nga pylli i Selvisë (*Cupressus sempervirens*) në shoqërim me *Quercus ilex*, *Quercus pubescens* dhe *Pinus* spp. *Myrtus communis*, *Pistacia lentiscus*, *Laurus nobilis* etj. PM ka larmi kafshësh: insekte, peshq, amfibë, reptilë, gjitarë dhe sidomos shpendë. Studimet tregojnë se këtu gjenden të paktën 749 lloje rruazorësh dhe pararruazorësh, si: molusqe, flutura, krahëfortë, krustace dhe ekinodermate; 9 lloje amfibësh; të paktën 102 lloje peshqish, si: Ngjala (*Anguilla anguilla*), Kocja (*Sparus aurata*), Levreku (*Dicentrarchus labrax*), Qefulli (*Mugil cephalus*), etj.; 26 lloje reptilësh, si: *Natrix natrix*, *Malpolon monspensulanum*, *Testudo hermanni* etj.; 192 lloje shpendësh, sidomos të ujit, dimërues dhe folezues. Më të zakonshme janë rosat, bajzat, karabullakët, çapkat, thëllëza e fushës, Shqiponja e madhe e rosave, Huta, Skifteri kthetraverdhë, etj. Gjatë sezonit të folezimit kthehet në vendin e shumimit për shpendët uji. Afro 88% e tyre përqendrohet në kriporet. Narta është vendushqimi për pelikanin (*Pelicanus crispus*), por takohen rregullisht flamingot (*Phenicopterus ruber*). Në kompleksin ligatinor regjistruohen 32 lloje gjitarësh, të cilët dominohen nga brejtësit, lakuriqtë e natës dhe llojet mishngrënëse. Dallohen katër lloje gjitarësh të vegjël: dy insektivorë (*Talpa caeca* dhe *Talpa stankovici*) dhe dy brejtës (*Pitymys thomasi* dhe *P. felteni*). Gjithashtu takohen: Çakalli, Baldosa, Lundërza, Lepuri i egër, Qelbësi, Nuselaleja, etj. PM strehon 26 lloje të rrezikuara në shkallë botërore dhe 189 lloje të rrezikuara në Shqipëri. Rëndësia e zonës shprehet gjithashtu nga prania e 118 llojeve të mbrojtura në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë PM ndodhen edhe katër Monumete Natyrore me vlera shkencore, ekologjike dhe turistike:

- *Dunat e Nartës*. Janë grup dunash me lartësi 5-6m e gjerësi 20-30m.
- *Laguna Limopuo*, afër fshatit Zvërnec, dallohet për biodiversitet të lartë.
- *Pylli i Zvërnecit* (rreth 7ha), veçanërisht pylli qiparisi me lartësi 10-15m e diametër trangu 30-40cm. Mes peizazhit tërheqës, ndodhet manastiri i Zvërnecit dhe kisha, të shpallur monumente kulture.
- *Rrapi i Çezmës*, afër fshatit Mifol, pranë burimit ose Çezmës së Ushtarit, mbi 100vjeçar me lartësi 15m, diametër të rreth 1m e perimetër 3m. Në këtë PM ndodhen edhe disa vlera kulturore:
- *Manastiri i Shën Marisë i shek. XVIII dhe kisha e shek. XIII-XIV* ndodhen në ishullin e Zvërnecit. Kisha është e njohur për piktura murale dhe gdhendjet në dru të luleve e kafshëve. Kisha e restauruar lidhet me bregun me urë, nëpër të cilën besimtarët dhe turistët shkojnë në ishull dhe në objektet e kultit ortodoks. Më 15 Gusht, organizohet festa e vitit. -Triporti gjendet në afërsi të fshatit Zvërnec, ka qenë port i rëndësishëm, që lidhte qendra antike, si: Aulona, Apollonia, Oriku dhe Amantia.
- *Spinarica* ishte një nga qytetet mesdhetare të Adriatikut, në afërsi të lagunës së Nartës. Ishte qendër e rëndësishme tregtare. Në PM gërshetohen larmi kushtesh të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, si: pozita gjeografike, klima, biodiversiteti, MN dhe kulture, kushte sociale e ekonomike etj. Zvërneci dhe Narta, dallohen për bukuritë bregdetare të ndërthurura me pasuritë e tyre kulturore e tradicionale, me kulinarinë e famshme të peshkut, verën e dëgjuar dhe për vajin e ullirit, të rrallë për cilësi. Ngjarje kulturore e rëndësishme janë Karnavalet e Nartës, të rikthyer. Këto ngjarje rritin atraksionin turistik. Me gjithë rritjen e kërkesës për turizëm, zhvillimin e tij e pengon mungesa e infrastrukturës, planet urbane, strategjitëjo të qarta për turizmin; vendimet e qeverisë për kërkimin e naftës; krijimi i parkut industrial dhe energjetik apo të aeroportit, dëmtojnë perspektivën turistike.

Nënzonat kryesore në brendësi të kompleksit janë: Laguna e Nartës dhe kriporet, Ish-rezervati i Pishë-Poros, Lagunat e Kallëngës, Kodrat e Panajasë dhe Fusha e Akërnise. E gjithë hapësira u shpall Zonë e Pejsazhit të Mbrojtur në vitin 2004 (Vendim i Keshillit të Ministrave Nr. 680, dt.22/10/2004). Kompleksi i Nartës është gjithashtu një nga Zonat e Rëndësishme për Shpendët (IBA) në Shqipëri.

ZONIMI

Kufijtë e zonës

Kufijte e propozuar të Pejzazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë treguar në Harten 3. Në përcaktimin e kufijve të zonës për të cilën është përgatitur Plani i Menaxhimit, është marrë në konsideratë gjëndja ekologjike, ekonomike dhe sociale.

IUCN/komisioni mbi Parqet Kombëtare dhe Zonat e Mbrojtura i ka kategorizuar zonat e mbrojtura (CNPPA) në menyre që:

1. të tërheqë vëmendjen e qeverive për rëndësinë e zonave të mbrojtura
2. të nxisë qeveritë për të zhvilluar sisteme menaxhimi për zonat e mbrojtura në përputhje me kushtet kombëtare dhe lokale
3. të reduktojë konfuzionin e krijuar nga adoptimi i termave të ndryshëm që përpiqen të karakterizojnë lloje të ndryshme të zonave të mbrojtura
4. të sigurojë standarte ndërkombëtare të ruajtjes së natyrës në nivel global dhe rajonal
5. të sigurojë një skemë për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave mbi zonat e mbrojtura, dhe

të përmiresojë komunikimin dhe të kuptuarit e palave të përfshira në ruajtjen e zonave të mbrojtura (IUCN 1994b).




Figure 4 - Harta e zonimit të Pejzazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë

Territori i Zonës së Pejshazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë ndahet në katër nënzona të mëdha (Harta 10 – Zona e Pejshazhit të Mbrojtur) :

- 1 Zona Qendrore
- 2 Zonë e Përdorimit Traditional
- 3 Zonë e Zhvillimit të Qëndrueshëm
- 4 Zona e Zhvillimit

a. **Zona Qendrore (A1 & A2).** Ajo përfshin habitate natyrore, gjysëm-natyrore, breglumore, pyje bregdetare, laguna dhe duna ranore. Zonat qendrore përfshijnë Grykëderdhjen e Vjosës, Pyllin e Pishë-Poros, lagunat e Kallëngës, një pjesë të lagunës së Nartës (Shamoduri) si dhe dy monumentet e Natyrës : Ishullin e Zverncit dhe laguna Limopua. Aktivitete në kundërshtim me qëllimin e krijimit të zonës. Këtu futet gjuetia, shaktërrimi dhe shqetësimi i llojeve të faunës dhe florës, menaxhimi i paautorizuar i habitateve, futja me makina të paautorizuara, hedhja dhe depozitimi i plehrave, derdhja e patrajtuar e ujërave të ndotur, ndërtimi i stukturave industriale, krijimi i qendrave të reja të banuara, përdorimi i kimikateve, gërmimet për zhavorr apo rërë si dhe futja e llojeve bimore apo shtazore të huaj.

b. **Zonë e Përdorimit Tradicional (B1 & B2).** Kjo nënzona u bën të mundur banorëve rezidentë të përhershëm apo sezonale në Parkun Kombëtar, të vazhdojnë mënyrën e tyre të jetesës me mjete tradicionale. Zona lejon subjektin publik të respektojë kufijtë e fushës rezidente dhe aktivitetet ekonomike. Zona përfshin tokë bujqesore (Dellinjë, Zhuke), Kripore dhe Pjesën Lindore të Lagunes së Nartës. Aktivitete në kundërshtim me qëllimin e krijimit të zonës. Këtu futet gjuetia, shaktërrimi dhe shqetësimi i llojeve të faunës dhe florës, menaxhimi i paautorizuar i habitateve, hedhja dhe depozitimi i plehrave, derdhja e patrajtuar e ujërave të ndotur, ndërtimi i stukturave industriale të pashoqëruara nga Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis si dhe futja e llojeve bimore apo shtazore të huaj.

c. **Zonë e Zhvillimit (D).** Mundëson zhvillimin e aktiviteteve të reja ekonomike me natyrë të qëndrueshme. Aktivitete në kundërshtim me qëllimin e krijimit të zonës. Këtu hyjnë gjuetia, shaktërrimi dhe shqetësimi i llojeve të faunës dhe florës, menaxhimi i paautorizuar i habitateve, hedhja dhe depozitimi i plehrave, derdhja e patrajtuar e ujërave të ndotur, si dhe futja e llojeve bimore apo shtazore të huaj.

3.1. LLOJET KRYESORE TË BOTËS SË EGËR TË PARKUT

A. BIMËT - FLORA

1. Pisha e egër (*Pinus halepensis*)



Dru jo shumë i lartë, rrallë herë arrin lartësi më të madhe se 20m, me diametër që mund të deri në 1m. Sistemi rrënjor është fillimisht boshtor, pastaj i formuar nga rrënjë shumë të thella, me fuqi të madhe depërtimi. Kërçelli, në përgjithësi, është i shtrembër, përmban shumë rrëshirë. Lëvorja në ngjyrë gri në të hinjtë në moshë të re, pastaj bëhet e murme e kuqerremtë, çahet për së gjati në formë pllakash të shumta. Druri ka blanë të verdhë të haptë dhe myje të murrmetë errët, i

rëndë, jo shumë i butë, i qëndrueshëm, me shumë rrëshirë, me rrathë vjetore të dallueshëm mirë.

Kurora është e rrallë, e rregullt, piramidale ose rruzullore shtrirë, në ngjyrë të gjelbërt hapet me reflekse të hinjta. Degët janë të forta, pak a shumë të shtrembëra, me lëvore gri të hinjtë ose të kuqerremtë. Bisqet në fillim të gjelbër, pastaj gritë hapët në të argjendë, të shogët dhe të hollë. Sythat 5-10mm të gjatë, rruzullore-konike, jo rrëshinore, të murrmetë kuqerremtë, jo të grumbulluar vetëm në majë të biskut, por edhe gjatë tij, me mëlluga të lira me kinde të bardha, shpesh të shperveshur në majë. Halat të grupuara nga 2 së bashku (shumë rrallë nga 3), (5) 6-10(15)cm të gjata dhe rreth 1mm të gjera, tepër të imta dhe jo të forta, me buzë me dhëmbëzim të rregullt, me majë të mprehtë, me vija gojëzore në të dy faqet, në ngjyrë të gjelbër të hapët, të grupuara në formë furçe në skaj të bisqeve, me kanale rrëshinore. Boçet mashkullore janë të verdha, të grupuara nga 30-40 së bashku; femëroret të gjelbra-manushaqe, janë të vetmuara ose nga dy, shfaqen Mars-Maj. Boçet e pjekura janë vezake-konike, (5)8-10(12)cm të gjata dhe 3-5cm të gjera, me bisht pak të përkulur dhe 1-2cm të gjatë, të kuqetë errëta, të shndritshme, me mëlluga me apofize pothuajse të sheshtë dhe me kërthizë të gjerë e pak të dallueshme, jo rrëshinore, piqen në vjeshten e vitit të dytë, përhapja e farave ndodh qysh në fillim të vitit të tretë, ndërsa boçet e hapura qëndrojnë edhe për një kohë të gjatë mbi degë. Farat janë 6-7mm të gjata (rreth 55000 fara/kg), të murrme të hinjta, të pajisura me një flatër të hollë, 3-4 herë me e madhe se fara (20mm e gjatë), e murrme kuqerreme Shumëzohet me farë. Për pyllëzime përdoren fidanë dhe farë. Frytifikon herët, qysh në moshën 8-10 vjeçare edhe më përpara. Është

llojtermofil, kserofil, dritëdashës, i ndieshëm kundrejt tëftohtit, kur temperatura qëndron disa ditë më poshtë se -5°C, më rezistenti, ndërmjet pishave, i kushteve ekstreme të nxehta e të thata të mjedisit mesdhetar; mund të vegjetoj edhe në terrene me 250-300mm rreshje në vit, përhapet me lehtësi dhe rritet shpejt. Është lloj me kërkesa të pakta ndaj tokës, përshtatet në të gjitha tipet e

terreneve. Lloj mesdhetar i pranishëm në të gjitha vendet e pellgut të Mesdheut, gjerësisht i kultivuar. Në vendin tonë formon grumbuj natyror të përzier me pishën e butë në Divjakë dhe Pish Poro, ndërsa e kultivuar gjendet në brezin bregdetar, në formacione shkëmbore gëlqerore e silicore të zonës Lauretum deri në 800-1000m lartësi mbi nivelin e detit. Shumë e përshtatshme për ripyllëzimin e terreneve të thatë e të degraduar. Druri gjen përdorim të gjerë në ndertimet e ndryshme, në fabrikat e përpunimit të drurit për prodhimin e lëndës së sharruar e të pllakave, për shtylla miniere dhe amballazhe, në industrinë e letrës; shfrytëzohet edhe për prodhimin e rrëshirës; lëvorja, e cila përmban deri në 23% tanin.

2. Pisha e butë (*Pinus pinea*)



Dru që arrin lartësinë 20-25m dhe diametrin mbi 1,5m. Ka sistem rrënjor sipëfaqësor dhe shkon mbi 1m, duke zhvilluar si boshtin kryesor ashtu edhe rrënjët anësore. Kërçelli është i drejtë, cilindrik, i zhveshur nga degët në të dy të tretat e poshtme. Lëvorja ka ngjyrë të kuqerreme të hirtë dhe çahet pllaka-pllaka në drurët e moshuar. Kurora me degëzim të rregullt qerthullor e të shtrirë, në drurët e rinj është rruzullore, ndërsa në drurët e rritur merr

formën karakteristike të ombrellës ose bëhet thujse e sheshtë, ku majat e degëve anësore janë në të njëjtin nivel me pjesën e sipërme të kurorës. Druri ka blanë të bardhë të kuqerremtë dhe myje të murrme, rrrathë vjetor të dallueshëm, me shumë rrëshirë, është i rëndë, i reziston shumë lagështirës. Bisqet janë gri të gjelbërreme, kur janë të rinj, nuk ka bisqe të dytë gjatë vitit. Sythat janë rreth 1cm të gjatë, cilindrike, pa rrëshirë, të murrme, me mëlluga me thekë të bardhë. Halat nga 2 së bashku, të gjata 10-20cm dhe të gjera 1,5-2mm, të forta, të mprehta, në të gjelbër të qartë, me buzë të dhëmbëzuara imët, me vija gojëzore në të dyja faqet, qëndrojnë 3-4 vjet. Boçet mashkullore janë cilindrike, të vogla, në ngjyrë të verdhë, ndërsa femëroret janë vezake, në ngjyrë të kuqe manushaqe, shfaqen nga Prilli deri në Qershor. Boçet e pjekura janë të vetmuara ose nga dy së bashku, pa bisht ose me bisht të shkurtër, vezakegjysmërruzullore (8-15x7-12cm), shumë të ngjeshura e të rënda, me rrëshirë, me mëlluga në ngjyrë të murrme të kuqerreme, të shndritshme, përfundojnë me një apofize të gjerë piramidale, me një kërthizë të sheshtë në qendër, në ngjyrë gri. Vitin e parë boçet janë shumë të vogla, rreth 1cm, në vitin e tretë arrijnë zhvillimin maksimal; qëndrojnë në degë edhe disa vjet pasi të jenë përhapur farat, piqen në vjeshtën e vitit të tretë. Fara, që quhet edhe fistik, është shumë madhe, 15-20mm e gjatë, e pajisur me një lëvozhgë kockore shumë të fortë, e mbuluar nga një pluhur i hollë e izi, me një bukë të ngrënshme përbrenda, janë të pajisura me një flatër të ngushtë (15-20x3mm). Çdo boçe

ka rreth 50 fara. Shumëzohet me farë. Për pyllzime mund të përdoren fara dhe fidanë. Pisha e butë fillon të frytifikojë që nga mosha 15-20 vjeçare. Në moshëtë re ka, rritje të shpejtë. Jeton 200-250 vjet. Është lloj i klimës mesdhetare. Ka nevojë për dritë dhe nxehtësi, nuk duron të ftohtit. Areali natyror dhe artificial i saj shtrihet deri në 600-800m mbi nivelin e detit, nuk ka kërkesa të mëdha ndaj tokës, shkon shumë mirë në ranishtet bregdetare, në dunat dhe në tokat aluvionale, por nuk zhvillohet mirë në tokat e rënda dhe më lageshtirë të tepërt. Është lloj kserofil. Në mënyrë natyrore në vendin tonë takohet kryesisht në Divjakë. Prodhimi më i rëndësishëm është druri, i cili shërben për prodhimin e lëndës së shanuar, të pllakave të zdrukthit, në ndërtimi, për letër, për të nxjerrë vajin që është shumë i preferuar për prodhimin e sapuneve aromatike; frytin-fistikunka vlera të mëdha ushqyese si dhe është shumë e preferueshme si dru dekorativ në parqe dhe lulishte.

3. Dafina (*Laurus nobilis*)



Në vendet me klimë e tokë të përshtatshme rritet si dru deri në 18m lartësi dhe 50cm trashësi. Ka degë të holla e të shogëta, të cilat formojnë një kurorë piramidale të dendur. Rregullisht rritet në trajtë shkurreje ose si dru i vogël. Sistemi rrënjor nuk është i thellë. Lëvorja në fillim është e gjelbër, më pas gri e errët ose e murrme. Gjethet të qëndrueshme, të thjeshta, heshtake të zgjatura (8-15x2-6cm), të mprehta me majë dhe pykore në bazë, të vendosura në mënyrë të këmbyer, të

gjelbra të errëta, të shkëlqyeshme në faqen e sipërme dhe të gjelbra të çelura në të poshtmen, të lëkurta, të lëmuara, të plota ose ndonjëhere me buzë të valëzuara, shume aromatike, me një bisht të shkurtër, 2-8cm, pa ndajgjethëza. Është bimë dioike, me lule të grupuara në ombrella sqetullore, 4-6 së bashku, në ngjyrë të bardhë në të verdhërreme, të parfumuara. Lulet mashkullore janë me 8-12 thekë, femëroret me vezore të mbitëshme, me një shtyllëz dhe kreza me tre të çara dhe 4 thekë jo pjellore. Lulet çelin në Mars-Prill. Fryti është një bërthokël vezake, në fillim e gjelbër dhe në pjekuri e zezë, sa një qershi e vogël, por me erë të këndshme, piqet në Tetor-Nëntor. Druri është i rëndë, i fortë, në ngjyrë të bardhëkuqerreme dhe me erë të lehtë. Dafina është lloj tipik i klimës mesdhetare që i përshtatet kushteve të zonës fitoklimatike lauretum. Është shumë e qëndrueshme kundrejt thatësirës, porse në vende të tilla rritet ngadalë dhe mbetet në trajtë shkurreje. Preferon tokat e freskëta subargjilore deri subranore dhe të pasura me humus. Është lloj dritëdashës, por mund të rritet edhe në hije. Ka jetëgjatësi të vogël, takohet kryesisht në zonën e ulta bregdetare. Përdoren: Gjethet, Lulet, Farat. Gjethet e dafinës në gjendje të thatë përmbajnë ujë, tanina, lipide, celulozë,

esencë, lëndë të hidhura, pak vitaminë B₁ etj. Frytet përmbajnë esencë, vaj yndyror, amidon, sheqer etj. Gjethet përdoren në trajtë infuzi ose dekokti. Ky çaj ka veti nxitëse me efekt të mirë në dispepsitë atonike, në gripet që shoqërohen me adinami, në bronkitet kronike, në çrregullimet e aparatit tretës, për të çliruar zorrët nga gazet e për të nxitur shërimin e reumatizmit, kundër bronkitit, kollës së fortë, djersitjes; bëhen banja të këmbëve, për erën e keqe, djersitjen e tepërt dhe eritemat. Përdorimi i jashtëm i vajit të trashë që nxirret nga frytet, përdoret për të shëruar dhëmbjet e të ejturit nga reumatizmi dhe nga të tjera sëmundje të afërta me këtë. Frytet përdoren si mjet për të shtuar oreksin dhe si stomakik. Vaji yndyror përdoret edhe në veterinari kundër parazitëve. Druri përdoret për të prodhuar artikuj të vegjël. Esenca përdoret në parfumeri dhe industrinë e sapunit. Gjethet dhe frytat përdoren si erëza, në industrinë farmaceutike, ushqimore, parfumerisë etj.

4. Mersina (*Myrtus communis*)



Rritet si shkurre ose drui vogël deri në 5m i lartë. Bisqet janë të përkundrejtë dhe me kënde. Lëvorja fillimisht është e kuqerremtë dhe me pas gri e hinjtë. Druri është në ngjyrë tëkuqerreme-murrme, i fortë, me rrrathë vjetor pak të dallueshëm. Gjethet janë të qëndrueshme, të thjeshta, kryq të përkundrejta, pa bisht, vezake-heshtake (1-3x0,5-1cm), të lëkurta, të thepeta si në majë ashtu edhe në bazë, me buzë të plota, në ngjyrë të gjelbër të errët dhe të shndritshme nga sipër, më të zbehta nga poshtë, të buta dhe shumë erëkëndshme. Lulet janë hermafrodite, të vetmuara ose nga dy së bashku, sqetullore, me bisht dhe me dy ndaj gjethëza të rënshme; kupa me 5 nënpetla të lira dhe të mprehta; kurora me 5 petla vezake përmbysura, të bardha, me qime

gjendrore në buzë; thekët janë të shumtë (rreth 50), më të gjatë se petlat, me pjalmore të verdha; vezorja është e nënteshme, dy kthinshe, me një shtyllëz; çelin në Korrik-Tetor. Fryti është rrushk në ngjyrë të errët, me kupë të qëndrueshme, me shije tëëmbël, aromatik, që përmban fara të shumta të bardha në formë veshke, piqet në Nëntor. Shumëzohet me farë dhe më rrallë me kalema gjysmë të drunjëzuar. Rritet ngadalë, fillon të lulëzoj dhe frytifikoj nga mosha 4-5vjeçare. Takohet në zonën e shkurreve mesdhetare, gjithmonë të gjelbra, në shoqërim me elementë të tjerë karakteristike të makjes. Kërkon toka të freskëta, por rritet edhe në toka të thata. Është e përhapur në bregdetin e Evropës Jugore, në Azinë Perëndimore dhe në Afrikën Veriore. Në vendin tonë takohet në nënzonën e ngrohtë tëzonës së dafinës, duke u ngjitur deri në 500-600m lartësi mbi nivelin e detit, e shoqëruar me Xinën, Bafrën, Shqopën dhe shkurre të tjera mesdhetare. Nga mersina sigurohen prodhime jo drusore të rëndësishme, si vaji aromatik që

nxirret nga distilimi i gjetheve të njoma, dhe përdoret në farmaceutike, esenca me erë të këndshme që përdoren në parfumeri dhe sapuneri si dhe tannin. Druri përdoret për të përgatitur artikuj të vegjël zdrukhtarie, si dru zjarri dhe për të prodhuar qymyr. Vlerësohet edhe si shkurre zbukuruese.

5. Selvia (*Cupressus sempervirens*)



Dru deri në 20-30m i lartë, ndonjëherë 50m, me diametër 25-50cm. Kërçelli i drejtë, cilindrik, në trajtë kollone, i çrregullt, shumë i degëzuar deri në bazë. Kurora e mbledhur, konike ose e hapur, e dendur, në ngjyrë të gjelbër të errët. Sistemi rrënjor tipik sipërfaqësor edhe kur tokat janë të thella e të shkrifëta. Lëvorja është në ngjyrë gri në të hinjtë deri të murrme, e butë, fibroze, me plasaritje në trajtë vizash (si e rrudhosur). Druri është shumë i qëndrueshëm, homogjen, me strukturë të imët, me blanë të bardhë në të verdhë e myje të verdhë të celët. Bisqet me seksion pothuaj katërkëndesh. Gjethet mëllugore, vezake, shyte, tëvendosura në katër rreshta, të ngjeshurapas bisqeve, të renditura afër njëra-tjetrës si tjegullat, pjesërisht të bashkërritura me bisqet, në ngjyrë

të gjelbër të errët. Bimë monoike; lulet në trajtë boqesh; mashkulloret të vetmuara, në skaj të bisqeve, të verdha, vezake (3-5mm të gjata); femëroret thajse rruzullore, gri të gjelbra, me reflekse manushaqe trëndafili. Lulëzon nga Shkurti në Maj. Frytet janë boçe në trajtë goglash, vezake të zgjatura ose rruzullore (2-4x1,5-3cm), të verdhërreme gri të errëta, me bisht të shkurtër, të përbera nga 8-14 mëlluga mburojengjashme, me thumb. Çdo mëlluge, përmban fara të shumta e të vogla, 2-3 x 3-6 mm, vezake, në ngjyrë gështenjëtë kuqerreme, me flatra të ngushta, piqen në vitin e dytë. Shumëzohet me farë, duke u ripërtëritur me lehtësi edhe në mënyrë natyrore. Frytifikimi fillon në moshën 4-5 vjeçare dhe është i bollshëm për çdo vit.

Selvia ka rritje të ngadalshme dhe jetëgjatësi të madhe (deri në 2000 vjet). Është lloj termo-kserofil, me kërkesa të pakta, përshtatet në toka të çdo tipi dhe natyre, përfshi edhe ato argjilore, të ngjeshura e gëlqerore ose tokat shumë të varfra. Është mesatarisht dritëdashës, tipike mesdhetare. Selvia vegjeton spontanisht në Mesdheun Lindor është kultivuar që prej mijëra vitesh kudo, duke përfshirë edhe vendin tonë. Areali natyror i pyjeve me Selvi shtrihet në zonën Lauretum dhe në nënzonën e ngrohtë, deri 500-800m lartësi mbi nivelin e detit. Selvia përdoret gjerësisht për pyllëzimin e terreneve të varfra e të thata, si element i brezave mbrojtës kundër erërave; për zbukurim, e shpesh në vorreza dhe në vende të shënjta. Druri përdoret në industrinë e prodhimit të mobilieve dhe për orendi të tjera shtëpiake. Nga distilimi i gjetheve përfitohet një esencë speciale, që përdoret në industrinë kimike e farmaceutike.

6. Shelgu (*Salix alba*)



Arrin një lartësi e 15m dhe rrallëherë 25m. Dallohet për të formuar rrënjë ajrore gjatë trungut, në lartësi të madhe, deri në nivelin maksimal të ujërave gjatë përmytjeve; pas tërheqjes së ujërave rrënjët mbesin të varura në kërcell në formën e disa mustaqeve karakteristike. Ka kërcell të drejtë dhe disa herë pak të shtrembër dhe të përkulur. Lëvorja në ngjyrë të hinjtë, me tëçara të thella qysh në moshë të re. Druri ka blanë të ngushtë, të bardhërreme dhe nyje të murrme të kuqërreme; është i butë, i lehtë, pak i qëndrueshëm. Kurora është e gjerë, e rrumbullakosur, e degëzuar në mënyrë të çrregullt, e rrallë dhe mbulon dobët tokën. Bisqet janë të epshëm, të hollë, në ngjyrë të gjelbër të verdhërreme ose të murrme; në moshë të re shpesh janë të mëndafshhtë të bardhërreme.

Sythat të zgjatur, të verdhërremetë kuqërremtë, të ngjitur pas biskut. Gjethet me bisht të shkurtër (0.8-1cm), me gjendra, me ndaj gjethëza të

ngushta e të rënshme, me llapë heshtake ose heshtake e zgjatur, 5-10x1-2cm, zakonisht 4-7(10) herë më e gjatë se e gjerë, me gjerësinë më të madhe në gjysmën e poshtme, me buzët të sharruara imët, me 15-18 palë nervatura sekondare, në fillim me push të mëndafshhtë në ngjyrë argjendi në të dy faqet, ndërsa në pjekuri me qime vetëm në anën e poshtme ose gjatë nervaturës kryesore. Është bimë dioike me lule të pajisura me mëlluga të bardha dhe me qime; mashkulloret të grupuara në lëvare të verdhërreme, 7cm të gjatë, me dy thekë dhe pjalmore të verdha; femëroret në lëvare të gjelberëmme, rreth 6cm të gjatë. Lulëzon shumë herët në pranverë, në Mars-Prill, në të njëjtën kohë me gjethëzimin. Fryti është një kapsule konike, deri në 6mm e gjatë, e shogët, thuajse pa bisht, e cila piqet në Maj-Qershor. Frytifikon çdo vit dhe me bollëk. Shumëzohet me farë dhe në mënyrë vegetative. Farat janë të shumta dhe përhapen në distancë të konsiderueshme, mbijnë shpejt, disa herë edhe brendaditës, në tokë të lagur madje dhe në ujë, duke formuar, pas tërheqjes së ujërave, një filizëri të bollshme, të dëndur si furçe. Shelgu i bardhë karakterizohet nga një fuqi e madhe lastarimi pas prerjes së kërcellit edhe në lartësi të

mëdha, shumëzohet me lehtësi me anë të kalemave. Filizat rriten fuqishëm qysh në fillim, duke arritur në moshën 20 vjeçare një lartësi prej 15-20m. Ka një jetëgjatësi të shkurtër, 80-100 vjet, ndërsa kërcelli fillon të kalbëzohet duke filluar nga mosha 10 vjeçare. Shelgu i bardhë është pak kërkues ndaj klimës dhe përballon me lehtësi të ftohtin e madh të dimrit dhe ngricat e vonshme e të hershme. Zhvillohet në mënyrë të bujshmenë tokat aluvionale, pjellore, me lagështirë të mjaftueshme dhe konstante që furnizohet nga shtresa e ujit freatik. Duron përmytjet me kohëzgjatje të madhe më mirë se çdo lloj tjetër drusor i vendit tonë. Është i përhapur në të gjithë Evropën. Rritet, gjithashtu, në Kaukaz, Azinë e Vogël, Kinë, dhe shkon deri në Algjeri. Tek ne takohet kudo gjatë rrjedhjes së lumenjve e përrenjve, kanaleve, rreth arave dhe vendeve që

mbajnë ujë që nga bregdeti deri në 1200-1300m lartësi mbi nivelin e detit. Shelgu i bardhë është një komponent specifik për krijimin e pyjeve rreth brigjeve të ujërave. Druri përdoret për ndërtime, për qëllime bujqësore e blegtorale, për prodhimin e celulozës, të shkrepseve, artikujve sportive, pllakave të zdrukthit, në industrinë kimike etj. Nga lëvorja nxirret tanin. Bisqet përdoren në shporteri, ndërsa gjethet si ushqim për blegtorinë. Shelgu i bardhë është një bimë mjaltëse shumë e mirë.

7. Vidhi i fushës (*Ulmus campestris*)



Në kushte optimale mund të rritet deri në 30-40m i lartë dhe 2-3m i trashë. Ka sistem rrënjor boshtor-sipërfaqësor, me rrënjë anësore shumë të zhvilluara, prej të cilave dalin pinjolla. Kërçelli është i drejtë, i vëtkrasitur, i trashur në bazë. Lëvorja në fillim e lëmuar, gri e zezërreme, më vonë e zezërreme, me tëçara gjatësore të thella dhe ndonjëherë me brinj suberoze shumë të theksuara.

Druri i ngjyrosur bukur, me pore unazore, me blanëtë gjerë të verdhërreme dhe myje të murrme çokollatë, i rëndë, i fortë, elastik, rezistent, jeton gjatë. Kurora është konike deri rruzullore, me degë të holla, të dëndura, të ngritura përpjetë. Bisqet njëvjeçare të hollë, të shogët ose lehtësisht me push, të murrme në të kuqerremtë, të vendosur në mënyrë dislike. Bisqet më të vjetër të hinjtë të verdhërreme, me plasaritje të holla gjatësore, disa herë me brinjë suberoze shumë të ngritura. Sythat vegetative janë të vegjël, vezake, të mprehtë, të larguar nga bisku, me pak push ose të shogët, me buzë me qerpikë në ngjyrë të bardhërreme.

Sythat lulore janë rruzullore dhe të dukshëm gjatë dimrit. Gjethet të thjeshta, të vendosura në mënyrë distike, të rënshme, vezake, 5-10cm të gjata dhe 4-5cm të gjera, me buzë dyfish të dhëmbëzuara, me majë të mprehtë ose të thepët dhe me bazë asimetrike, në ngjyrë të gjelbër pak a shumë të shndritshme në faqen e sipërme dhe të shogëta nga poshtë, me pak qime në sqetullën e nervaturave, ndërsa pjesa tjetër e shogët ose deri diku me push të ashpër, me 7-15 çifte nervaturash të dyta, me bisht të shkurtër 8-15mm dhe me ndajgjethëza të rënshme. Lulet janë të shumta, të vendosura në tufa sqetullore në bisqet e vitit të kaluar, pa bisht, hermafrodite, pa petla, në ngjyrë të kuqe të purpurt, çelin herët në pranverë, në Mars-Prill, para gjethëzimit. Fryti është një shojzë e lehtë, me gjatësi 1-2cm, afërsisht e rrumbullakët, e shogët, membranore, majëngrënë, që arrin gati deri tek fara. Fara është e vendosur afër majës së flatrës, ka fuqi mbirëse të ulët, 30-40%, piqet në Maj dhe përhapet menjëherë. Shumëzohet me fare, ashtu edhe duke i përgatitur fidanët në fidanishte. Lastaron nga cingu dhe nxjerr pinjolla. Vidhi i fushës

fillon të frytifikojë herët, që nga mosha 10-20 vjeçare, për çdo vit e me bollëk. Filizat në moshë të re rriten shpejt, duke arritur në vitin e parë 30-40cm lartësi dhe në moshën 5 vjeçare 3-5m. Jeton 400-500 vjet. Është lloj me kërkesa ndaj dritës dhe nxehtësisë, rezistent ndaj thatësisë dhe ngricave të vonshme e të hershme. Preferon klimën e butë, rritet mirë në toka të fresketa, të thella dhe shumë pjellore, gjë që shpjegon edhe përhapjen e tij në formë ekzemplarësh të vetmuar; mund të përshtatet edhe në terrene argjilore. Nuk dëmtohet nga përmbytjet. Është dritëdashës, por duron edhe hijen e drurëve të tjerë metë cilët shoqërohet. Është i ndjeshëm ndaj prekjës nga kërpudhat dhe insektet. Është i përhapur kryesisht në Evropën Qendrore e Jugore, në Azinë e Vogël dhe Afrikën Veriore. Tek ne takohet në zonën fushore, buzë ujërave e rrzëz pyjeve, në gjerde dhe pyjet aluvionale deri në 1500-1600m mbi nivelin e detit, sinë Velipojë, Kune-Vain, Patok, Fushë-Krujë, Rrushkull, Kavajë, Elbasan, në zonën e Myzeqesë, Divjakë, Fier, Vlorë-Nartë, Sarandë, etj. I përshtatshëm për tu mbjellë buzë ujërave, ledheve dhe si dru dekorativ. Druri i Vidhit të fushës është më i miri i të gjithë vidhave për nga karakteristikat që ka, punohet me lehtësi dhe përdoret për prodhimin e mobilie, parketit, në ndërtimet hidraulike etj. Gjethet janë një ushqim i preferuar për bagëtinë. Lëvorja e zierë është përdorur si ushqim nga popullsia.

8. Xina (*Pistacialentiscus*)



Është shkurre kaçubore, shumë e degëzuar dhe e dendur, që rritet zakonisht deri në 2m e lartë dhe rrallë mund të arrijë deri në 4-5m. Lëvorja është mëllugore, e murrme. Bisqet janë të shogët, nëngjyrë të murrmetë kuqerreme. Druri ka blinë të verdhë dhe myjë të kuqerremtë, është me damarë, i fortë, me rrathë vjetore pak të dallueshëm. Gjethet janë të qëndrueshme, të këmbëra, të përbëra

çiftpendore, me bishtak me 2-5(6) çifte gjethëzash heshtake (2-3,5x1,5cm), me buzë të plota, në ngjyrë të gjelbër të shndritshme nga sipër, më të zbehta nga poshtë, të shogëta, me erë të fortë të këndshme rrëshire. Është bimë dioike me lule të vendosura në vile të shkurtra e të dendura sqetullore (2-5cm të gjata), nëngjyrë të kuqe të errët, çelin nga Marsi në Qershor. Fryti është një bërthokël rruzullorë, 5mmimadh, me majë, shumë aromatik, i kuq i errët ose thajse izi Piqet në Gusht-Nëntor. Shumëzohet me farë. Lastaron nga cunq, kur pritët. Xina është lloj i klimës mesdhetare atlantike. Është dritë dashëse dhe i reziston thatësisë. Shkon në çdo lloj tokë, por preferon ato të lehta. E përhapur në të gjithë Mesdheun dhe në Azinë e Vogël, është element karakteristik i makjes mesdhetare. Në vendin tonë takohet me shumicë dhe kudo, në zonën e dafinës ku formon grumbuj të thjeshtë ose të përzier me lloje të tjera termofile të shkurreve

mesdhetare, gjithmonë të gjelbra, siç janë Mersina, Bafra, Shqopa, Mareja, Dëllinja, Mretat etj. Druri i Xinës mund të përdoret për të përgatitur ndonjë orendi zbukurimi dhe për djegie. Nga frytet mund të prodhohet një lloj vaji për gatim. Nga lëvorja, me anë të plagosjes së saj, në periudhën e verës, nxirret një rrëshirë që quhet "Chio", që përdoret në farmaceutike, ndërsa nga gjethet mund të nxirret tanin.

9. Verriu i zi (*Alnus glutinosa*)



Arrin shpesh lartësinë 20-25m dhe disa here deri në 30m. Ka rrënjëzim sipërfaqësor deri në boshtor-sipërfaqësor, në varësi me tokën; në rrënjëzat e reja formohen disa gunga në ngjyrëportokalli, në të cilat jetojnë bakteriet fiksuese të azotit. Kërçelli është i drejtë nga baza deri në majë. Lëvorja është e lëmuar, e shndritshme, e hinjtë në rini, pas 15-20 vitesh formon një ritidom të zezërreme me mëlluga me qoshe, përmban rreth 16% tannin. Druri nuk ka myje, i porsaprerë ka ngjyrë të bardhë

të kuqerremtë dhe më pas merr ngjyrë portokalli.

Është i butë, i lehtë, ka rezistencë të madhe në lloje. Kurora medegëzim të rrallë dhe të shtrirë, e formuar nga degë të shumta të holla horizontale, që i japin asaj formë vezake-piramidale, me ngjyrë të gjelbër të mbyllur. Bisqet të epshëm, të hollë, me qoshe, me lëvore të lëmuar, të gjelbër të errët, me lenticela të shumta të dukshme, të ngjyshitshme. Sythat me një bisht të dukshëm (3-7mm të gjatë) të larguar nga bisku, vezake, me seksion trekëndor, të mbuluar me dy mëlluga, në ngjyrë të murrme të kuqerremtë, pak të ngjyshitshëm. Gjethet janë të thjeshta, të këmbjyera, vezake të përmbysura ose afërsisht të rrumbullakta (4-10x3-7cm), pykore në bazë, të dhëmbëzuara në 2/3 e sipërme dhe të plota në pjesën e poshtme, janë në ngjyrë të gjelbërtë shndritshme e të shogëta në faqen e sipërme dhe me të zbehta në të poshtmen, me tufëza qimesh në ngjyrë ndryshku në sqetullën e nervaturës, të kapur nga një bisht 2-3cm i gjatë, me 5-8 nervatura të dyta, viskoze; në rini bien vonë në vjeshtë pa ndryshuar ngjyrën. Është bimë monoike me lule të grupuar në lëvare, formohen qysh në verë dhe hapen herët në pranverën e ardhshme, para gjethëzimit; mashkullorët cilindrike, 6-12cm të gjatë, të varur, të grupuar nga 3-5 së bashku; femëroret vezake-gjatore, 0.5-1cm të gjatë, të vendosur nën mashkullorët, me lule pa perigon, në pjekuri transfonohen në boçe të vogla 1-2cm të gjata, vezake ose elipsoidale, të pajisura me mëlluga drunore, që rezultojnë nga transformimi i brakteve lulore, në ngjyrë të zezërreme në pjekuri. Frytet janë në trajtë boçesh rruzullore, të cilat në vjeshtë, pas pjekjes, mbeten të varura për shumë kohë në dru, ndërsa mëllugat hapen duke lënë farat të bien e të përhapen.

Farat janë të vogla, 2-3mm, me flatra shumë të ngushta, përmbajnë qeska me ajër, të cilat i lejojnë që të transportohen nëpërmjet ujit në distanca të mëdha. Periodiciteti i frytifikimit 1-2 vjeçar. Shumëzohet si me farë ashtu edhe në mënyrë vegjetative. Rreziku kryesor për farat është vështirësia për t'i ruajtur për një kohë të gjatë dhe fuqia mbirëse e ulët. Verriu i zi dallohet nga një aftësi e madhe e ripërtëritjes vegjetative, e krahasueshme me atë të dushqeve e të shkozës; në kushte të favorshme lastaron fuqimishëm deri në moshën 60-70 vjeçare. Klima nuk përbën faktor kufizues për përhapjen e Verriut të zi. Është rezistent ndaj të ftohtit dhe sidomos ndaj ngricave të hershme e të vonshme, por më kërkues ndaj nxehtësisë sesa Verriu i bardhë. Në të kundërtën, përhapja e tij është kështu fuqimisht nga faktorët edafikë, shfaq kërkesa të larta ndaj lagështirës së tokës, duke vegjetuar edhe në toka pak a shumë argjilore, me nivel të lartë të ujërave freatike, në lugina, në shtretërit e përrenjve e të lumenjve. Shkon shpesh në terrene kënetore të paajrosura ku formon vërrishte të thjeshta. Është i përhapur në të gjithë Evropën, pjesën veriore të Azisë së Vogël etj. Tek ne takohet gjatë lumenjve, që nga zonat fushore deri në 1800m mbinivelin e detit. Verriu i zi mund të përdoret shumë mirë për konsolidimin e brigjeve tërrjedhjeve ujore, të shpateve që mbajnë ujë, për popullimin e stacioneve me ujë të tepërt, të papërshtatshëm për kulturat e tjera, duke siguruar një prodhim material drunor të konsiderueshëm. Druri përdoret për shtylla miniere, pastë për letër, pllaka fibre, torneri, skulpturë, për prodhimin e qymyrit, vegla muzikore etj. Lëvorja përmban tannin.

10. Murrizi njëbërthamësh (*Crataegus monogyna*)



Përgjithësisht rritet si shkurre, ndonjëherë takohet si dru 8-10m i lartë, me kërcell të çrregullt. Lëvorja nëngjyrë të hinjtë të murrme, mëllugore. Druri është i bardhëremë i kuqerremtë, i fortë, i rëndë, me myje, rezistent ndaj fërkirnit. Bisqet janë të shogët, të murrme të kuqerremtë, me gjemba 1cm të gjatë, të vendosur gjatë biskut dhe sidomos në majë. Sythat janë të vegjël, rruzullore, të verdhërreme. Gjethet të këmbjera, 2-4cm të gjata, rombike-vezake, me buzë të vrigulluara thellë, me 3-7 vriguj të çrregulltë, të sharruar në majë, në ngjyrë të gjelbër sipër dhe më të zbehta poshtë.

Lulet janë të plota, të bardha, rreth 1cm diametër çdo lule, të grupuara në vastakë nga 5-25 së bashku në bisqet e shkurtër. Çelin në Maj. Fryti është një bërthokël e kuqe, vezake ose sferike, 0,7-1,4cm e madhe, përmban vetëm një farë të fortë e kockore, e cila mbin me vështirësi në vitin e dytë. Shumëzohet me farë, e cila mblidhet në Shtator-Tetor dhe shtratifikohet deri në pranverën e vitit të dytë. Është lloj me amplitudë të gjerë ekologjike, pëlqen nxehtësinë, është rezistent ndaj

thatësirës dhe tokave të ngjeshura e të thata etj. Lloj dritë dashëse gjysmë hije dashës. Është i përhapur në Evropë, Azi dhe Afrikën e Veriut Tek ne takohet gjithkund, që nga bregu i detit deri në zonën e ahut, nëpër shkurreta e pyje të dritësuar, ledhe dhe gjerde, në çeltira dhe livadhe malore, deri në 1400m lartësi mbi nivelin e detit. Lulet gjejnë përdorim në farmaceutikë, mjekësinë popullore dhe janë mjaltëse. Ndihojnë në rregullimin e luhatjeve të tensionit. Kokrrat mund të konsumohen të freskëta ose të ziera në formë çaji, ndërsa druri ka përdorime të vogla. Mund të përdoret si lloj zbukurimi dhe për krijimin e gjerdeve të gjallë.

11. Trëndafil qeni (*Rosa canina*)



Është shkurre që nuk kalon 2-3m lartësi. Degët i ka të pajisura me gjemba të fuqishëm, të cilët janë me majë të përkulur, të shtypur anash dhe me bazë shumë të gjerë. Sythat janë të vegjël, të kuq. Gjethet janë të rënshme, të këmbyera, të përbera, tek pendore dhe me ndaj gjethëza të ngjitura me bishtin, me 5-7 gjethëza vezake ose eliptike 2-4cm të gjata, me buzë njëfish të sharruara ose disa herë dyfish të sharruara, të shogëta në të dy faqet ose me push të lehtë në nervaturat.

Lulet janë skajore, të vetmuara ose nga 2-5 së bashku, me diametër 4-5cm, me 5 petla në ngjyrë trëndafilose ose të bardha dhe 5 nënpetla të mprehta. Çelin në Maj-Korrik. Fryti është i shumëfishtë, i formuar nga një pjesë mishtake elipsoidale, e kuqerremtë, me prejardhje nga shtrati lulor, që mbyll brenda akena të shumtë e të vegjël me qirne. Piqet në Gusht-Shtator.

Shumëzohet me farë, kalema, shpatulla etj. Shkurre dritëdashëse e klimës së temperuar. Rritet në toka me përmbajtje të lartë bazash të këmbyeshme, të thata deri të shkrifeta, disa herë të ngjeshura. Është i përhapur në Evropën Qendrore dhe Jugore. Në vendin tonë takohet kudo edhe me shumë nga llojet e tjerë të trëndafilave të egër në formë tufash, kryesisht në grumbujt pyjorë të rralluar, në skaj të pyjeve etj, deri në 1600m mbi nivelin e detit. Rëndësi paraqet fryti i trëndafilut të egër, i cili është i pasur me vitamina C, D, P, etj. si edhe me lëndë të ndryshme

sheqerore, acid nitrik etj. Lulet janë laksative. Frytet janë astringjent, pastrues të gjakut dhe luftojnë sëmundjen e skorbutit. Rrënjët kanë qënë përdorur dikur si ilaç kundër tërbimit.

12. Lulebasani (*Hypericum perforatum*)



Bimë barishtore shumëvjeçare. Prej rizomës së hollë të degëzuar dalin çdo vit disa kërcëj të drejtë të degëzuar, të lëmuar, që arrijnë një lartësi prej 20-60cm, e degëzuar në majë. Kërçelli ka pak gjethe. Gjethet i ka të përkundërta, pa bisht, në formë vezake, të vogëla, ose lineare deri në 3cm, të pajisura anës me pika të vogëla të zeza. Lulet që dalin në trajtë tufash në majë të kërcëjve, të mëdha, kanë ngjyrë të verdhë në të artë dhe me pika të zeza në të murrme nga ana e jashtme. Kupa ka pesë sepale dhe

kurora pesë petëla, thekët janë të shumtë, 50-60. Fryti është një kapsolle me tri kthina, që përmban shumë fara të vogëla, të murrme. Lulëzon nga fundi i Prillit deri në Gusht. Rritet në vende barishtore, të thata, të papunuara, në livadhe, në kullota, çeltira pyjesh edhe në zonën malore, të ulët dhe të mesme. Në gjendje të egër takohet në toka argjilore-ranore. Preferon klimë mesdhetare. Pjesët që grumbullohen janë: Kërçelli me lule. Lulesat. Gjethet. Bima përmban esencë të përbërë, kryesisht nga terpene (pinene) e eskuiterpene, nga ana tjetër gjendet në sasi të vogëla acid izovalerianik. Bima e pa lulëzuar përmban më shumë esencë. Vaji yndyror përmban alkool cerilik, gliceride të acideve stearik dhe miristik dhe një fitosterinë. E gjithë bima përmban taninë katekike, vitaminë C, karoten, saponinë, acid kafeik, acid klorogjenik e nikotinic, kolinë, etj. Përdoret në trajtë dekoti, vaji mjekësor, tinkture, ekstrati të lëngët alkoolik. Mjekësia popullore e përdor me sukses lule ballsamin, për përdorim të brendshëm, si mjet balsamik dhe antiflogjistik, në gjendje infektive të bronkeve dhe rrugëve gjenitourinare, si rruhdës dhe antiseptik në mjekimin e katarreve të zorrëve; si antiseptik për shpëlarjen e zgavrës së gojës; antihemorragjik, në dhimbjet e kokës si një nxitës i gjendrave digjестive dhe kryesisht atyre të mëlçisë. Ka veti antiinflatore dhe qetësuese, për mjekimin e gastritit dhe të ulçerave të stomakut e të duodenit, kolitit, diarrese, dizenterisë, kundër tuberkulozit, për ndalimin e rrjedhjes së gjakut në menstruacionet dhe të majasëllit. Për përdorim të jashtëm vaji i lule ballsamit përdoret si antiinflatore dhe qetësues për mjekimin e djegieve të shkaktuara nga dielli, për plagët e reja dhe ulçeracionet e lëkurës. Gjithashtu ajo përdoret edhe në parfumeri dhe kozmetikë.

13. Rigon i bardhë (*Origanum vulgare*)



Bimë barishtore shumëvjeçare, me lartësi 30-80cm, aromatike. Me kërcëj të drejtë, pak të rrënjëzuar e pasur me qime gjëndërore. Ka gjethe të përkundrejta, me bisht të shkurtër, vezake këndrejta, të veshura me qime, bojë hiri. Lulet me bisht të shkurtër dhe të grumbulluara në kallinj të stërgjatur në mes të kërcëjve, të bardha, rrallë të kuqërremta. Lulëzon nga fundi i muajit Qershor deri nga mesi i Gushtit. Rigoni është i zakonshëm dhe gjendet në lartësitë deri në 800-1000m mbi rrafshin e detit, në vende me barë, në shkurreta, në çeltira pyjesh ose e kultivuar. Shtrirja gjeografike e rigonit tregon qartë dhe kërkesat e kësaj bime për klimën dhe tokën. Bimë mjekësore që i grumbullohen: E gjithë bima (Herba). Përdoret në mjekësi kryesisht në dhimbjet e gojës, të dhëmbëve, kundër ftohjes dhe gripit, bronkitisit, gjithashtu përdoret dhe si çaj. Po kështu përdorime gjen dhe në gatime të ndryshme.

14. Bari i bletës (*Melissa officinalis*)



Bimë barishtore njëvjeçare ose shumëvjeçare, rritet 30-80cm. Ka kërcell të drejtuar përpjetë, katërkëndësh, shumë të degëzuar. Gjethet të përkundërta, bishtake, të thjeshta, vezake, urrëza-urrëza anëve, shyte në majë, me ngjyrë të gjelbër të çelur, shumë leshtore, 6-8cm të gjata dhe 3-5cm të gjëra. Lulet dalin në majat e bisqeve, në cima sqetullore nga 6-12 okane ngjyrë të bardhë e nganjëherë si në rozë, kanë bishta të shkurtër, dalin nga disa bashkë në

sqetull të gjetheve dhe janë të drejtuar të gjitha nga një anë. E gjithë bima lëshon një erë si të limonit, sidomos kur prekim gjethet me dorë. Lulëzon gjatë verës, Qershor-Gusht. Kupa është si kabanë, me dy buzë leshtore në pjesën e poshtme. Kurora dybyzore, me gyp të hollë, cilindrike, e përkulur, ka 4 thekë, pjalmoret me bashkëlidhës të drejtë e me vriguj të kundërt, ka 1shtyllëzë; kreza është e çarë dysh. Fryti përbëhet nga 4 akene vezake, të murrmë, 1,5-2mm të gjata dhe 0,75-1mm të gjëra. Rritet në zonën e shkurreve mesdhetare dhe në zonën e dushkut, zakonisht në pyje dhe vende të ftohta me hije. Kërkon toka të pasura, jo të thata, pa lagështi, të ngrohta dhe me diell. Tokat ranoro-argjilore dhe ato me humues janë të përshtatshme. Bari i bletës përmban 0,1-0,2% esencë, acid galik, rrëshirë, një lëndë të hidhur, aldehide, kamfur,

taninë, vitaminë C. Gjethet përdoren në trajtë: Infuzi, Dekokti dhe Uji aromatik apo alkoolaturë të thjeshtë. Infuzi vepron si karminativ, antispazmodik, qetësues nervash; ai shton sekretimin e temthit, qetëson rrahjet e forta të zemrës, vepron në pagjumësitë me origjine nervore. Dekokti ka dhënë rezultate të mira te të sëmurët me marrje mendsh. Vepron si forcues i nervave të zemrës, kundër dhimbjeve të kokës, fuqizon stomakun dhe lehtëson tretjen e ushqimeve, kundër gazëve të zorrëve. Dekokti përdoret edhe në trajtë kompresash dhe banjash për mjekimin e plagëve, në neuritet dhe në reumatizem, si mjet zbutës e qetësues, sepse ka veti cikatrizuese e antiseptike, si banja aromatike dhe si nxitëse të lëkurës.

15. Hithra (*Urtica dioica*)



Bimë barishtore shumëvjeçare, dioike, me rizomë zvarritëse e të degëzuar. Kërçelli është i drejtë i thjeshtë, me 4 brinjë ose i rumbullakët, i veshur me qime therëse, i lartë 0,5-2m. Gjethet i ka të përkundërta, të mëdha, deri 15cm të gjata, të pajisura me 4 ndajgjethëza të lira, vezake ose

heshtake, me majë të mprehtë dhe me buzë të sharruara, të mbuluara qime të holla therëse, me bisht të gjatë e me ngjyrë të gjelbërt të errët. Lulet i ka të vogla, të gjelbërt në të bardhë, të dhëmbëzuara nga jashtë. Lulet mashkullore përbëhen prej 4 thekësh të rrethuara prej një kupe të gjelbër me 4 nën petela. Lulet femërore përbëhen prej një pistili dhe një kupe me 4 nënpetela.

Lulëzon në periudhën Maj-Tetor. Fryti është një kokërr e vogël e shtypur dhe vezake. E përhapur kudo. Rritet në çfarëdo lloj toke, por preferon tokat e freskëta e të pasura. Në vendin tonë, në gjendje të lirë, takohet nga bregu i detit deri në majat e maleve, nëpër djerrishte, rreth banesave dhe gjetkë. Takohet në zonat me klimë mesdhetare fushore dhe kodrinore. Përdoren gjethet, farat dhe rrënjët. Gjethet, në gjendje të thatë, përmbajnë proteina, albumina, yndyrë, celulozë, lëndë azotike, aminoacide, glucide, etj. Gjethet, në gjendje të njomë, përmbajnë esencë, acid formik, glukokinina, karotinë, fitoncide, klorofilë, vitamina B₂, A, C, K, pak lëndë rrudhëse, kripëra të kaliumit, silicit etj. Gjethet e hithrës përdoren në trajtë: Infuzi, Infuzi të përzier,

Ekstrakti të lëngët, Shurup apo dhe përzjerje gjethesh rrënjë dhe uthullë. Në sajë të principeve vepruese hithra përdoret kundër anemisë, si ndihmëse në sëmundjen e sheqerit, si nxitëse e urinimit, e formimit dhe e sekretimit të qumeshit etj. Hithra, në sajë të klorofilit dhe lëndëve të tjera që përmban, përdoret në sëmundjet e lëkurës, sepse ka aftësi të zhdukë erën e keqe dhe nxit indet, ndalon qelbëzimet, mjekon plagët, ulçerat varikoze. Hithrat e freskëta përdoren për mjekimin e reumatizmit duke goditur trupin me degët së bashku me gjethet, sepse ka aftësi të nxisë qarkullimin e gjakut në lëkurë. Për të mënjeluar rënien e flokëve dhe zhdukur zbokthin përdoren uthulla e përzierë me gjethet dhe rrënjët.

16. Çikore (*Cichorium intybus*)



Bimë barishtore shumëvjeçare e gjatë 80-100cm. Rrënjën e ka të gjatë, strumbullore, të trashë sa një gisht, nga jashtë të murrme, përbrenda të bardha, të mbushur me një lëng qumështor. Kërcellin e ka të drejtë, cilindrik, me shumë degë të ngritura, dredhake dhe ullizake në majë. Gjethet të këmbyera, leshtore në nervurat e mesit. Të poshtmet janë gjatore, të çara, me vriguj të zgjeruar nga fundi, thuajse në formë trekëndëshe; kërcelloret të vogla heshtore, të plota ose pak të incizuara në bazë.

Kaptinëzat 11-10mm. Lulet blu, më rrallë roze ose të bardha, të vendosura në kaptinëza, nga të cilat disa janë sjetullore, pa bisht, trish ose të parëzuara, kurse të tjerat janë të vetmuara në majat e degëve. Pështjella përbëhet nga dy radhë braktesh braktesh të qerpikta, gjendrore, të jashtme vezako- heshtore, më të shkurtra se të brendshmet, të cilat janë vizake-shyte.

Shtrati është i sheshtë, i hojëlzuar, pa petëza, gjysëm lulegypëzat janë 18-20. Kurora është me 5 dhëmbë, ka 5 thekë. Pjalmoret janë të bashkuara në cilindra të përshkruar nga një shtyllëzë me 2 kreza. Fryti është një aken me 4 qoshe. Lulëzon gjatë periudhës Qershor-Tetor. E përhapur në vende gurishtore me bar dhe kullota, në djerrina, nga ultësirat deri në zonën malore. Takohet në vende të papunuara, anës rrugëve dhe hendeqeve, në vende barishtore me përhapje të bollshme kudo. Rritet në viset me klimë të ngrohtë dhe në ato malore dhe si tokë parapëlqen toka ranore-gëlqerore. Grumbullohet e gjithë bima (Herba). Rrënja. Gjethet. Majat e lulëzuara. Rrënja përmban inulinë, sheqerna (glukoze, levuloze, sakaroze), gjurma taninë, esencë, lëndë tanike e rrëshinore, cikorinë ose intibinë, laktucinë, dhe kolinë, gomë, antocianinë, poliene, kripëra minerale (nitrat kaliumi etj.). Gjethet përmbajnë cikorinë, argininë, kolinë, inulinë, acid cikorik, acid nikotinic, biotinë, klorofil, albuminë, lëndë të hidhura (centaurinë, cnicinë), vitamina B₁ dhe C, kripëra minerale (kalium dhe mangan). Lulet përmbajnë glikozidin cikorinë i cili zbërthehet duke dhënë glukozë dhe cikorigen. Gjethet përdoren në trajtë infuzi. Rrënjët e grimcuara përdoren në trajtë dekokti edhe lulet përdoren në trajtë infuzi. Gjithashtu, bima përmban principe amaro-tonike dhe prandaj këshillohet të përdoret në trajtë infuzi si tonik. Veprimi i saj megjithëse është i ngadalshëm dhe i dobët jep rezultate të mira. Tradicionalisht është përdorur

kundër gurëve në mëshikëzën dhe në veshka, në pastrimin e gjakut dhe reumatizmit.

17. Menta e butë (*Mentha piperita*, *M.longifolia*)



Bimë barishtore shumëvjeçare, me lartësi 40-120cm, me rizomë të zhvilluar mirë, që shërben për shumëzim vegetativ. Kërçelli është katërkëndor, të degëzuar, me degë të drejtuara përpjetë e të përkundërta, shpesh me ngjyrë të gjelbër në të kuqërremë. Gjethet i ka të përkundërta, bishtake, vezake, heshtake, të dhëmbëzuara në formë sharre, të mprehta, 5-8cm të gjata e 2-3cm të gjëra, me ngjyrë të gjelbër të errët, me hije të

kuqe në faqen e sipërme e me qime të forta në faqen eposhtme. Lulet janë të vogëla, vendosen në formë kalliri, eshtake ose konike, ngjyrë vjollcë të hapur ose me ngjyrë të kaltër, të grumbulluara në qerthuj, në majë të kërçellit dhe në sqetullat e gjetheve. Kupën e ka të rregullt, me 5 dhëmbë. Kurora është 2 herë më e gjatë se kupa, petëlnjëtur, në formë hinke. Thekë 4; Vezorja me 4 kthina; Shtyllëza në formë filli; Kreza e çarë në dysh. Fryti përbëhet nga 4 akene, 0,1mm të gjata dhe 0.2-0.4mm të gjëra. Koha e lulëzimit ndryshon sipas kushteve klimaterike dhe pozicionit gjeografik, përgjithsisht në vendin tonë nga Qershori në Shtator. E përhapur kudo. Nuk ka kërkesa ndaj tokës, por preferon më shumë tokat e lehta aluvionale, të pasur me lëndë organike, me ujë dhe nuk rritet në toka të rënda deltinore dhe që formojnë kore. Preferon klimë me lagështi dhe është lloj dritëdashës, si dhe pëlqen zonat e mbrojtura nga erërat e ftohta. Grumbullohet e gjithë bima (Herba). Gjethet. Bima përmban esencë, acid plruvik dhe acid ketoglutarik, oksidaza dhe poroksidaza, acid klorogjenfk, acid kafeik, një kompleks polifenolik, taninë, një lëndë të hidhur, lëndë rrëshinore, vitamin C etj. Përbërësi kryesor i esencës është mentoli. Përdoret në trajtë: Infuzi, Ekstrakti të lëngët dhe Shurupi. Infuzi përdoret për qetësimin e sistemit nervor, largimin e gazërave nga zorrët, për rixitjen dhe zhrazjen e fshikëzës së tëmthit, kundër marrjes së mendve, kundër ftohjes, të ënjturit, si venotonik, stimulon mëlçinë, forcon punën e zemës etj. Në trajtë llapaje të ftohtë qetëson dhimbjet e kokës. Gjethet kanë veti antibiotike dhe për këtë qëllim janë përdorur për shërimin e plagëve dhe të çibaneve. Esenca përdoret gjërësisht si karminativ dhe nxitës i gypit tretës, në kolelitiazë, për fërkime në trajtë tretësire alkoolike, për të qetësuar dhimbjet reumatizmale dhe kruarjet lëkurës të shkaktuara nga urtikaria si dhe në industrinë ushqimore, kozmetikë dhe për shumë përgatesa farmaceutike.

B. KAFSHËT

1. Çakalli (*Canis aureus*)



- Gjatësia e përgjithëshme: 80-100cm;
- Gjatësia e bishtit: 20-24cm;
- Lartësia në shpatull: 50cm;
- Pesha: 10-15kg;
- Jetëgjatësia: 12-14 vjet.

Në të gjithë arealin e tij të gjërë Çakalli paraqet 13 nënspecie. Gëzofi ka sfond të verdhë të artë në të kuqeremtë, me nuanca të zeza në shpinë dhe anash e të zbardhura në gjoks e bark. Buzët i ka të zeza, pjesa e brensëshme e veshëve e bardhë. Ndër ndijimet ka të zhvilluar të parit, të dëgjuarit dhe pastaj nuhatjen. Zëri i tij është një ulërimë e zgjatur që dëgjohet në mbrëmje. Kafshë nate që jeton në çift nganjëherë edhe me këlyshët e një viti më pare, të cilët ndihmojnë në ushqimin dhe mbrojtjen e të vegjëlve të porsa pjellë. Çdo grup ka një teritor prej reth 3km². Kafshë e shoqëruar me mbrëmjes dhe e natës që noton mire, nuk ecin në gjurmët e njëri tjetrit. Armiqtë e tij janë qentë dhe njeriu. Në vëndin tonë gjëndet në zonën bregdetare. Biotopi i tij janë sipërfaqet e sheshta të veshura me pyje e shkure me klimë të butë e të pasura me gjah të imët. Monogam, strofkën e bën në një gropë natyrore ose në galeri egzistuse. Kryqëzimi ndodh në Shkurt-Mars. Bara zgjat 60-63 ditë. Këlyshët lindin në strofkë, të verbër e të shurdhër për 12-15 ditë. Pjell 3-8 këlyshë, të cilëve iu jepet qumësht për 1,5 muaj. Në vazhdim këlyshët ushqehen si tek ujku. Kur përfundon formimi i sistemit të dhëmbëve këlyshët dalin në gjueti me prindërit e tyre. Kur fillon formimi i çifteve familjet prishen. Konsumon minj dhe brejtës të tjerë, por edhe kërkë, kafshë dhe shpendë shtëpijakë etj. Çakalli konsumon edhe fryta, misër e produkte të tjera bujqësore.

2. Baldosa (*Meles meles*)



- Gjatësia e përgjithëshme: 75-94cm;
- Gjatësia e bishtit: 15-19cm;
- Gjatësia e veshëve: 9-11cm;
- Pesha: 10-16kg. maksimum 20kg;
- Jetëgjatësia: 5 vjet.

Baldosa e ka ngjyrën e shpinës dhe anëve hiri, kurse barkun dhe këmbët të zeza. Dy breza të zinj që fillojnë nga turiri kapin sytë veshët dhe përhapen në trup prapa kokës. Pjesa tjetër e kokës është e bardhë. Ka shumë të zhvilluar ndëgjimin më pak nuhatjen, kurse shikimin e ka të dobët. Poshtë bishtit afër vrimës anale ka një gjendër me sekrecion të jashtëm, që lëshon një lëng me erë të keqe. Baldosa është kafshë plantigrade me putrat e mëdha, të çveshura e me kthetra të gjata. Sistemi i gjurmëve është karakteristik dhe vlen si element identifikimi. Baldosa noton dhe i qëndron besnike vëndit të jetesës. Është kafshë e mbrëmjes dhe e natës. Në dimër nuk ushqehet, por ri në strofkë dhe pi vetëm ujë, por nuk bie në letargji. E përhapur në Evropë dhe Azi. Në Evropë përfshin gati të gjithëkontinentin, me përjashtim të ekstremit verior. Tek ne gjëndet kudo si në fushë edhe në mal, por më dendur takohet në zonën kodrinore. Biotopi i saj janë pyjet, sidomos ato të fletore dhe zonat me shkure afër tokave bujqësore, vreshtave e livadheve, ku gjen ushqim. Baldosa iu largohet vëndeve të urbanizuara. Është kafshë më pak e varur nga mjedisi pyjor. Baldosa kryqëzohet në Janar-Mars, kur femra mund të bashkohet me më shumë meshkuj të të njëjtit klan, por mund të kryqëzohet edhe në kohë të tjera të vitit, prandaj këlyshë baldose shifen gjatë gjithë vitit. Veza e fekunduar qëndron e pa fiksuar në muret e uterusit për 10 muaj, pra nuk zhvillohet. Pastaj për rreth dy muaj veza zhvillohet dhe pjellja ndodh në Mars-Prill. Për ndërtimin e strofkës Baldosa hap galeri me një shpejtësi të mahnitëshme në vjeshtë, të cilën e shtron me bar të thatë për futjen e të cilit hyn mbrapsht në galeri duke e mbajtur barin me këmbët e para. Këlyshët lindin të verbër, të shurdhër e me barkun pa qime dhe qëndrojnë kështu për 28-35 ditë. Pjell gjithësej 2-7 këlyshë, të cilët ushqehen me qumësht për 2,5-3 muaj. Gjatë kohës, që është me të vegjël, familja mbahet nën kontroll nga femra, e cila merr përsipër edhe stërvitjen e të vegjëlve. Sjellje tipike e familjes së baldosës, gjatë lëvizjeve të gjata, është i ashtuquajtur i “vrapimi në kolonë indiane”, e cila ka në krye nënën, ndërsa këlyshët që vijnë pas lidhen midis tyre me nënën duke kapur e shtrënguar midis dhëmbëve bishtin e atij që është përpara. Këlyshët bëhen të pavarur në moshën 6 mujore, kurse të aftë për riprodhim në moshën 1,5-2 vjeçare. Konsumon kërmijn, insekte, larva, vezë e zogj të vegjël, këlyshë lepuri, por edhe ushqim bimor si misër, rrush, fruta të ndryshme, ehuj, lënde, kërpudha, tubera dhe filiza të njomë. Është më pak i specializuar për konsumimin e mishit.

3. Dhelpra (*Vulpes vulpes*)



- Gjatësia e përgjithëshme e trupit: 80-90cm;
- Gjatësia e bishtit: 30-40cm;
- Lartësia në shpatull: 35-40cm;
- Gjatësia e këmbës së pasme: 12-16cm;
- Peshë: 2-7kg (max 10kg).

Ngjyra në përgjithësi e kuqerremtë, me variacione duke qënë shpina e kuqerremtë, kurse pjesët e poshtëme të trupit mund të jenë të bardha në të verdha ose të erëta, gri deri në të zezë. Maja e bishtit është e bardhë. Pjesët e poshtëme të veshëve dhe ekstremitetet e këmbëve të zeza. Tek dhelpra haset fenomeni i albinizmit dhe melanizmit. Këlyshët janë ngjyrë kafe të erët me një njollë të bardhë në gjoks dhe në ballë. Ndron qimen vetëm në pranverë. Gjurma e dhelprës ka dimensionet 6x4cm. Zëri i Dhelprës është murrmuritje ose lehje. Nën bisht, 7-8cm nga rëza, ka një gjëndër aromatike me sekrecion të jashtëm. Dhelpra është kafshë jo e shoqërushme, e muzgut dhe e natës, me përjashtim të periudhës së rriprodhimit dhe kur zona është e qetë. Ditën pushon në shkure të dendura, në zgavra drurësh etj. Noton mire. Armiqtë e Dhelprës janë Ujku, Shqiponja e malit, Bufi i madh, si dhe tërbimi. Dhelpra ka një areal mjaft të gjërë në plan botëror. Në Evropë gjëndet thuajse kudo me përjashtim të Maltës, Kretës dhe Islandës. Dhelpra është besnike e vëndit ku ka lindur. Për t'u rriprodhuar, në kushte natyrore, një çift dhelprash ka nevojë për një teritor prej 3-8km². Monogam dhe kryqëzimi ndodh në strofkë, në Janar-Shkurt. Strofka është një galeri me një të zgjeruar me dy ose më shumë hyrje, të cilën e hap vetë duke e përdorur për disa vjet rrjesht ose me interval. Mund të qëllojë që të ndodhet në të njëjtën strofkë në galeri që lidhen, por në të zgjeruara të veçanta së bashku me Baldosën dhe Macen e egër. Bara zgjat 52-53 ditë e cila fillon në Shkurt. Pjell në Prill-Maj në të zgjeruarën e strofkës 4-6 këlyshë të cilët për 12-14 ditë janë të verbër. Në 3-4 javët e para të jetës këlyshët ushqehen vetëm me qumësht. Në këtë faze femra nuk e lejon mashkullin t'u afrohet këlyshëve, por pranon prej tij ushqimin që ai bie. Pastaj njëlloj si tek Ujku ata fillojnë të hanë ushqim gjysëm të tretur e pastaj të pa tretur. Megjithëkëtë dhënia e qumështit vazhdon deri në 3 muaj. Në fund ata shkojnë me prindërit në gjueti për të mësuar. Këlyshët arrijnë moshën e maturitetit në një vit. Dhelpra femër është në gjëndje të rriprodhohet deri në moshën 10 vjeçare, ndërsa mashkulli pak më gjatë. Ushqimi bazë i Dhelprës janë minjtë, por konsumon edhe insekte, bretkoca, larva, peshk, shpendë të buta ose të egra, lepuj, këlyshë derri ose kaprolli, vezë si dhe ushqim me origjinë bimore si rush, mollë, dardha, kumbulla etj. Për këtë mënyrë jetese Dhelpra, njëlloj si ujku dhe çakalli, stërvit të vegjëlit e saj, duke i marrë në gjueti e duke iu mësuar mënyrën e të ushqyerit dhe të kapjes së presë. Në këtë proces marin pjesë të dy prindërit.

4. Lundërza (*Lutra lutra*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 63-90cm;
- Gjatësia e bishtit: 37-55cm;
- Lartësia në shpatull: 30cm;
- Këmbe e pasme: 10-13,5cm;
- Pesha: 6-15kg, max 22kg;
- Jetëgjatësia: 15-18 vjet.



I ka shumë të zhvilluara të gjitha shqisat. Është kafshë plantigrade, e cila ecën me kërcime, duke i dhënë trupit anash gjë që vihet re nga sistemi i gjurmëve që le në tokë. Jashtëqitjet i ka jeshile, kur janë të freskëta, kurse të thata ngjyrë hiri. Lundërza nuk i qëndron besnike vëndit të jetesës, por ka rreze të madhe lëvizshmërie. Kafshë e shoqërushme e mbrëmjes dhe e natës, por nganjëherë shifet edhe ditën. Ruan shtigjet që del dhe hyn në ujë, noton dhe zhytet me shkathtësi, duke aritur të qëndrojë nën ujë 6-7 minuta. Armiq natyralë ka rëmbenjësit e mëdhenj, por edhe Ujkun, Ariun, etj, si dhe njeriun. Gëzofi është me shumë vlerë. E përhapur në Evropë, Azi, dhe Afrikën veriore. Tek ne gjëndet kudo afër liqeneve, lumenjve, e rezervuarëve ku ka peshk. Monogame, meqënëse gjatë gjithë vitit shifet këlyshë lundërze. Periudhat e kryqëzimit janë dy: njëra nga Dhjetori në Mars dhe tjetra nga Qershori në Korrik. Bara vazhdon 9-10 muaj dhe pranohet që tek kjo kafshë egziston dukuria e mbarsshmërisë latente d.m.th.kur kryqëzimi kryhet në Qershor-Korrik veza e fekunduar qëndron e pa zhvilluar rreth 6 muaj, pastaj fillon zhvillimin që mbaron për 60-63 ditë, ndërsa kur kryqëzimi kryhet në Dhjetor-Mars fillon zhvillimin menjëherë. Si rregull Lundërza nuk ndërton galeri, por pushton të Dhelprës ose Baldosës, ose zgavra natyrale në breg të ujrave me një dalje nën ujë dhe një hapje vertikale për ajrosje. Në muajin Prill këlyshët pillen në strofkë të verbër e të shurdhër për 28-35 ditë. Pjell 2-4 këlyshë që ushqehen me qumësht për 7-8 javë, kohë kur braktisin edhe strofkën, ndërsa mbas 10 ditësh janë në gjëndje të ndjekin kudo nënën e tyre. Këlyshët bëhen të pavarur në moshën 6-9 mujore dhe të aftë për riprodhim në moshën 1,5 deri 2,5 vjeçare. Ushqimi bazë është peshku, por konsumon edhe bretkoca, rosa të egra, brejtës të vegjël, etj. Mund të konsumojë normalisht 2-3 kg.peshk në ditë. Peshqit e vegjël i ha menjëherë në ujë, kurse të mëdhenjtë në breg. Teritori i gjuetisë është i gjërë dhe mund të arrijë deri 5-15km përgjatë lumenjve. Teritorin e markon me anë të urinës dhe jashtëqitjes

5. Lepuri i egër (*Lepus europaeus*)

- Gjatësia e përgjithëshme:55-65cm;
- Gjatësia e bishtit:7,5-10cm;
- Gjatësia e veshëve:12-15cm;
- Pesha:3,5-5 kg;
- Jetëgjatësia:5-12,5vjet.



Sekset nuk kanë ndryshim në pamjen e jashtëme. Ngjyra e zakonshme është e hirtë në të kuqeremtë e hapur e cila në dimër erësohet drejt të zezës. Këmbët e para i ka me 5 gishta të pasmet me 4. Ndër ndijimet ka të zhvilluar ndigjimin dhe nuhatjen. Zëri i mashkullit është një lloj murmurime, që dëgjohet në periudhën e kryqëzimit. Këlyshët e vegjël kanë në ballë një njollë të bardhë gjatoshë e cila zhduket me ritjen e tyre. Kakërdhitë i ka kafe të mbyllur. Është i përhapur në Evropë dhe Azi. Në vëndin tonë kudo, por më të favorshme janë zonat nga 200-400m megjithëse, mund të takohet deri edhe në 2000m lartësi. Terrenet më të përshtatshme janë ato bujqësore të alternuara me pyje të cilët të zenë 10-15% të sipërfaqes. Rrezja e lëvizshmërisë është 1-3km. Lepuri i egër është kafshë e muzgut dhe e natës, jo e shoqërushme, po të mos shqetësohet lëviz edhe ditën. Pengesat nuk i kapërren, por i përshkon. Lepuri i egër është një kafshë që mëson lehtë, kështu po qe se i shpëton një rreziku rruhet gjithmonë prej tij edhe kur ai nuk është më. Vrapon duke bërë r Rathë, që kryqëzohen me një shpejtësi maksimale prej 60-70km/orë. Noton rrallë dhe vetëm kur detyrohet. Tek Lepuri i egër mund të hasen individë që sillen si poligamë, por edhe individë që kanë natyrë monogame. Periudha e riprodhimit është Janar-Gusht. Femra në afsh le gjurmë sekrecioni nga gjëndrat ano-gjenitale dhe ato të kokës. Këto të fundit gjenden në gojë prandaj femra lëpihet për të shpërndarë aromën e kësaj gjëndre. Të njëjtin qëllim ka edhe kalimi i këmbëve të para mbi fytyrë ose të fërkuarit e fytyrës mbas shkurreve. Të gjitha këto nxisin mashkullin për riprodhim. Nuk bën kurrë galeri. Foleja është një gropë natyrale e mbrojtur dhe fshehur në mes të shkurreve dhe drurëve. Bara zgjat 42-43 ditë. Këlyshët lindin të veshur me qime dhe me sytë hapur, të cilët femra i pjell veç e veç. Pak ditë pas pjelljes ka një kryqëzim të ri deri sa brenda një periudhe riprodhimi lepuri i egër mund të bëjë 3-4 barqe këlyshësh. Numuri i këlyshëve në një pjellje është 2-5. Këlyshët 5 ditët e para pijnë vetëm qumësht, pastaj fillojnë të hanë nga pak ushqim mbasi dhënia e qumështit vazhdon rreth 3 javë. Në moshën 5-6 javore këlyshët bëhen të pavarur. Konsumon bar të freskët, hasëlle, degëza, sythe, lëvore, llstarë e fruta etj. Pi rrallë ujë, sepse atë e siguron nga jeshillëku dhe vesa. Konsumon gjithashtu edhe kafshë të vogla të ngordhura, insekte si dhe disa lloje kakërdhish të vetat.

6. Qelbësi (*Mustela putorius*)



- Gjatësia e përgjithëshme: 45-50cm;
- Gjatësia e bishtit: 13-19cm;
- Pësha: 0,7-1,7kg (♀ < ♂);
- Jetëgjatësia: 15-17 vjet (në robëri 14 vjet).

Gëzofi ka dy kategori qimesh e para të shkurtëra në formë pushi të dendur me ngjyrë të verdhëremë, e dyta të gjata të ralla me ngjyrë kafe të errët. Maja e hundës është e bardhërreme, buzët, majat e veshëve, rrethi i syve janë të verdhë të hapur, kurse anash trupit dhe poshtë gëzofi është më i hapur. Lëshon një klithmë karakteristike ose ka një të çfryrë si të macës. Ndër shqisat më të zhvilluar ka nuhatjen. Në zonën anale ka një gjëndër me sekrecion të jashtëm që lëshon një lëng me erë të keqe, kur kafsha është e frikësuar. Qelbësi është kafshë jo e shoqërushme e mbrëmjes dhe e natës, kurse ditën rri në strofkë. I qëndron besnik vëndit të jetesës. Mund të notojë dhe të zhytet shumë mire, ndërsa rrezën e lëvizshmërisë e ka më të vogël se Zardafi dhe Kunadhja. Ka vetinë se trembet nga tingujt e sendeve metalike. Putrat e Qelbësit janë me nga pesë gishta, ndërsa sistemi i putrave në lloje të ndryshme ecjeje: në ecje të zakonshme, në ecje të shpejtë dhe me vrap. I përhapur në Evropë ku përfshin thuajse të gjithë kontinentin si dhe në Azi. Tek ne gjëndet kudo si në zonat malore ashtu dhe në zonat fushore. Preferon livadhet relativisht të lagëta afër vëndeve moçalore, guroret e braktisura, grumbujt me gurë, mullarët e barit, togjet e fashinave, stivat e druve, kanalet, urat të gjitha këto me drurë të shpërndarë të moshave të ndryshme etj. Në këto mjedise shfrytëzon galeritë egzistuse. Qelbësi është lloj poligine tek i cili mashkulli frekuenton zonat e 2-3 femrave. Kryqëzimi ndodh në Mars-Prill, ndërsa bara zgjat 40-42 ditë. Pjellja ndodh në Qershor-Korrik, në strofkë, e cila është një grumbull bimësh të thata, pendësh dhe qimesh të vendosura në një zgavër druri, ose muri, në një galeri, stive drush ose gurësh etj, ku femra pjell 3-7 këlyshë, 6-7cm të gjatë, të cilët lindin të verbër dhe lakuriq ose të mbuluar me qime të rralla të bardha. Këlyshët dalin nga strofka në moshën 40 ditëshe, bëhen të pavarur në 3 muaj dhe arrijnë pjekurinë seksuale në moshën 9 mujore. Konsumon minj, lepuj, bretkoca, gjah të vogël me pendë që folezon në tokë si Shkurta, Thëllëza, por edhe shpendë të buta. Konsumon gjithashtu edhe fryta, peshk, mjaltë etj. Qelbësi ka vetinë që një pjesë të ushqimit ta depozitojë si rezervë në galeri, ku ka një të ndarë të posaçme për këtë qëllim, për ta konsumuar kur ushqimi mungon ose është i pa mjaftueshëm.

7. Nuselale (*Mustea nivalis*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 17-27cm;
- Gjatësia e bishtit: 4-6,5cm;
- Gjatësia e këmbës së pasme: 2-3cm;
- Peshë: 65-125g. (mashkulli më i madh se femra);
- Jetëgjatësia: 8 vjet.



Midis sekseve nuk ka ndryshim në ngjyrosje. Ngjyra e gëzofit sipër është kafe në bezhë kurse gusha, gjoksi dhe barku janë të bardha. Zëri i Nuselalës, kur është e qetë, është një fishkëllimë melodioze. Shqisat i ka të gjitha shumë të zhvilluara. Në arealin e saj të gjërë të përhapjes, i cili shtrihet në Evropë, Azi, Amerikën e veriut, etj. Në vëndin tonë gjëndet kudo. Biotopi i saj përbëhet nga çdo teren i thatë me kushte për strehim si shkure, pyje të vegjël, anë pylli, kopshte, stiva drush, mullarë bari, koçekë misri, gërmadha etj. Nuselala kërkon qetësi si dhe prezencën e ujit, në afërsi të vëndit të jetesës. Është kafshë nate e shoqërushme, por mund të bëjë edhe jetë individuale dhe të jetë aktive edhe ditën. Armiqtë e saj natyralë janë Dhelpra dhe shpendët rëmbenjës si ata të ditës ashtu dhe ata të natës. Kryqëzimi i parë ndodh në mars-Prill. Bara zgjat 5 javë, ndërsa këlyshët 4-9 pillen në srofkë, e cila ndërtohet në një galeri egzistuese në stivat e gurëve, të drurëve, në mullarët e barit etj. Ata janë të verbër për 25 ditë. Dhënia e qumështit vazhdon 4 javë, të pavarur këlyshët bëhen në moshën 3-4 mujore, ndërsa të aftë për riprodhim pa mbushur akoma vitin e parë. Konsumon minj, dhe me raste shpendë, lepuj, amfibë, reptile, dhe invertebrorë të ndryshëm. Konsiderohet si një nga mustelidet më agresive dhe gjaksore, gjë që demonstron edhe nga fakti se ajo shpesh kufizohet vetëm me pirjen e gjakut të presë, duke bërë një vrimë të vogël e cila fryhet në qafën e viktimës. Teritori i saj i gjuetisë është mjaft i gjërë dhe mund të arrijë 6-7ha, në të cilin nuk le të hyjë nusëlale tjetër.

C. SHPENDËT

1. Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 161-196cm;
- Krah: 65-75cm;
- Hapja e krahëve: 310-345cm;
- Pesha: 6,5-10kg;
- Jetëgjatësia: 52 vjet.



Ngjyra e përgjithëshme e bardhë me pendët fluturuese të krahut kafe në të zezë. Në kokë dhe zverk pendët i ka të përdredhura, sytë gri, ndërsa këmbët gri të kaltërreme. Sqepi shumë i madh me pjesën e sipërme të fortë e me vija që përfundon me një thua si çengel, e pjesën e poshtëme të paisur me një trastë të gjërë membranore ngjyrë portokalli në të kaferemë. Shpendët e rinj janë ngjyrë gri në kafe sipër dhe të bardhë poshtë, ngjyrë e cila me moshën zbardhet. Të rriturit janë gri në të bardhë me pendë “kaçurrele” në kokë, sqep të madh me “çantë” të kuqe të ndritshme gjatë periudhës së rriprodhimit. Pelikani kaçurrel është folezues kolonial, monogam. Folezon i veçuar ose në koloni. Folenë e bën në tokë, me shkopinj, bar, pendë dhe me mbeturina bimore, në formë trung-koni, me diameter 2m dhe lartësi 60-70cm. Është folzues i hershëm, dhe inkubimin e fillon që në muajin Shkurt. Lëshon 1-5 vezë, të bardhërreme e të gëlqerizuara me dimensione 9,3x5,8cm dhe peshë 143-195g., dhe i ngroh për një periudhë nga 38-40 ditë. Suksemi i rriprodhimit varet shumë nga qetësia e mjedisit ku folezon. Nëse përgjatë periudhës së rriprodhimit, ky lloj shqetësohet atëherë kjo shkakton sukses të ulët ose dështim të rriprodhimi. Të vegjlit fitojnë aftësinë e fluturimit në një moshë rreth 65-85 ditore, dhe bëhen krejtësisht të pavarur në një moshë rreth 105 ditore dhe arrijnë peshën e të rriturve në 75 ditë. Maturinë seksuale e fiton në një moshë nga 3-4 vjeçare. Është lloj filopatrik, çka do të thotë se është ngushtësisht i lidhur me mjedisin ku folezon, pasi folezon gjithmonë në të njëjtin vend. Në Evropë është i përhapur në Juglindje të saj, ku vëndi ynë përfaqëson ekstremin më Perëndimor. Folezon në deltën e Danubit, Bullgari, Greqi, detin Kaspik dhe Azov; deltën e Vollgës dhe në disa pika në Azinë qëndrore deri në Mongoli. Në vendin tonë folëzon vetëm në Lagunën e Karavastasë, në një ishull, i cili ka marrë edhe emrin “Ishulli i Pelikanit”. Por haset shpesh edhe në zona të tjera si në Lagunën e Nartës, në Liqenin e Shkodrës, në Liqenet e Prespave, dhe më rrallë në zona të tjera, si psh Liqeni i Ohrit, Liqeni i Thanës etj. Ushqehet kryesisht me peshq. Çdo individ konsumon 1,5-2kg peshq në ditë.

2. Karabullaku i detit (*Phalacrocorax carbo*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 80-90cm;
- Krahu: 54-56cm;
- Hapja e krahëve: 130-150cm;
- Pesha: 2-2,5kg;
- Jetëgjatësia: 20 vjet.



Ngjyra e përgjithëshme e zezë, me reflekse metalike blu të murme, sidomos në pjesën e poshtme të trupit, faqet dhe grykën i ka të bardhërreme, puplat e supeve ngjyrë bostani në kafe, me rrethoja të gjelbërreme në të zezë. Puplat rreth pjesës së zhveshur të fytyrës i ka të bardha. Në pranverë gusha, e më pak koka, mbulohen me pupla të dendura, të holla, me ngjyrë të bardhërreme. Bishti ka 14 pendë drejtuese, sqepi është i fortë, i murmë me bazën më të çelur e majën të kthyer si ganxhë, sytë të gjelbër në të verdhë, pjesën e zhveshur, rreth syve, të murme në ulliri, kurse këmbët me lëkurë notuese të zezë. Maksilari i poshtëm ka trastë membranore, por shumë më të vogël se pelikanët. Zhytet aktivisht në ujë 2-9m thellë, duke qëndruar nën ujë 30-70 sekonda. Lloj kozmopolit. Takohet në të gjitha kontinentet, duke qënë lloji më i përhapur e familjes. Në Evropë është i përherëshëm, veronjës dhe dimëronjës. Në vëndin tonë është i përherëshëm e me shumicë në lagunat bregdetare dhe në liqenet e Pogradecit dhe të Prespave. Çerdhen e vendos në tokë, në ishuj të qetë e me bimësi të lagunave ose edhe mbi drurët që gjenden afër ujërave, në koloni me llojin e vet ose lloje të tjera. E ndërton me thupra barishte e leshterikë, ku pjell 3-5 vezë, me përmasa 6,5x4cm, ngjyrë blu të hapur, me lëvozhgë të gëlqerizuar dhe me cifla. Zogjtë çelin lakuriq, të dobët e të zhveshur dhe vetëm mbas dy javësh mbulohen nga një push i zi. Inkubacioni vazhdon 29 ditë dhe bëhet vetëm nga femra. Duke qënë nidikolë (shpendët që nuk braktisin folenë përnjëherë dhe të vegjëlit qëndrojnë deri në momentin që janë të aftë për të fluturuar, quhen “nidikolë”) arrijnë peshën e të riturve në moshën 35 ditëshe, ndërsa fluturojnë dhe bëhen të pavarur në moshën 60 ditëshe. Ka raste në vitet e favorshme, kur ky shpend mund të bëjë dy barqe vezësh në vit. Ushqehet vetëm me peshk, racioni ditor i nevojshëm është sa një e pesta e peshës së tij trupore.

3. Flamingo (*Phoenicopterus ruber roseus*)

- Gjatësia: 120-145cm,
- Krahu: 140-170cm.



Shpendët që nuk braktisin folenë përnjëherë dhe të vegjëlit qëndrojnë deri në momentin që janë të aftë për të fluturuar, quhen “nidikolë”: Janë shpendët më të pikatur për shkak të kontrasteve midis ngjyrave rozë të zezë dhe të bardhë. Shpend të mëdhenj që jetojnë në cekcina të kripura ose ujëra të njelmëta. Krahë dhe këmbë tepër të gjatë. Sqep i madh, i rëndë, i përkulur. Lloji evropian “*roseus-kuq*” riprodhohet në koloni të mëdha, në ishuj dhe brigje të ulëta, në bregdete të gjera, të hapura, të cekëta dhe baltore ose në liqene të kripura, gjire detare etj. Të pangatërrueshëm me lloje të tjerë. Të bardhë me nuanca rozë, mbulojë të krahëve të kuqe dhe pendë fluturuese të zeza. Sqepi është kryesisht në ngjyrë të kuqe tëçelet, me majë të zezë, ndërsa këmbët janë tërësisht rozë (pa ngjyrën e kuqe flakëruese të gjunjëve). Puplimi është më shumë i bardhë se sa rozë. Shpesh i parë në tufa të mëdha, shumë të ngjeshura (duken si një brez i ngushtë rozë e zbardhët në horizont). Në fluturim ngjyra e kuqe, në krahë, është e dukshme, qafa dhe këmbët mbahen të shtrira plotësisht (qafa është pak e rënë). Të rinjtë ngjyrë kafe-gri dhe të zbardhur, ngjyra e kuqe mungon. Ushqimi bimor dhe shtazor i ujërave. Ngre fole në pirgje me baltë. Zëri në trajtën e kakarisjeve të forta, që të kujtojnë pak thirrjet e patave. Lëshojnë gjithashtu tinguj trumpete si edhe hungërima.

4. Çafka e bardhë e vogël (*Egretta garzetta*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 55-65cm;
- Krah: 26-31cm;
- Hapja e krahëve: 83-95cm;
- Pesha: 0,5 kg;
- Jetëgjatësia: 9 vjet.



Trupin e ka plotësisht të bardhë, në kokë ka një çafkë gjithashtu të bardhë kurse mbi shpinë në kohën e kryqëzimit ka pupla të holla në formë fijesh të bardha. Sqepin e ka të zi, këmbët e zeza me gishta të verdhë, kurse «freri» në fazën e çiftëzimit është i kuq, ndërsa në periudhat e tjera gri në blu. Fluturon me qafën e mbledhur në formën e gërmës (S). Gjendet në pjesën më të madhe të Evropës Jugore, është veronjëse, por ka edhe zona ku ajo është e përherëshme dhe dimëronjëse. Takohet, gjithashtu, edhe në Afrikë, ku dimëron shumica e kësaj Çafke, në Azinë qëndrore e Jugore, në Australi etj. Në vëndin tonë është e përherëshme, në sasi të konsiderushme. Biotopi i saj janë lagunat bregdetare me bimësi ku edhe folezon, por edhe liqenet e brendëshme me shtrirje të madhe, lumenjtë, kënetat e kripuea etj. Është monogam, folezon në koloni, me çafkat e tjera dhe Karabullakët, mbi drurë të lartë, afër ujërave ose edhe në kallamishte, ku pjell 3-5 vezë me dimensione (4,3x3,4 cm), ngjyrë qielli në të gjelbër të hapur. Intervali i pjelljes së vezëve, nga njëra tjetra, 2 ditë, kurse inkubacioni që zgjat 21-25 ditë, fillon mbas pjelljes së vezës së parë dhe

realizohet nga të dy partnerët. Zogjtë lindin nidikolë, të mbuluar me push të bardhë, duke patur sqepin dhe këmbët rozë, që shpejt bëhen gri në blu. Në moshën 3 javore zogjtë dalin nga çerdhja, por qëndrojnë rrotull saj, ndërsa në 5 javë marrin fluturimin. Konsumon peshq të vegjël, bretkoca, hardhuca, krimba, insekte dhe kafshë të tjera të vogla uji.

5. Bajza (*Fulica atra*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 36-43cm;
- Krahu: 19-23cm;
- Hapja e hrahëve: 70-80cm;
- Pesha: 0,58-0,90 kg;
- Jetëgjatësia: 18 vjet.



Ngjyra e përgjithëshme e trupit për të rriturit e hirtë në të zezë, më e theksuar në qafë dhe në kokë, dhe ball i bardhë, ndërsa për ekzemplarët e rinj e bardhëremë në kafe. Sqepin e ka të bardhë, kurse në ballë në vazhdim të sqepit ka një pllakë brinore të zhveshur me ngjyrë të bardhë ndërsa gishtat e këmbëve i ka të paisura me membrana notuese të veçanta. Këmbët i ka të gjelbërre me pjesën e zhveshur të tibias ngjyrë portokalli, kurse gishtërinjtë blu. Fluturon me këmbët e varura ose të shtrira mbrapa. Femra është më e vogël se mashkulli, por në pamjen e jashtme nuk ndryshojnë. Në Evropë është e përherëshme, veronjëse dhe dimëronjëse vetëm në Islandë, por takohet në Azi, Afrikën veriore, Australi dhe Amerikën veriore. Lloj shumë i zakonshëm në vëndin tonë. Haset pothuajse në të gjitha mjediset e mëdha ligatinore dhe liqenore (përfshirë edhe rezervuarët artificialë) të vendit tonë. Është e përherëshme dhe dimëronjëse në sasi të madhe. Ekzemplarët që dimërojnë vijnë nga Veri-Lindja, në Tetor dhe largohen në Mars. Biotopi i saj janë lagunat bregdetare, por edhe liqenet dhe rezervuarët e brendshëm, të veshur me bimësi ku ajo fshihet dhe ndërton çerdhen. Është monogam, çerdhen e ndërton midis kallamash të varur ose mbi një tog lundruer kashte dhe bimësh të vdekura kënetore. Gjithashtu folezon përdhe në zona bregdetare, herë pas here edhe në shkurre dhe pemë të vogla ose në ujë të hapur në sipërfaqe ujore të cekëta. Tek ky lloj, foleja ndërtohet nga të dy partnerët, po ashtu edhe inkubimi dhe udhëzimi i të vegjëlve. Riprodhues i vetmuar me 1-2 inkubime në vit; ku femra, në Prill-Maj, pjell 5-10 vezë, me dimensione (4,5x3,5cm), ngjyrë të bardhë, të shndritëshme ose të kuqeremtë në gri, me pika, me interval pjelljeje veza nga veza prej 1 dite, të cilat ngrohen nga të dy partnerët për 21-25 ditë. Inkubacioni fillon pas pjelljes së vezës së fundit. Zogjtë lindin të mbuluar me një push të erët e kokën e kuqe, të cilët vetëm disa ditë (5-6) qëndrojnë në çerdhe, pastaj ndjekin prindërit (pra janë nidifugë). Mbas një muaji janë në gjëndje të ushqehen vetë, kurse në dy muaj fluturojnë. Bajza është shpend i shoqërushëm, e cila në kohën e vjeshtës bashkohet në tufa, duke kaluar dimrin së bashku. Zhytet deri 2m, më rrallë 4-5m thellë, ku qëndron 2-10 sekonda. Pjekurinë seksuale e arrin në moshën një vjeçare, por zakonisht pjell pasi

të ketë mbushur 2 ose 3 vjet. Para se të fluturojë vrapon mbi ujë duke rrahur krahët, por pasi ngrihet në fluturim pastaj mund të përshkojë distanca të mëdha. Armiqtë e bajzës janë skifterat dhe shqipet e kënetës. Ky lloj është kryesisht aktiv gjatë ditës dhe në muzg. Konsumon bimë uji që i mbledh ose në sipërfaqe ose duke u zhytur, por konsumon edhe insekte uji, larva, kërminj, dhe me rast edhe vezë peshku. Ushqehet ditën, natën fle në çerdhe ose midis bimësisë.

6. Thëllëzë fushe (*Perdix perdix*)

- Gjatësia e përgjithshme: 29-31cm;
- Krah: 15-16cm;
- Hapja e krahëve: 45-48cm;
- Pesha: 350-450g;
- Jetëgjatësia: 7 vjet.



Ngjyra e përgjithëshme e trupit e hirtë, ndërsa koka dhe gusha të kuqerremta, për të dy sekset. Sqepin e kanë të përhimë në të gjelbërremë, këmbët të përhimë në të kaltërt, ndërsa sytë kafe. Tek mashkulli ngjyra e shpinës tenton drejt kafes në të kuqerremtë, ndërsa në bark ka një njollë të madhe kafe të erët në gështenjë në formë patkoi. Por kjo shënjë nuk është një karakteristikë e sigurt seksuale, mbasi një njollë të tillë e kanë edhe femrat e vjetra. Karakteristikë më e sigurt seksuale janë pendët skapulare, të cilat, tek meshkujt, janë gri uniforme, kurse tek femrat në po këtë ngjyrë, por me 3-4 breza transversal, me ngjyrë të hapur gati të bardhë. Ndër shqisat ka të zhvilluar mirë ndëgjimin dhe shikimin. Thëllëza e fushës nuk qëndron asnjëherë mbi drurë, fluturon rëndë dhe zhgryet në pluhur, për tu pastruar nga parazitët. Është e përhapur në Evropë dhe Azi. Po kështu dhe në vëndin tone, në të gjithë zonën fushore dhe kodrinore, kryesisht në Fier, Lushnjë, Lezhë, Shkodër, Korçë, Kolonjë, Peshkopi, Vlorë, Berat, etj. Biotopi i saj janë zonat kodrinore e fushore të kultivuara me lloje të ndryshme bimësh bujqësore, por ku ka edhe zona me shkure. Në masivet e mëdhenj pyjorë nuk hyn veç se në anë. Në dimër preferon shpatet jugore, kurse në verë ato veriore. I përshtaten më mirë zonat me toka të lehta. Është monogame. Jeton në tufa, që formohen në fillim të dimërit, nga fundi i të cilit (15 Shkurt-15 Mars) tufat prishen dhe formohen çiftet partnerët e të cilëve mund të qëndrojnë disa vjet pa u ndarë. Tek ky lloj janë femrat ato që zgjedhin meshkujt gjithmonë jo nga tufa e tyre. Çdo çift mbron një teritor të caktuar. Çerdhja ndërtohet në tokë, në një gropëzë, me diametër 12-15cm, thellësi 5-8cm, e fshehur në mes të bimësisë. Në fillim të Majit femra pjell 9-3 vezë, me interval një ditor, ngjyrë bezhë në kafe, me dimensione 3,5x2,7cm. Inkubacioni vazhdon 24-25 ditë dhe kryhet vetëm nga femra, ndërsa mashkulli rri 30-50m larg çerdhes dhe e mbron atë, duke

marrërrëzikun e mundshëm mbi vehte. Femra në inkubacion del për t'u ushqyer në mëngjez dhe mbrëmje, duke i mbuluar vezët me bar të thatë. Tek Thëllëza e fushës është shumë e zhvilluar ndjenja e familjes. Zogjtë janë nidifugë, mbrohen dhe kujdesohen nga të dy prindërit. Kur mbushin moshën 2 javore fillojnë të fluturojnë, ndërsa arrijnë peshën e të riturve në 3,5-4 muaj. Zogjtë bëhen të pavarur në moshën 9 mujore dhe arrijnë pjekurinë seksuale në moshën një vjeçare. Thëllëza e fushës është një lloj shumë i njohur dhe studjuar në Evropë. Në kushte normale racioni i saj ushqimor përbëhet nga bimë të gjelbra, fara drithërash të kultivuara, fara bimësh të egra, insekte kryesisht milingona dhe larvat e tyre dhe guralecë, për tretjen e ushqimit. Në fakt përbërja e ushqimit ndryshon me stinën. Si rregull, në verë, ushqehet në mëngjez dhe mbasdite, kurse në dimer, kur ushqimi është i pakët, e kërkon atë gjithë ditën.

7. Shqiponja e madhe e rosave(*Aquila clanga*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 65-72cm;
- Krahu: 54-56cm;
- Hapja e krahëve: 152-182cm;
- Pesha: ♂1,65-1,95kg; ♀1,75-2,50kg;
- Jetëgjatësia: 18 vjet.



Nuk ka dallim midis sekseve në ngjyrosje. Ngjyra e përgjithëshme kafe e erët me rreflekse sitë bakrit. Pendët e mbibishtit janë të bardhërreme, ndërsa fluturueset primare të zeza me pjesën e rrënjës të bardhë. Sqepin e ka të zi, lëkurën mbi sqep dhe këmbët të verdha, kurse sytë kafe. Mund të konfondohet lehtë me Shqiponjën e vogël të rosave prej të cilës dallohet nga ngjyra më e erët e pendëve mbuluese të nënkrahëve. Shpend shtegtar që veron në një zone të gjërë që fillon nga Evropa Veri-Lindore vazhdon në Azinë veriore dhe përfundon në Lindjen e largët. Në Shqipëri haset gjatë dimrit, kur shtegton, në zona me pyje të rrallë në bregdet, afër kënetave dhe liqeneve. Llojmonogam qëfolezon në pyje, afër rrjedhjes së ujërave, mbi drurë, duke shfrytëzuar çerdhet e vjetra të rrëmbenjësve ose duke e ndërtuar vetë, në lartësi 8-12m. Në Maj-Qershor femra pjell 2 vezë, të bardha në gri që ngrohen për 41 ditë, duke filluar mbas pjelljes së vezës së parë. Zogjtë janë nidikolë për 60-65 ditë. Konsumon minj, por edhe shpendë të ndryshme, peshq, rreptilë, molusqe dhe insekte të mëdhenj. Në dimer, kur ushqimi mungon, mund të konsumojë edhe kërma.

8. Huta (*Buteo buteo*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 51-57cm;
- Krahu: 7,8-25,5cm;
- Hapja e krahëve: 113-128cm;
- Pesha: ♂ 550-850g; ♀ 700-1200g;
- Jetëgjatësia: 25 vjet.



Ndër rrëmbenjësit e ditës Huta është më i denduri. Pa dimorfizëm seksual, ngjyra e përgjithëshme e trupit është kafe e mbyllur me njolla të bardha në bark dhe në pjesën e poshtme të krahëve. Numuri i njollava është i ndryshëm nga individi në individ. Në bisht ka breza transversale të ngushtë në ngjyrë kafe dhe hiri mjaft të dendur. Lëkura në bazën e sqepit dhe këmbët janë të verdha, sqepi afërsisht i zi, sytë të murme në të kuqeremta ose të verdhërreme. Shpend i qëndrueshëm. Huta mendohet se ka shikimin më të shkëlqyer ndër shpendët rrëmbenjës. Në pjesën më të madhe të Evropës është e përherëshme, por në pjesën veriore të kontinentit është vetëm veronjëse, në dimër zbresin në Jug një pjesë deri në Afrikën e veriut. Në vëndin tonë është i përherëshëm, kurse në dimër më me shumicë. Haset dhe folezon kudo nga zonat e ulta deri në male. Biotopi i saj janë pyjet, sidomos ato të fletorëve si dhe fushat, vëndet djerrë, livadhet kënetorë luginat e lumenjve. Monogam, në pranverë, në periudhën e kryqëzimit, fluturon në lartësi të mëdha, duke formuar rrathë pa rrahur krahët e duke nxjerë klithma karakteristike. Çerdhen e ndërton mbi drurë të lartë, në bigëzimin e degëve kryesore, të cilën e ndërton me degë e degëza të thata e pastaj material të butë, të cilën e përdor për disa vjet duke e riparuar. Nuk okupon çerdhet e të tjerëve. Në Mars-Prill femra pjell 2-4 vezë, me dimensione 5,7x4,6cm të bardha, me njolla të hirta të kuqeremta e kafe. Inkubacioni vazhdon 35 ditë, ndërsa zogjtë janë nidikolë për 6-7 javë (shpendët që nuk braktisin folenë përnjëherë dhe të vegjëlit qëndrojnë deri në momentin që janë të aftë për të fluturuar, quhen “nidikolë”). Megjithëse në moshën 1,5-2 mujore fluturojnë vazhdojnë të mbeten të varur nga prindërit për problemin e ushqimit deri në fund të verës. Pjekurinë seksuale e arrijnë në moshën 2 vjeçare. Konsumon minj, lepuj, reptile, bretkoca, insekte, kërma dhe rrallë shpendë. Kap në fole të vegjëlit e lepurit dhe të shpendëve që folezojnë në tokë si thëllëzat, shkurtat etj.

9. Skifteri kthetraverdhë (*Falco naumanni*)

- Gjatësia e përgjithëshme: 29-32cm;
- Krahu: 21-26cm;
- Hapja e krahëve: 58-72cm;
- Pesha: ♀ 140-210g; ♂ 90-170g;
- Jetëgjatësia: 6 vjet.



Mashkulli kokën dhe bishtin i ka gri në blu, kurizin ngjyrë ndryshku, ndërsa pendët fluturuese primare janë gri dhe përfundojnë me një brez të zi, brez i cili gjëndet edhe tek femra. Dallohet nga mashkulli i Skifterit kthetrazi sepse mbi krahë ka një brez ngjyrë qielli dhe mbi kuriz nuk ka njolla të zeza. Femra ka një ngjyrosje të përgjithëshme kafe me njolla e vija të errëta. Është e ngjashme me femrën e Skifterit kthetrazi, por dallohet prej saj nga ngjyra e kthetrave që janë të zeza për kthetraziun dhe të bardhërreme për kthetraverdhin. Me femrën ngjasin edhe zogjtë që s'kanë aritur maturitetin. Shpend i shoqërushëm dhe më i zhurmshëm se kthetraziu. Në Evropë, por edhe tek ne, është veronjës që vjen në Mars-Prill dhe largohet në Gusht-Shtator. Takohet sidomos gjatë shtegtimit në tufa të mëdha në ultësirën bregdetare dhe në luginën e Vjosës. Biotopi i tij janë terrenet e hapura në afërsi të qendrave të banuara. Është monogam dhe folezon në koloni. Realisht nuk bën çerdhe, por vezët i vendos në zgavrat e shkëmbenjve, në gërmadha etj, shpesh së bashku me shpendë të tjera jo rrëmbenjësë. Në Maj pjell 4-5 vezë, të kuqërreme me shumë njolla të kuqe tulle ose të kuqe në të murme. Inkubacioni vazhdon 28-31 ditë dhe kryhet kryesisht nga femra. Zogjtë bëhen të aftë për fluturim në moshën 4 javore dhe arrijnë pjekurinë seksuale në një vit. Konsumon kryesisht insekte dhe minj.

D. DISA LLOJE TË TJERA PREZENTE NË PEIZAZHIN E MBROJTUR



Ngjala (*Anguilla anguilla*)



Kocja (*Sparus aurata*)



Levrek (*Dicentrarchus labra*)



Qefulli (*Mugil cephalus*)



Breshka e detit (*Caretta caretta*)



Delfini (*Delphinus delphis*)



Breshkë uji (*Emys orbicularis*)



Breshka (*Testudo hermanni*)



B.barkëverdhtë (*Bombina variegata*)



B.kërcimtare (*Rana dalmatina*)



Gj. i vogë i ujit (*Natrix natrix*)



Bolla 4 vija (*Elaphe quatuorlineata*)

4. PLANI I MENAXHIMIT TË ZONËS SË MBROJTUR

Me qëllim për të ruajtur biodiversitetin dhe vlerat natyrore të ZM sipas kategorisë përkatëse dhe në të njëjtën kohë të lejohet komuniteti lokal të përdori burimet natyrore dhe të zhvillojë turizmin, plani i menaxhimit për të gjithë zonën e parkut është dokumenti më i rëndësishëm i cili garanton balancën midis konservimit dhe përdorimit drejt përdorimit të qëndrueshëm. Planin e Menaxhimit është një instrument ligjor për menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm, duke siguruar konservimin e biodiversitetit dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve. Është gjithashtu shumë e rëndësishme metodologjia e pjesëmarrjes e aplikuar për hartimin e Planit të Menaxhimit ku çdo institucion dhe grup interesi punojnë së bashku dhe vazhdojnë të bashkëpunojnë për zbatimin e planit.

Planin e Menaxhimit dhe Planin e tij i Veprimit janë instrumenta ligjor që miratohen nga Ministri përgjegjës për Mjedisin/ZM. Është gjithashtu një instrument planifikimi për tu përfshirë në politikën, planet, programet dhe aktivitetet publike të lidhura me të, dhe në procesin e vendim-marrjes në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Qëllimi kryesor i planit të menaxhimit është krijimi i platformës ligjore, shkencore, administrative dhe financiare për institucionet përgjegjëse dhe palët e interesuara, me qëllim që të arrihet objektivi kryesor i ZM të miratuar e shpallur si e tillë, për ruajtjen dhe përmirësimin e biodiversitetit, trashëgimisë natyrore dhe vlerat e peisazhit, për përfitime të qëndrueshme të komunitetit lokal nga përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore. Planin e menaxhimit i drejtohet direkt Administratës dhe Komitetit të Menaxhimit të parkut kombëtar, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e tij. Çdo institucion, organizatë, dhe komuniteti lokal i parkut kombëtar janë të detyruar të zbatojnë planin e menaxhimit dhe të ndërmarrin aktivitetet e tyre në park në përputhje me vizionin dhe objektivat e tij. Planin e menaxhimit përfshin Planin e Veprimit për zbatimin e tij. Ndërgjegjësimi i Publikut dhe edukimi mjedisor janë komponentë të Planit të veprimit i cili përmban masat për tu zbatuar. Ky modul është një instrument i dobishëm që do të kontribuojë për zbatimin në mënyrë të vazhdueshme të aktiviteteve të edukimit mjedisor për shkollat dhe për publikun në përgjithësi.

ANEKSI 2 - Lista e Festave Mjedisore

- Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar – 27 janar
- Dita Botërore e Ligatinave – 2 Shkurt
- Dita Botërore e Eficiencës së Energjisë – 5 mars
- Dita Botërore e Harabelave – 20 Mars
- Dita Botërore e Ujit – 22 Mars
- Ora e Tokës – 23 Mars
- Dita Evropiane e Parqeve – 24 mars
- Dita Ndërkombëtare e Zogjve – 5 prill
- Dita e Tokës – 22 Prill
- Dita Ndërkombëtare e Zogjve Migrues – 3 Maj
- Dita Ndërkombëtare e Ndryshimeve Klimatike – 15 maj
- Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit – 22 Maj
- Dita Evropiane e Parqeve Natyrore – 24 Maj
- Dita Botërore e Mjedisit – 5 Qershor
- Dita Botërore e Oqeaneve – 8 Qershor
- Dita Botërore e Lluftës kundër Shkretëtirëzimit dhe Thatësirës- 17 Qershor
- Dita e Liqenit të Ohrit – 21 qershor
- Dita pa Makina – 22 Shtator
- Dita Botërore e Turizmit – 27 shtator
- Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve – 4 tetor
- Dita Botërore e Habitave – E hëna e parë e Tetorit
- Dita Ndërkombëtare e Ecjes në Natyrë – 15 tetor
- Dita Botërore e Mbjelljes së Pemëve – 22 Tetor
- Dita Ndërkombëtare e Veprimtarive Klimatike – 24 Tetor

MODULI 2 - EDUKIMI MJEDISOR NË KURRIKULËN E RE

Përfituesit nga trajnimi:

Përfituesit nga realizimi i këtij moduli janë:

- Mësuesit e arsimit bazë, duke përfshirë arsimin fillor dhe ciklin e mesëm të ulët

1. Rezultatet e pritshme.

Pjesëmarrësi në trajnim:

1. Rëndësia e edukimit dhe e ndërgjegjësimit për zonat e mbrojtura
2. Evidentimi i problematikave aktuale në zonat e mbrojtura të Vlorës
3. Integrimi në kurrikul i konceptit të edukimit mjedisor
4. Njohja e hapësirave që krijon kurrikual e re për trajtimin e aspekteve të ndryshme të edukimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor
5. Planifikimi i aktiviteteve të para në kuadrin e këtij projekti

2. Përshkrimi i përmbajtjes.

Edukimi Mjedisor përfaqëson përpjekje të organizuara për të mësuar se si funksionon mjedisi natyror dhe, në veçanti, se si njerëzit mund të menaxhojnë sjelljet e tyre dhe ekosistemet për të jetuar në mënyrë të qëndrueshme. EM si një përpjekje e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Arsimit është pjesë e kurrikulës së re dhe trajtohet si në kompetencat kyçe, në programet mësimore të fushave të ndryshme kurrikulare, si dhe në hapësirat që krijon kurrikula me zgjedhje për të trajtuar aspektet e ndryshme të tij.

EM vjen me disa dimensione dhe secili prej tyre duhet marrë në konsideratë në mënyrë të veçantë me qëllim që të arrihen rezultatet e dëshiruara. Ky modul dhe trajnimi që zhvillohet nëpërmjet tij ka në vëmendje të nxisë mësuesit dhe nxënësit të punojnë për edukimin mjedisor, ta prekin natyrën dhe të kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit dhe në pasurimin e tij. Të jesh një shkollë pranë një Zone të mbrojtur është sa fat, aq edhe përgjegjësi. Kjo është arsyeja pse po ndërmerret ky program trajnimi dhe si ai do të realizohet nga vetë shkollat e përfshira në projekt.

EM është i lidhur me ndërgjegjësimin dhe krijimin e ndjeshmërisë për mjedisin, me parashikimin e pasojave që do t'i përjetojë mjedisi në një të ardhme jo fort të largët; ka të bëjë me sfidat mjedisore që shpesh dalin përtej kufijve të mundësive dhe kujdesit për mjedisin; kanë të bëjnë me njohjen e botës dhe të jetës së mjedisit në zona të caktuara; është e lidhur me ruajtjen e cilësisë së mjedisit dhe me evidentimin në kohë të problematikave dhe shqetësimet mjedisore.

Në fakt konceptimi i kurrikulës së re e ka patur në vëmendje EM. Një nga 7 kompetencat e saj kyçe është: Kompetenca për jetën, mjedisin dhe sipërmarrjen. Siç përmendet edhe në përshkrimin e kësaj kompetence “Shkollat përgatitin nxënësit për të jetuar, për të punuar në një botë të ndërlikuar dhe për t’u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI kërkon kompetenca për t’u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitete për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Për të zhvilluar këtë kompetencë, shkolla iu krijon nxënësve kushte që të kuptojnë tërësisht ndërvarësinë ndërmjet dukurive ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë vendore dhe globale. Ajo mundëson që nxënësit të orientohen drejt së ardhmes, të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, shkolla i ballafaqon nxënësit me problemet ekologjike, për t’i ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm”.

Në këtë këndvështrim, nga nxënësi pritet të kontribuojë në mënyrë produktive nëse ai paraqet mirë vetveten, duke vënë theksin në pikat e forta; Punon në mënyrë të pavarur dhe në grup; Organizon dhe udhëheq veprimtari të të nxënit dhe shoqërore; Demonstron shkathtësi sipërmarrëse, njohuri për planifikimin e punës dhe për shfrytëzimin racional të kohës; Zotëron aftësi për menaxhimin e konflikteve dhe vlerësimin e rreziqeve.

Në arsimin fillor, në mënyrë të veçantë për këtë kompetencë, pritet që nxënësi:

- Përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, duke gjetur të përbashkëtat, që ato kanë me profesionet e dëshiruara.
- Përgatit një plan pune një javor dhe specifikon veprimtaritë prioritare duke argumentuar përzgjedhjen e tyre.
- Përgatit një projekt të vogël, duke theksuar veprimtaritë kryesore për një çështje, që e shqetëson në shkollë ose komunitet dhe përcakton kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për zbatimin e tij.
- Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit, që e rrethon dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për veprimtaritë e mundshme, për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
- Diskuton për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë.
- Identifikon dhe llogarit shpenzimet personale ose familjare përgjatë një jave dhe i paraqet ato në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
- Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshëm (rrobave, ushqimeve, ilaceve) dhe sqaron përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes si dhe rrisqet për mospërdorimin në mënyrën e duhur.
- Paraqet në formë tabelare, grafike, vizatimi apo formë tjetër veprimtaritë e përkujdesjes për qeniet e gjalla, të cilat mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij.

Në arsimin e mesëm të ulët, në mënyrë të veçantë për këtë kompetencë, pritet që nxënësi:

- Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme.
- Ndërmerr aktivitete të ndryshme për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore për shkollën ose për komunitet (ekspozitë, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit të hartuar me anëtarë të grupit.
- Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut 22 dhe biodiversitetit duke i paraqitur idetë në formë të shkruar ose në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, jep mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje si dhe organizon aktivitete për mbrojtjen e mjedisit.
- Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/dhe publikimeve të ndryshme të shkollës.
- Zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale, të familjes ose të klasës dhe argumenton rëndësinë e planifikimit të buxhetit.
- Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë.
- Propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik, etj., (si anëtar jurie të ngritur në nivel klase, shkolle apo shoqërie civile).
- Hulumton nevojat e shkollës ose të komunitetit dhe në bazë të të dhënave organizon aksione vullnetare apo humanitare për plotësimin ose përmirësimin e nevojave.

Në arsimin e mesëm të lartë, në mënyrë të veçantë për këtë kompetencë, pritet që nxënësi:

- përcakton prioritete, jep zgjidhje cilësore për përmirësimin e mjedisit, si dhe zbaton parimet e tregut të lirë dhe të buxhetimit në situata të jetës reale;
- ndërmerr iniciativë në aktivitete të ndryshme me interes për lëndën/fushën mësimore, për klasën, për shkollën dhe për mjedisin ku jeton, si dhe tregohet i përgjegjshëm në plotësimin e detyrave, përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve, referuar projektit apo planit;
- argumenton me shembuj konkretë lidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, prezanton vendimmarrjen personale referuar mundësive në dispozicion për 19 arsimim/trajnim të mëtejshëm, mundësive personale dhe financiare, si dhe argumenton zgjidhjet për realizimin e planit personal të karrierës;

- planifikon dhe menaxhon me sukses një projekt me objektiva të caktuara, si p.sh., një projekt për organizimin e ndërmarrjeve të vogla që ofrojnë produkte dhe shërbime për qytetarët, duke u mbështetur në kërkesat aktuale të tregut të punës;
- paraqet modelin e një drejtuesi të një ndërmarrjeje ose organizate, sipas imagjinatës personale dhe duke respektuar karakteristikat kryesore të një sipërmarrësi të suksesshëm;
- përdor aftësitë digjitale për llogaritjen, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informacione të nevojshme (p.sh., të një mjedisi të biznesit), duke renditur të dhënat sipas nevojave dhe prioriteteve të ndërmarrjes ose organizatës;
- zbaton udhëzimet dhe rregullat e shkruara në udhëzues, katalog, apo skicë për përdorimin e drejtë të mjeteve laboratorike, makinave dhe pajisjeve teknike, gjatë një ushtrimi ose aktiviteti (në klasë, në laborator etj.), si dhe tregon për të tjerët mënyrën e zgjedhjes dhe përdorimit të tyre;
- paraqet kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar;
- merr iniciativa të suksesshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.

Gjatë seancave të parashikuara, do të analizohen edhe programet e arsimit fillor dhe për arsimin e mesëm të ulët për fushat “Shoqëria dhe mjedisi” dhe “Shkencat e natyrës”.

3. Metodologjia.

Rubrika e metodologjisë së zbatimit të këtij moduli përmban metodat që do të përdoren për secilën seancë të trajnimit, mjetet mësimore për konkretizim dhe detyrat për pjesëmarrësit që do të kryhen pas zhvillimit të modulit.

a) Metodatat gjatë trajnimit

Metodologjia që do të përdoret në këtë modul: Trajnim i drejtpërdrejt nëpërmjet leksionit, diskutimit, punës në grupe etj.

Temat e seancave
Edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor i lidhur me kurrikulën
Dokumentacioni i ri kurrikular dhe lidhja e tij me edukimin mjedisor
Përshkallëzimi i kërkesave nga njëra shkallë e kurrikulës në tjetrën
Hapësirat që krijon kurrikula e re për të trajtuar aspekte të ndryshme të mbrojtjes së zonave në

Temat e seancave
Shqipëri në arsimin e mesëm të ulët Analiza e programeve të reja kurrikulare
Aktivitete edukuese dhe ndërgjegjësuese që mund të zhvillohen me fëmijët me fokus zonën e mbrojtur në arsimin fillor Punë në grupe
Aktivitete edukuese dhe ndërgjegjësuese që mund të zhvillohen me fëmijët me fokus zonën e mbrojtur në arsimin e mesëm të ulët Punë në grupe

Mjetet ndihmëse:

- ✓ Kompjuter dhe Video-projektor, që do të përdoren nga trajnuesi për të realizuar trajnimin.

b) Detyra për të trajnuarit

- Përgatitja e një aktiviteti ditor të lidhur me një nga çështjet e edukimit mjedisor.
- Planifikimi i një projekti ndërlëndor.

c) Literatura e rekomanduar

- Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar
- Kurrikulat bërthamë
- Programet mësimore të Arsimit fillor, të Biologjisë, dhe të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”

VEPRIMTARI PRAKTIKE

MJEDISI LOKAL - TIPARET E MJEDISIT NATYROR

1. Përbërësit e mjedisit natyror.
2. Relievi, tiparet e përgjithshme dhe elementët përbërës të tij .
3. Klima dhe mikroklimat e mjedisit natyror lokal.
4. Ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe pasuritë pyjore.
5. Bimësia dhe bota shtazore. Elementët përbërës të florës dhe faunës.

MJEDISI NATYROR DHE JETA E NJERËZVE

1. Ndikimi i mjedisit natyror lokal në jetën e njerëzve që jetojnë në të.
2. Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në ndryshimin e mjedisit natyror .
3. Respektimi i mjedisit natyror dhe elementët përbërës të tij.

MBROJTJA E MJEDISIT QË NA RRETHON

1. Harta e florës dhe faunës në zonën tuaj.
2. Zhvillimi i mjedisit lokal dhe elementët përbërës të tij.
3. Faktorët që ndikojnë në pakësimin e hapësirave të gjelbra në zonën tuaj.
4. Roli i njeriut në mbrojtjen dhe dëmtimin e pasurive bimore e shtazore.
5. Bashkëpunimi komunitet-qeverisje lokale për ruajtjen e pasurisë bimore e shtazore në zonën tuaj.

INTERPRETIMI I HARTËS TOPOGRAFIKE TË MJEDISIT TUAJ LOKAL

Punë praktike: Njohja dhe interpretimi i hartës topografike sipas kritereve të përcaktuara në legjendën e hartës për mjedisin tuaj lokal.

1. Interpretimi i hartës topografike të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me elementët përbërës të hartës topografike si: qendra historike, lagjet e banimit, rrugët, ndërtesat arsimore, kulturore etj .
3. Vendndodhja e hapësirave dhe kurorës të gjelbër, agrikulturës dhe pyjeve në mjedisin tuaj lokal .
4. Interpretimi i hartës topografike të lagjes tuaj si pjesë përbërëse e mjedisit tuaj lokal.

NJOHJA NË TERREN E MJEDISIT QË NA RRETHON

Punë praktike: Një vështrim i përgjithshëm i mbi tiparet e relievit të mjedisit tuaj lokal duke përfshirë klimën, llojet e shkëmbinjve, bimësinë, botën shtazore, mineralet dhe burimet e energjisë.

1. Njohja me elementët përbërës të relievit të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me llojet e shkëmbinjve, tokave, maleve si pjesë e rëndësishme e relievit.
3. Njohja me klimën dhe mikroklimat që veprojnë në mjedisin tuaj lokal .
4. Njohja me bimësinë dhe botën shtazore të mjedisit tuaj lokal.
5. Njohja me ujërat, burimet minerare dhe të energjisë në mjedisin tuaj lokal.

MODULI 3 - RICIKLIMI

“RRUGË” MESIMORE MBI TEMËN E MBETJEVE - DISA IDE PËR MËSUESIT

Shkollat mund të zbatojnë aktivitete të edukimit mjedisor që synojnë nxitjen e “kulturës së mjedisit” nëpërmjet rrugëve që promovojnë aftësinë për të krijuar një marrëdhënie të vazhdueshme me botën dhe me sfidat e mëdha të ditëve të sotme.

Aktivitetet kanë për qëllim futjen tek të rinjtë sjellje të përgjegjshme ndaj mjedisit, duke filluar nga kontekstet individuale të jetës dhe marrëdhënieve, për një zhvillim të plotë të identitetit, kulturave dhe qytetarisë.

Rrugët janë të strukturuar në projekte transversale dhe karakterizohen si laboratore kërkimore edukativ dhe dizenjimi i njohurive, ku të dish të bësh dhe të dish të jesh.

Projektet dhe ekspozitat synojnë ti japin vlera: përvojës, vëzhgimin, marrëdhënien shkollë-territor, kompleksitetin, punën në terren, transversalitetin, ndryshimin, fleksibilitetin, vlerësimin e diferencave, ndjenjën e limitit, përgjegjësitë personale.

Projektet synojnë në:

te sensibilizojnë mbi problematikat mjedisore

- ✓ të sensibilizojë studentët, familjet dhe në përgjithësi komunitetin lokal dhe administratorët komunal mbi problemet mjedisore;
- ✓ të nxisin procese arsimore bashkëkohore për të nxitur ndryshime në sjellje dhe zakone, duke promovuar respekt ndaj mjedisit;
- ✓ të shpërndajë e informacione dhe njohurive mbi çështjet mjedisore dhe të inkurajojë pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në lidhje me mjedisin;
- ✓ të inkurajojë punën bashkëpunuese që përfshin aktorë të ndryshëm që veprojnë në këtë fushë, duke lehtësuar ngritjen e rrjeteve lokale që synojnë zhvillimin e iniciativave për menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe burimeve të tij.
- ✓ të promovojë "ndjenjën e përkatësisë" në mjedisin e vet të jetesës për të arritur aftësinë e të "menduarit globalisht" duke marrë pjesë në gjërat e botës;
- ✓ të njohin në tërësi mjedisin natyror dhe atë të krijuar nga njeriu, ekologjik, teknologjik, social, legjislativ, kulturor dhe estetik.

Çështjet mjedisore, në veçanti ato që lidhen me problemin e mbetjeve, janë të lidhura ngushtë me sjelljen individuale të subjekteve të ndryshme, qofshin prodhues apo konsumatorë. Në fakt, një nga problemet më serioze mjedisore të shoqërive perëndimore është rritja e vazhdueshme e prodhimit të mbeturinave për frymë.

Projekti i propozuar këtu është transversal sepse mbeturinat gjithmonë kanë ndikuar në mjedis, duke ndikuar në aspektin urban dhe natyrën në të cilin jetojmë.

Objektivi

- të inkurajojnë te nxënësit dhe familjet e tyre përhapjen e një mentaliteti në favor të grumbullimit të diferencuar të mbeturinave, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të gjithëve për një menaxhim racional të mbeturinave. Rritjen e vetëdijes për ekzistencën dhe rëndësinë e problemit të mbeturinave dhe asgjësimit të tyre, me vëmendje të veçantë për materialet që mund të rikuperohen;
- t'u mësojë fëmijëve rëndësinë e ekzistencës së qendrës së grumbullimit të mbeturinave, t'i udhëzojë ata mbi llojet e mbeturinave si dhe të inkurajojë ripërdorimin e tyre;
- të nxisi ndjeshmërinë e fëmijëve për grumbullimin e diferencuar dhe përdorimin e qendrës së grumbullimit nëpërmjet laboratorëve për klasat që çojnë në një njohuri të thelluara të materialeve të riciklueshme.
- të zbatojnë praktika të mira që synojnë reduktimin e prodhimit të mbetjeve

1. TOKA DHE MBETURINAT: A ËSHTË E MUNDUR BASHKEKZISTENCA? KOMPOSTIMI

Kompostiera

Ju mund të realizoni një kompostim (perzierje) "bëje vetë" në kopshtin e shkollës (në internet ju mund të gjeni udhëzimet).

Nxënësit mund të përdorin kompostierën për të dhënë mbeturinat e tyre organike (koçani i mollës, lëkura banane, etj) që prodhojnë në shkollë çdo ditë, të japin udhëzimet e përdorimit për përdoruesit e tjerë si dhe të bëjnë panelet informuese për të shpjeguar se si është marrë përzierja dhe për çfarë mund të përdoret.

Shikoni me kalimin e kohës transformimin e mbeturinave organike në komposto (dekompozim, krimbat etj).

Përdorni në fund të vitit shkollor këtë komposto plehrash / tokë plehrash si tokë për mbjelljen e luleve në kopshtin e shkollës ose në parkun publik aty pranë.

Studioni se si mbeturinat organike treten në botë dhe në histori (me dëshmi dhe intervista nga familjet dhe komuniteti lokal).

2. MBLEDHJA DERË MË DERË? ... PO FALEMINDERIT

Hedhja e mbeturinave gjithmonë ka pasur një ndikim të rëndësishëm në mjedis i cili ndikon në aspektin urban dhe atë natyror në të cilin jetojmë. Kjo çon në vendosjen dhe zbatimin e zgjedhjeve dhe sjelljeve konkrete për të zvogëluar prodhimin e mbeturinave përmes sistemit të grumbullimit "derë më derë".

Objektivat:

- Të zhvillohet sistemi i grumbullimit "Derë më Derë" në komunitetin e shkollës;
- hartimin e materialit informativ që mund t'u dërgohet familjeve nga organet përgjegjëse për menaxhimin e shërbimeve të higjienës urbane;

Struktura e projektit - Çfarë është mbeturina dhe llojet e ndryshme të mbeturinave; grumbullimi i ndarë i mbetjeve; ndikimi i mbeturinave në mjedis; - të njohim kompaninë komunale që ofron shërbimin e menaxhimit të mbeturinave; - analiza e gjendjes aktuale të grumbullimit të mbeturinave në komunën ku gjendet shkolla. - Studimi i riorganizimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve - nxënësit mund të përgatisin (dhe pastaj të vlerësojnë) një pyetësor që do t'u dorëzohet prindërve dhe të njohurve për të vlerësuar shkallën e kënaqësisë me sistemin e përdorur nga bashkia për përpunimin e mbetjeve ose stimulimin e grumbullimit të ndarë në burim.

- Cikli i jetëgjatësisë së disa ndarjeve meceologjike. - Komunikimi mjedisor lidhur me mbeturinat; - klasa, e ndarë në grupe të vogla, do të thellojë njohuritë mbi ciklin jetësor të një prej ndarjeve meceologjike: organike, plastike, qelqi, metale, bateri, letër; - forum për shpërndarjen e rezultateve. - fëmijët do të mësojnë të shikojnë, të trillojnë, të luajnë me fjalë, të përdorin mjete teknologjike (si kamera dhe/ose video kamera), për të ekspozuar pikëpamjet e tyre mbi problemin e mbeturinave, në veçanti duke u përpjekur të prodhojnë slogane për të dekurajuar braktisjen e mbetjeve në territor dhe/ose djegien e tyre; - praktikë në terren.

Strategjitë operationale / organizative / kohore

Është e nevojshme të përfshihen realitetet lokale më të interesuara në këtë temë, siç janë Administratat Komunale dhe rrethi, OJQ-të aktive mbi çështjet e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe operatorët e sektorit privat. Vizitat në impiantet e përpunimit të llojeve të ndryshme të mbeturinave. Ndër këto: vend depositimet e mbetjeve, impiantet e përpunimit të letrës apo impiante multi-materiale.

3) Ripërdorimi: Bankoja e lodrave

Tregu i fëmijëve do të rinovohet duke u pasuruar me mënyra të reja zbavitje. Ajo shndërrohet në një lojë të mrekullueshme për të gjetur veten dhe për të bërë njohje të reja, të argëtoheni dhe t'i kushtoni një pjesë të kohës tuaj solidaritetit. Ata shkëmbejnë lodra, libra, përralla etj duke u bërë kështu një pjesë e fëmijërisë së secilit. Ajo gjithashtu bëhet një mundësi për të bërë lojëra të ndryshme, animacione, punëtori kreative dhe të jetojnë shumë orë në një shkollë mikpritëse, e cila është një mik i fëmijërisë dhe adoleshencës.

Objektivi:

- ✓ të nxitë programet e edukimit mjedisor të kërkim-veprimit;
- ✓ të forcojë veprimin edukativ të projektit duke ofruar shërbime dhe mjete në të cilat varet zbatimi i praktikave të mira;
- ✓ krijimi i një "ure" midis shkollave (personeli, nxënës) dhe autoritetet lokale, shoqatat etj., të cilat mbështesin qëllimin për zvogëlimin e konsumit; - të stimulojë një ndryshim real social, ku vlerat e integritetit, bashkëpunimit, dhurimit, mbrojtjes së mjedisit dhe praktikave të mira janë gurët kryesorë;
- ✓ të inkurajojnë bashkëpunimin me institucionet dhe shoqatat që veprojnë në terren për menaxhimin e çështjeve të mbetjeve dhe për aktivizimin e proceseve arsimore dhe informative;
- ✓ identifikojnë dhe vlerësojnë ndikimin e veprimit arsimor duke vlerësuar objektivat e arritura nëpërmjet të dhënave reale të ndryshimeve në sjellje.

Struktura e projektit: Përgatitja brenda shkollave të vendeve të veçanta për shkëmbimin e lodrave që nuk përdoren më nga fëmijët.

Strategjitë operacionale/organizative/kohore: Projekti parashikon përfshirjen e shoqatave, institucioneve, bibliotekave në zonë.

4. THUAJ, BËJ, KRIJO ... TË MËSOJMË TË RICIKLOJMË

Projekti synon të bëjë letër të ricikluar në shkollë duke e kthyer atë në llapa, (qull) letrën që nuk është më e nevojshme dhe pastaj duke e lënë atë të thahet (fazat e ndryshme mund të gjenden në internet).

Projekti:

- ✓ synon të shpjegojë se si "riciklimi" nuk është asgjë më shumë se akti i thjeshtë i modifikimit të një objekti dhe kthimi i tij për një përdorim tjetër për të shmangur hedhjen e tij
- ✓ synon të edukojë në mënyrë që të shmangim shpërdorimet

- ✓ gjithashtu na lejon të reflektohem mbi përdorimin e letrës me kalimin e kohës dhe evoluimin e saj të mundshëm (e-libër, zvogëlimin e gazetave të shtypura në favor të lajmit në internet, nevojën për të zvogëluar ripërdorimin e letrës në praktikën e përditshme etj)
- ✓ synon të identifikojë rregullat e mirësjelljes që mund të reduktojnë konsumin e letrës në shkollë dhe në shtëpi dhe të inkurajojnë riciklimin e saj.
- ✓ ju lejon të bëni produkte letre (monumente, objekte, etj.) dhe ndoshta t'i shfaqni ato në një ekspozitë në shkollë ose në vende të tjera.

5. IDEIMI I NJË FUSHATE PROMIVIMI

Projekti ka për qëllim t'i bëjë fëmijët të ideojnë një fushatë të vërtetë promovimi për të bindur komunitetin që të reduktojë mbeturinat, ti shmangë ato dhe të mbledhë në mënyrë të diferencuar. Mund të ketë si objekt mbetjet në kuptimin e përgjithshëm por edhe një lloj të vetëm (letër, plastikë, vaj gatimi etj.).

Pjesa e parë fokusohet në llojet e ndryshme të mbeturinave dhe në një kërkim për fushatat informative të përdorura në Shqipëri dhe në vende të tjera për mbetjet. Pastaj çdo klasë (ose grup) mund të përdorë mënyra të ndryshme (poster, broshurë, video clip, këngë, etj.) të komunikimit për të paketuar dhe dërguar mesazhin e tyre.

EKSPOZITË INTERAKTIVE “MË SHUMË APO MË PAK MBETJE”

E gjithë ekspozita sillet rreth temës së plehrave në përgjithësi, me theks të veçantë në temën "mbeturina". Duke ofruar një sërë informacionesh, ne do të përpiqemi të sensibilizojmë vëzhguesit, duke i bërë ata më të vetëdijshëm mbi rëndësinë e këtij problemi. Ekspozita mund të jetë në hapësirat e ndryshme të shtëpisë: salla e hyrjes, dhoma e ngrënies, bodrumi, dhoma e ndejties, kuzhinën, pra ambientet ku kryhet prodhimi i mbeturinave. Nëpërmjet lojërave interaktive, vizitori është mund të edukohet për praktika të mira.

Cfarë mësojnë?

- "identifikojnë" paketimet me ndikim më të ulët mjedisor;
- të përcaktojnë numrin e koshave "një përdorimsh" të cilët mund të shmangen dhe mund të përzgjidhen koshat e ripërdorshëm;
- të mësojnë për të riparuar gjëra të thjeshta;
- të njohin paketimet e ndryshme dhe zbulojnë origjinën e tyre;
- ekspozita gjithashtu mund të ketë produkte të bëra me dorë prej mbeturinave (letër, plastike, tapa etj)

Drejtuar Shkollave fillore dhe 9-vjeçare.

Struktura e ekspozitës mund të ndryshojë në varësi të llojit të vendeve në dispozicion.



Aktivite shtesë që mund të realizohen me klasat e hapura:

Riciklimi i tapave të shisheve për të dizenuar një element karakteristik të Zonës së Mbrojtur.

Objektivi: Duke qenë se qëllimi kryesor i projektit lidhet me zonat e mbrojtura dhe edukimin mjedisor, nëpërmjet këtij aktiviteti synohet zgjerimi i njohurive të fëmijëve mbi elementët karakteristikë të zonës së tyre të mbrojtur dhe përforcimi i të kuptuarit të natyrës dhe mbrojtjes së saj nëpërmjet ripërdorimit të objekteve të riciklueshme.

Struktura e aktivitetit: Nxënësit janë elementi kyç, si një brez i ardhshëm, të cilët duhet të jenë gjithmonë në kontakt me mjedisin dhe si duhet t'a mbrojnë atë, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi individual dhe nëpërmjet tyre çdo element i këtij zinxhiri.

Përfshirja e fëmijëve në disenjimin e një tabloje të përbashkët me një karakteristikë të zonës së mbrojtur, që në rastin e Bredhit të Hotovës, do jetë "Bredhi" dhe "Ariu" do të luaj një rol mjaft të rëndësishëm në radhë të parë në bashkëpunimin e tyre për të nxjerrë një punë finale të mënyrës si ata e kuptojnë mjedisin dhe së dyti duke rritur imagjinatën dhe aftësinë për të përdorur objekte të riciklueshme dhe rëndësinë që ka ripërdorimi i tyre, si një mënyrë për të sjell ndikime më të pakta në mjedis. Puna finale do të nxis dëshirën e tyre për të realizuar gjëra të tilla edhe në mënyrë individuale në të ardhmen.

Strategjia organizative: Ndarja e nxënësve në grupe sipas klasave dhe realizimi i një tabloje me një karakteristikë të zonës së mbrojtur nga secili grup; përdorimi i tapave më madhësi të ndryshme të shisheve, rrobave që nuk përdoren më, plastikave, kartonave, letrave me ngjyrë, të mbledhura nga nxënësit që në momentin e lajmërimit të mësuesve lidhur me aktivitetin e ardhshëm.

Përdorimin e shisheve plastike si një mënyrë për të gjelbëruar ambientin e shkollës



Objektivi: Në mënyrë që nxënësit të jenë sa më të lidhur me çdo element të natyrës, është e rëndësishme që ata të dinë të ndërtojnë një pjesë natyre brenda ambienteve ku ata rriten e mësojnë.

Struktura e aktivitetit: Kur bëhet fjala për natyrë, së pari duhet të dimë si funksionon natyra. Ndërtimi i një kopshti të vogël nga vetë nxënësit brenda ambienteve të shkollës, do të rris aftësitë e tyre për të punuar për një jetë të shëndetshme dhe për t'u njohur më nga afër me proceset natyrore, siç mund të jetë rritja e një bime.

Përdorimi i shisheve të plastikës në vend të një vazoje do të ndikoj në mendimin e fëmijës, në mënyrë që ai të kuptoj se asgjë nuk duhet shpërdoruar, por ajo mund të ripërdoret për të krijuar diçka akoma dhe më të vlefshme. Asgjë nuk duhet të shkoj dëm.

Strategjia organizative: Përdorimi i një faqeje muri të shkollës për të vendosur shishe plastike të përmasave të njëjta, të lidhura me spango të trasha përgjatë gjithë gjatësisë së murit; aktivizimi i nxënësve në sigurimin e plehut dhe bimëve të ndryshme nga shtëpia e tyre ose jo, të cilat mund të jenë bimë aromatike ose zbukuruese; ndërtimi i një kopshti botanik për shkollën; përkujdesja në mënyrë të vazhdueshme për të.